

**PËRMBLEDHJE DREJT
ARSIMIT PAQËSOR**

Titulli: PËRMBLEDHJE DREJT ARSIMIT PAQËSOR

Botues: Ambasada e parë e fëmijëve në botë “Megjashi” Rr. Kosta Novakoviç nr. 22a 1000 Shkup

Për botuesin: M-r Dragi Zmijanac, president dhe themelues

Telefoni: +389 2 2465316

e-mail: info@childrensembassy.org.mk; peace@childrensembassy.org.mk

Redaktore: Gordana Pirkovska Zmijanac, Ana Bitoljanu dhe Fatmire Ajdari

Formimi grafik: Sasho N. Alusheski

Përkthyes nga maqedonisht: Hamide Baftija, Agim Avdiu

Shtypi: Invento

Vizatimet të cilat janë përdorur për ilustrim në përmbledhje i vizatuan fëmijë të cilët nuk janë të përfshirë në procesin e rregullt arsimor, vizitor në qendrën ditore të Ambasadës së fëmijëve Megjashi. Me shpresë dhe besim në edukim për të gjithë fëmijët, këtë libër ia dedikojmë: Melisë, Elidës, Saminës, Vanesës, Asijës, Antonelës, Shakirës, Martinës, Ajtenit, Medinës, Xhejlanit, Menës, Leontinës, Jasinit, Marijës, Rihanit, Leritës, Abdushit, Selvies, Ramizës, Naserit, Gabrielit, Sabrinës, Elifit, Serhanit, Siberxhanës, Orhanit, Shukres, Enisës, Anetës, Elizabetës, Elvisit, Ramijes, Nerxhivanes, Njusenës, Iskrës, Elvisit, Valbonës, Bergijes, Selmës, Mevludes, Xhefrinës, Marvinit, Bergijanit, Shaos, Senedit, Jufidës, Elinës, Senadës.

Ivan Oparin, një djalë 10-vjeçar nga Rostov në Don, Federata Ruse. Kur ishte tre vjeç, mësuesja në kopsht i tha se vizatimet e tij ishin shumë të këqija. Atëherë Ivani kishte “kuptuar” se nuk mund të vizatojë fare. Në shkollë nuk vizatonte fare, sepse vizatimet e tij janë jashtë asaj që kërkohet në program. Por ai dëshiron të vizatojë entitete të ndryshme të çuditshme dhe ta imagjinojë jetën e tyre. (personazhet e tij janë në frytin më të plotë të një imagjinate shumë kreative, të gjithë janë plot jetë, dhe të gjithë janë të pa dhunshme). Në faqen 3 është Shalmasvir. Ai ha orë dhe jeton në Kinë. Ai ka një makinë fluturuese portokalli dhe eksploron botën me gjuhën e tij. Në faqen 37 është Çizha. Ai jeton në oqean. Ushqehet me kripë dhe peshkaqenët janë miqtë e tij. Në faqen 90 është Kula. Ajo jeton në një vullkan dhe mbart 71 vezë gjatë gjithë jetës së saj. Pikat vjollcë janë fëmijët e saj.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

37:316.627 (497.7) (082)

ЗБОРНИК кон мировното образование / [уреднички Гордана Пирковска Змијанац,

Ана Битољану и Фатмире Ајдари; превод од англиски и хрватски јазик Сашо Н. Алушевски]. - Скопје:

Прва детска амбасада во светот „Меѓаши“, 2018. - 70, 41 стр. ; 30 см

Насл. стр. на припечатениот текст: Permbledhje drejt arsimit paqësor. -

Обата текста меѓусебно печатени во спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4603-18-4

a) Мировно образование - Теорија и пракса - Македонија - Зборници COBISS.MK-ID 109273866

ШАЛЬМАШВИР



PËRMBAJTJA

1. Drejt arsimit paqësor në Republikën e Maqedonisë	5
<i>Gordana Pirkovska Zmijanac dhe Ana Bitoljanu</i>	
2. Arsimi paqësor – arsim për të gjithë	11
<i>Sebastian Shvajcer</i>	
3. Arsimimi paqësor nëpër shkolla si mundësi e jo si barrë shtesë.....	17
<i>Goran Bozhiçeviq</i>	
4. Vendosja e arsimimit paqësor në pjesën formale dhe joformale të sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë	27
<i>Sofka Koceva</i>	
5. Për Arsim për paqe - Nuk ka drejtësi, nuk ka paqe!	37
<i>Zhana Zhivadinoviq</i>	
6. Arsimi paqësor mund të jetë mënyrë jetese	43
<i>Arbana Pasholli</i>	
7. Përvoja nga SHMQSH “Nikolla Karev”	46
<i>Gordana Blazhevska Spiridonova dhe Maja Filiposka</i>	
8. FJALOR I ARSIMIT PAQËSOR	71
<i>Goran Bozhiçeviq</i>	

1. DREJT ARSIMIT PAQËSOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Arsimi paqësor (AP) ose arsimi për paqe, sot, në kohën e krizës globale dhe pasigurisë, ngjall interes gjithnjë më të madh. Ajo promovon njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që mund tu ndihmojnë njerëzve që ti transformojnë konfliktet në mënyrë paqësore, të ndërtojnë shoqëri më të drejta, dhe në mjediset ku ata jetojnë të krijojnë kushte për paqe pozitive. Vlerat kryesore të arsimit paqësor, të tilla si jo-dhuna dhe drejtësia sociale, janë themeli i ndryshimit të dëshiruar shoqëror për respektimin e të drejtave të njeriut dhe për ndërtimin e besimit.

Arsimi paqësor i përfshin të gjitha moshat. Të gjitha temat mund dhe duhet të diskutohen në mënyrë të përshtatshme, me mosha dhe grupe të ndryshme. Të mësuarit reciprok si dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, i inkurajon njerëzit si ndërtues individual të kulturës për paqe dhe në përgjithësi rrit përkushtimin ndaj paqes në një komunitet apo shoqëri.

Nëpër shkolla AP është program shkollor inovativ dhe gjithëpërfshirës me të cilën krijohet një mjedis i këndshëm dhe jo i dhunshëm nëpër shkolla dhe jashtë tyre duke krijuar unitetin në diversitet dhe duke plotësuar nevojat e shumta të popullsisë së ndryshme. Paqja dhe arsimi janë një aspekt i pandashëm i civilizimit modern. Asnjë civilizim nuk është me të vërtetë i avancuar pa arsimim dhe asnjë sistem arsimor nuk është me të vërtetë i civilizuar nëse nuk bazohet në parimet universale të paqes.

Bazat fillestare të arsimit për PAQE

Arsimi paqësor rrënjët e tij i gjen në praktikat e mira dhe mësimet e ndryshme, nga konceptet religjioze deri në pedagog të shquar dhe mendimtarë të tillë si Komenski, Montessori etj. Qasjet shkencore dhe aktiviste të J. Galtung, I. Haris, P. Freira, B. Rirdon etj, sot japin kahje dhe forma të arsimit paqësor, ndërsa Kombet e Bashkuara vazhdimisht e theksojnë rëndësinë e arsimit paqësor. Sipas KB-së zhvillimi i kulturës së paqes është e një rëndësie esenciale për shoqëritë, kështu viti 2013 ishte dedikuar për arsimin paqësor duke theksuar se arsimi ka rëndësi vitale për nxitjen e përkatësisë globale dhe ndërtimin e shoqërive që jetojnë në paqe. Por një nga problemet për përfaqësimin më të madh të AP është se nuk ekziston një përgjigje e lehtë dhe e thjeshtë për pyetjet: Çfarë (gjithqka) është në të vërtetë arsimi paqësor? Cilat përmbajtje duhet ti përfshijë? Cilat përmbajtje në nivel global do të zbatohen kudo? etj. Drej kësaj gjendje gjithashtu kontribuon edhe ajo se arsimi paqësor nuk është një disiplinë shkencore dhe arsimore plotësisht e veçantë.

Në preambulën e Kushtetutës së UNESCO-s të vitit 1945 theksohet: „Meqë luftërat fillojnë në kokat e njerëzve, preventimi i paqes duhet të bëhet në kokat e njerëzve”. Rrjedhimisht pas kësaj deklarate, njerëzit mund të mësojnë se si të jetojnë në mënyrë paqësore, të përbashkët dhe se si mund të krijohet paqja në të gjithë botën. Në pedagogjinë për paqe, përkundër gjitha miteve, dihet se askush “nga natyra” nuk është i dhunshëm, se njeriu posedon dhunti të lindura që ndikojnë në sjelljen e tij, por asnjëherë nuk e determinojnë plotësisht. Nga këtu, edukimi në parim është i arsyeshëm dhe i mundshëm.

Pikënisjet e çdo lloj forme të edukimit për paqe janë baza emocionale dhe kognitive të sjelljes, dhe në këtë kontekst edhe pikëpamjet e individëve dhe grupeve. Prandaj, për të eliminuar luftën

dhe dhunën është e nevojshme ndryshimi i qëndrimeve dhe paragjytimeve të caktuara, si dhe ndryshimi i strukturave të pushtetit shoqëror dhe ndërkombëtar. Analiza e strukturave të pushtetit shoqëror dhe ndërkombëtar është një pjesë e pashmangshme e pedagogjisë për paqe, ndërsa të kuptuarit dhe përballjes me konfliktet u jepet rëndësi qendrore. Arsimi mund të luaj një rol të madh në nxitjen e ndjenjës së të gjithë i përkasin botës së njëjtë. Nuk mjafton që vetëm ti mësojmë fëmijët të lexojnë, shkruajnë dhe numërojnë. Arsimi duhet të bazohet në respektin reciprok dhe të kontribuon në krijimin e paqes në komunitet. Arsimi për paqe dhe promovimi i paqes përmes arsimit është një prioritet i UNESCO-s.

Arsimi duhet të nxisë respektin e ndërsjellë për të tjerët dhe botën në të cilën jetojmë, tu ndihmon njerëzve të krijojnë komunitete më të drejta, inkluzive dhe më paqësore. Shtetet anëtare të UNESCO-s në vitin 1974 e miratuan Rekomandimin për arsim për bashkëpunim ndërkombëtar, paqe dhe arsim për të drejtat dhe liritë e njeriut në lidhje me të gjitha fazat dhe format e arsimit dhe përcaktimin e përgjegjësisë së shteteve anëtare të ofrojnë arsim për të gjithë, në mënyrë që të promovohet drejtësia, liria, të drejtat e njeriut dhe paqja. Rëndësia e këtij rekomandimi u konfirmua në vitin 1995 në dokumentin Korniza e integruar për veprim për arsim 1 dhe në dokumente të tjera të UNESCO-s ku në veçanti theksohet rëndësia e arsimit për paqe dhe kontributi i shkollave në këtë drejtim.

Në vitin 1999 është sjellur një dokument i rëndësishëm që nxjerr në pah lidhjen kryesore mes arsimit për paqe dhe krijimin e një kulture të paqes: Deklarata e KB-së për kulturën e paqes¹⁾. Sipas Deklaratës dhe programit për aksion kultura e paqes është një përmbledhje e vlerave, qëndrimeve, traditave dhe mënyrave të sjelljes të bazuara në respektimin e jetës së njeriut, ndalimin e dhunës, promovimin dhe implementimin e jo-dhunës përmes edukimit, dialogut dhe bashkëpunimit. Deklarata thekson gjithashtu se kultura e paqes duhet të bazohet në respektimin e parimeve të lirisë, drejtësisë, demokracisë, tolerancës, solidaritetit, bashkëpunimit, pluralizmit, diversitetin e kulturave dhe të kuptuarit në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe mes popujve. Ajo gjithashtu promovon që mjedisi jetë- sor të jetë i favorshëm për ndërtimin e paqes, si dhe pjesëmarrjen aktive të të gjithë anëtarëve të shoqërisë në promovimin e kulturës së paqes, duke theksuar se roli kyç në promovimin u takon: prindërve, politikanëve, gazetarëve, organizatave dhe grupeve fetare, intelektualëve, shkencëtarëve, filozofëve, njerëzve krijues, artistëve, shëndetësisë dhe punëtorëve humanitarë, punëtorëve socialë, menaxherëve, organizatave joqeveritare etj.

Deklarata thekson se kultura e paqes duhet të bazohet në respektimin e parimeve të lirisë, drejtësisë, demokracisë, tolerancës, solidaritetit, bashkëpunimit, pluralizmit, diversitetit të kulturave dhe të kuptuarit e të gjitha niveleve të shoqërisë dhe midis popujve, ndërsa ruhet në një mjedis kombëtar dhe ndërkombëtar që nxit ndërtimin e paqes dhe që e mundëson gjithë këtë.

Çfarë është arsimi paqësor?

Nuk është e thjeshtë përgjigja e pyetjes se çfarë në të vërtetë është arsimi paqësor dhe se cilat përmbajtje duhet ti përfshijë, për shkak se çdo kontekst dhe rajon kërkon një qasje të ndryshme, një integrim të ndryshëm të vlerave dhe përmbajtjeve të arsimit për paqe, por qëllimet e të gjithë

¹⁾ <http://www.un-documents.net/a53r243a.htm>

aktorëve që janë të dedikuar / përfshirë janë të ngjashme: përpunim i qetë, gjegjësisht transformim jo i dhunshëm i konflikteve, nxitjen e një klime të padhunshme dhe të mirëkuptimit të ndërsjellë, ndërsa në shkollë – fëmijë të lumtur në një shkollë të qetë, kreative dhe të sigurt.

Në të njëjtën kohë, të gjitha çështjet lidhur me AP domosdoshmërisht na kthejnë prapa tek pyetjet: Çfarë është paqja? dhe Si përjetohet paqja në mjedisin / vendin ku jetojmë, punojmë, veprojmë? Dëshirojmë që të inkurajojmë që më shumë të flitet dhe të mendohet për paqen dhe arsimin paqësor, veçanërisht në drejtimin që paqja nuk është vetëm mungesë e luftës dhe veprimeve ushtarake. Prandaj arsimi paqësor përfshin një gamë të gjërë temash të tilla si jo-dhuna, teknikat e transformimit të konflikteve, demokracinë, çarmatimin, diversitetin, identitetin, bashkëjetesën, barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, përgjegjësinë për mjedisin jetësor, aftësitë e komunikimit, etj

Një tjetër tipar kyç i arsimit paqësor është përshtatja e tij në vendin ku kryhet si dhe rishqyrtim konstant i raportit të mjediseve makro dhe mikro, globale - lokale. Edhe pse një pjesë nga temat e përgjithshme kudo janë të njëjta, si ato të përmendurat- paqja, jo-dhuna, transformimi i konfliktit, të drejtat e njeriut, diversiteti, barazia gjinore, përgjegjësia për mjedisin etj, çështjet specifike dhe temat në të cilat punohet përcaktohen ndryshe, në kontekste të ndryshme shoqërore, varësisht nga historia e vendit dhe sfidave / problemeve kryesore me të cilat ballafaqohet.

AP në Maqedoni patjetër duhet që të merret me gjëra të tilla si lufta/konflikti në vitin 2001, ndarjet etnike, gjegjësisht dhuna dhe diskriminimi që dalin nga kjo ndarje, mungesa e konceptit qytetërim/qytetar, shterje nga periudha e tranzicionit, kalimi nga sistemi njëpartiak në atë shumëpartiak, nga sistemi ideologjik në demokraci, por edhe mungesa e kulturës demokratike, ndryshimet nga socializmi në kapitalizëm, etj, por edhe me çështjet aktuale të tanishme, si për shembull ndotja dhe e drejta për ajër të pastër apo refugjatët dhe gjendja e tyre dhe probleme të ngjashme që kanë rëndësi jetësore.

Edhe pse temat ndonjëherë duken të rënda, me ta duhet të angazhohemi në mënyrë që të mos mbetemi vetëm në vizatimin e pëllumbave të paqes nëpër muret e ndërtesave shkollore pa i inkurajuar nxënësit për të mësuar më shumë për shkaqet e konflikteve dhe problemeve, si dhe të përballohen me ta në mënyrë jo të dhunshme dhe kreative – madje edhe nëse kjo është më e vështirë për tu bërë. Një nga rekomandimet tona për shkollat me të cilat bashkëpunojmë është brenda vetë kolektivëve të bisedojnë dhe të gjejnë se cilat tema nga fusha e AP janë të rëndësishme dhe relevante për ta dhe kështu në mënyrë aktive të artikulojnë edhe disa probleme mjaft specifike të një mjedisi / komuniteti lokal të caktuar.

AP përveq fokusimit të saj të domosdoshëm në kontekstin e vendit dhe problemeve që ekzistojnë në vend, njëkohësisht e përfshin edhe segmentin rajonal, duke inkurajuar bashkëpunimin ndërkufitar apo rajonal me vendet fqinje. Ky lloj i bashkëpunimit është veçanërisht i rëndësishëm në qoftë se ekziston një e kaluar e përbashkët e ngarkuar me dhunë, siç është rasti me vendet e ish-Jugosllavisë, jo vetëm në aspektin e stabilizimit të marrëdhënieve pas konfliktit, por edhe si një investim aktiv në ndërtimin e një të ardhme të përbashkët.

Qasja e Ambasadës së Fëmijëve Megjashi

Për ne kuptimi i paqes është vizion i shoqërisë, në të cilën çdo fëmijë dhe të gjithë njerëzit mund ti zhvillojnë potencialet e tyre dhe ti realizojnë liritë e tyre personale, duke pasur parasysh që të jenë të ligjshme, por edhe përmes normave shoqërore, të mbrojtur nga dhuna, shtypja dhe poshtërimi. Të ndërtojmë një shoqëri më humane dhe më të drejtë për të gjithë, dhe sidomos për të dobët.

Në këtë drejtim, kuptimi i arsimit për paqe ndoshta thjesht përshkruhet si një proces i të mësuarit gjatë gjithë jetës që rruan paqen. Mësimnxënia përfshin emocionet personale, artikulimin e vlerave dhe ideve, ndërtimin e kapaciteteve etj., që kontribuojnë në të jetuarit në një shoqëri ku ata gëzojnë të drejtat e njeriut, vazhdimisht zvogëlohen format e ndryshme të dhunës, vazhdimisht kontribuohet në drejtësinë sociale dhe ndryshimet shoqërore, bëhet kujdes dhe investohet në një mjedis të shëndetshëm jetësor... Arsimi paqësor i inkurajon dhe u mundëson njerëzve që ta njohin dhunën (drejtpërdrejtë, në mënyrë strukturore dhe kulturore), t'i përgjigjen asaj si dhe ti transformojnë konfliktet në mënyrë të padhunshme dhe konstruktive.

Pse është i nevojshëm, arsimi për paqe?

AP hap çështje që janë tejet të rëndësishme për gjeneratat e reja nga një aspekt i vlefshëm. Hap pyetje tipike të sferës së konfliktit dhe pas konfliktit:

- ♦ Si ti mësojnë gjeneratat e reja që t'i respektojnë dallimet dhe me vetëdije të kontribuojnë në zhvillimin e një atmosfere bashkëpunimi edhe në kolektivin shkollor?
- ♦ Si të theksohet rëndësia e përgjegjësisë personale në përmbushjen e detyrimeve dhe gjatë ndërveprimit me moshatarët?
- ♦ Si të transformohen konfliktet që shfaqen në mënyrë të pashmangshme, por edhe si të punohet në parandalimin e tyre?

Situata në botë është shqetësuese – nuk zvogëlohen rreziqet nga luftërat dhe konflikteve ushtarake, njëkohësisht rritet dhuna në marrëdhëniet ndërpersonale, dhe qëndrimi negativ ndaj mjedisit jetësor dhe krijon forma të reja të dhunës. Nevojiten përpjekje të përbashkëta dhe politika të menduara të veprimit, me ç'rast pikërisht arsimi theksohet si një fushë kyçe dhe mundësi për t'u përballur me këto probleme. Nevojitet arsim që të rinjve do t'u japë hapësirë të mjaftueshme për të menduar dhe për të mësuar në mënyrë aktive për paqen – arsimin paqësor (AP). Ndryshimet dhe qasja e ndryshme që janë të përfshira në arsimin paqësor ndikojnë tek të rinjtë që në kohën e duhur, shpesh dhe në mënyrë preventive ta njohin dhe të parandalojnë dhunën, ndërsa në mënyrë afatgjate kontribuon në përkushtimin e tyre ndaj jo-dhunës dhe pjesëmarrjes aktive në ngjarjet shoqërore.

Arsimi paqësor nëpër shkolla është i përqendruar te nxënësit dhe nevojat e tyre. Ky është një arsim me vlerë, nuk është neutral, por në mënyrë aktive përpigjet për vlera të tilla si jo-dhuna, barazia, empatia, solidariteti, mirëkuptimi, përgjegjësi, aktivizmi, dialogu etj. Arsim për të cilin është e rëndësishme se çfarë mësohet, por edhe se në çfarë mënyre mësohet, i cili i nxit nxënësit

në ndryshim shoqë- ror si qëllimin përfundimtar (nuk fokusohet vetëm në transferimin e njohurive dhe shkathtësive).

AP ofron shkathtësi praktike për atë se si të transformohen konfliktet në mënyrë jo të dhunshme, tregon vlerën e arsimit, përdorimin e njohurive dhe aftësive të fituara, sistemon, klasifikon, analizon, i përgatit të rinjtë për jetë, gjegjësisht u ndihmon për të kuptuar se si funksionon bota (shoqëria), por edhe çfarë lloj bote duan, nxit mirëkuptimin ndaj të tjerëve dhe botës, i inkurajon të rinjtë që në mënyrë aktive të përfshihen në ndodhitë rreth tyre, u ndihmon në zbulimin dhe përballimin me nacionalizmin, racizmin, mizogjininë, homofobinë seksizmin, ejxhizmin, gjuhën e urrejtjes dhe kështu me radhë.

Arsimi paqësor që të mund të zbatohet kryesisht kërkon krijimin e besimit mes të gjithë aktorëve në shkollë si dhe ndjenjën e barazisë, dhe jo sipas detyrimeve dhe rolin në procesin arsimor, por barazi në respektimin e të gjitha personaliteteve dhe mendimeve dhe përfshirjen e të rinjve në sfera të ndryshme të jetës shkollore, madje edhe në atë se si vetë shkolla është e organizuar dhe punon.

Kështu, AP kontribuon që shkolla të bëhet një komunitet në të cilin të rinjtë mësojnë se si të veprojnë dhe e ndërtojnë komunitetin sipas nevojave të tyre, ashtu siç duhet që të veprojnë më tutje në jetë si qytetarë aktiv të shoqërisë.

Metodologjia

Metodologjia përfshin forma të ndryshme të punës që përfshijnë të mësuarit e shkathtësive shoqë- rre, teknika për menaxhimin konstruktiv të konflikteve në shkollë dhe jashtë saj, punë në përmirë- simin e raporteve mes nxënësve, mësuesve dhe organizimin e punës së shkollave.

Në punën e përditshme në kuadër të projektit Arsimi paqësor është e rëndësishme që profesorët dhe nxënësit të fitojnë aftësi që do të kontribuojnë në ndërtimin e paqes. Theksi nuk është vendosur në mësimin si mësim, njohuri, edhe pse është e mirëseardhur, por më shumë në zbatimin praktik të komunikimit të padhunshëm, ndërtimin e paqes, bashkëpunimin, respektin ... Nëse flasim për njohuri, do të përmendim rëndësinë e njohjes së fakteve të caktuara rreth çarmatimit, mjetet e ndara për buxhetet ushtarake, armatimin etj, mënyra alternative për zgjidhjen dhe transformimin e konflikteve, mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të drejtat e njeriut, kulturat dhe besimet tjera.

Arsimi për paqe duhet të jetë pjesë e planprogramit të rregullt. Shkathtësitë në fushën e paqes përfshijnë zhvillimin e shkathtësive për komunikim dhe shkathtësi për përpunimin konstruktiv të konflikteve, analiza e krizës, vendosjen e prioriteteve, shkathtësi në punën ekipore ... Këto shkathtësi duhet të zhvillohen nëpërmjet arsimit, me rekomandim që të përdoret metodologjia e cila përdoret tani në programet e trajnimit të arsimit paqësor nga Ambasada e Fëmijëve Megjashi. Vlerat / qëndrimet që janë të nevojshme për ndërtimin e paqes përfshijnë: solidaritetin, kuriozitetin, interesin për të tjerët, mbështetjen, aksione jo të dhunshme, papajtueshmërinë me padrejtësinë, dëshira për të promovuar zgjidhje demokratike, drejtësinë dhe barazinë. Këto ndjenja / cilësi / shkathtësi zhvillohen duke përdorur një metodologji të veçantë (që mundëson) dhe nëpërmjet bisedimeve të hapura në hapsira të sigurta.


Të mundshme janë modele të ndryshme përmes të cilave arsimi paqësor mund të përfshihet në procesin e rregullt arsimor dhe kështu të bëhet pjesë e kulturës së shkollave dhe kulturës së përgjithshme të vendit.

Paqja ka forma të ndryshme, si dhe arsimi paqësor.

Në fund të rikujtojmë se ndryshimet i iniciojnë individët besnik dhe entuziastë dhe ju ftojmë për një reflektim dhe veprim të përbashkët, gjetja e mënyrave ku, dhe në çfarë mënyra mund ta zbatojmë Arsimin paqësor në sistemin e arsimit formal në R. Maqedonisë.

Gordana Pirkovska Zmijanac dhe Ana Bitoljanu

Për Ekipin e arsimit paqësor pranë Ambasadës së parë të fëmijëve në botë Megjashi



2. ARSIMI PAQËSOR – ARSIM PËR TË GJITHË

Arsimi paqësor – arsim për të gjithë

(Teksti është shkruar në bazë të „Designing Learning for Peace”)

Në kontekstin e Evropës moderne, arsimi për paqe është aktual ashtu siç ka qenë në dekadat e fundit. Megjithatë, edhe pse mund të thuhet se niveli i dhunës është reduktuar pas Luftës së Dytë Botërore, si në nivelin ndërshtetëror ashtu edhe në atë shoqëror, shoqëritë evropiane janë larg të liruarit nga dhuna.

Të gjitha format e dhunës janë më shumë prezente kudo në Evropë, nga shembujt më të theksuar si lufta në Ukrainë apo qëndrimet e rritura raciste dhe ksenofobike ndaj refugjatëve dhe minoriteteve ose kornizat ligjore që kufizojnë lirinë e shprehjes në një numër të madh të vendeve evropiane, e të mos flasim për format e dhunës nga jeta e përditshme, si forma me bazë gjinore të dhunës dhe ngacmimit në punë dhe në shkollat, ndër të tjera.

Kështu që pa hezitim, mund të thuhet se dhuna është ende një mënyrë e zakonshme e sjelljes në ndërveprimin njerëzor, e bazuar në supozimin se konfliktet mund të trajtohen me sukses me mjete të dhunshme në mënyrë që të arrihet ndryshimi i dëshiruar. Kjo paradigmë nuk është e saktë vetëm për konfliktet ndërkombëtare apo civile, por gjithashtu mund të shihet edhe në shumë konflikte ndërpersonale..

Kultura e dhunës është konstante në historinë njerëzore, e cila vazhdimisht inkurajohet dhe mbështetet nga imazhet e dhunës dhe nga luftërat në jetën e përditshme. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj këtyre imazheve përforcon paradigmën e dhunës dhe mundohet që ta racionalizoj qëndrimin se nuk ekziston alternativë ndaj kësaj qasjeje. Kjo paradigmë normalizon dhunën si një mjet për të përballuar konfliktet në shoqëri dhe midis shteteve.

Në qoftë se supozojmë se paradigma e dhunës është model njerëzor i fituar dhe i mësuar i mendimit dhe sjelljes, atëherë mund të supozojmë se edhe një mënyrë tjetër e përballimit të konflikteve gjithashtu mund të mësohet. Ideja për arsimin për paqe është promovuar nga ana e mendimtarëve, mësuesve dhe aktivistëve progresiv në periudha të ndryshme të historisë.

Qasje të ndryshme arsimore

Duke pasur parasysh këtë, në dekadat e fundit janë zhvilluar dhe përdorur shumë qasje të ndryshme arsimore në përpjekje për të përballuar qëndrimet dhe sjelljet e dhunshme të njerëzve. Ndër qasjet më të njohura janë arsimi gjinor, arsimi qytetar, arsimi për të drejtat e njeriut, arsimi ndërfaqësor si dhe arsimi global. Ajo që është e përbashkët për këto qasje është se të gjitha kanë për qëllim të promovojnë tolerancën, diversitetin, të inkurajojnë dhe ti përforcojnë përgjegjësitë individuale dhe shoqërore në sferat personale, sociale dhe ekologjike të ndërveprimit njerëzor.

Kohët e fundit, ideja për arsimin paqësor ka fituar popullaritet dhe është bërë gjerësisht i njohur si një formë e re e arsimit e cila ka për qëllim ta ndryshojë paradigmën nga një kulturë dhune në një kulturë paqeje. Por, ashtu si me shumë ide dhe qasje të reja, edhe në këtë fushë ka shumë paqartësi rreth asaj se çfarë në të vërtetë është arsimi paqësor dhe cilat forma mund ti ketë. Kështu që, edhe pse shpejt fiton popullaritet, ajo vuan nga një nivel i ulët i konceptualizmit,

dallimeve në cilësi dhe njohje, si dhe mungesa e të kuptuarit të qëllimit të tij dhe qartësisë rreth vendit të tij në fushën më të gjerë të punës paqësore.

Rrjedhimisht, duket se është kyçe për çdo edukator paqësor të zhvillon kuptim të vetin konceptual të arsimit paqësor e cila duket e përshtatshme për kontekstin në të cilin vepron. Për këtë arsye, më poshtë është bërë një seksion i një nocioni të arsimit paqësor për të ilustruar gjërat e rëndësishme në mbështetjen e edukatorëve paqësor në dizajnimin e kornizës së tyre personale për arsimin paqësor.

Përkufizimi i paqes

Për shumë edukatorë të paqes, është treguar e dobishme nëse përdorin përkufizimin e tyre për paqe si një pikënisje për përkufizimin e arsimit paqësor. Kjo është e dobishme nga një arsye e thjeshtë, sepse përderisa e dimë se çka nënkuptojmë me nocionin e paqes, lehtë mund të konkludojmë se ç'është arsimi paqësor apo arsimi për paqe.

Autori i këtij teksti me fjalën paqe nënkupton proces pjesëmarrës jo të dhunshëm që synon të reduktoj të gjitha format e dhunës dhe të krijoj kushte për mirëqenie të brendshme, sociale dhe ekologjike.

Përkufizimi thekson se paqja synon të krijojë mungesën e të gjitha formave të dhunës në një proces jo të dhunshëm dhe jashtëzakonisht inkluziv. Kjo nuk do të thotë se paqja nuk përfshin konflikte, sepse konfliktet janë pjesë e jetës së përditshme, por ato konflikte përballohen me mjete jo të dhunshme dhe në mënyrë participative. Përveç kësaj, që paqja të jetë e plotë, duhet të arrihet paqe në tre dimensione që në thelb e përbëjnë botën:

- ♦ sfera e brendshme e jetës njerëzore;
- ♦ sfera sociale - ndërveprimet midis individëve, grupeve, organizatave, shteteve;
- ♦ sfera e mjedisit jetësor- i gjithë mjedisi biologjik në dhe rreth tokës, duke përfshirë të gjitha qeniet e gjalla dhe të pajeta .

Këto dy shtylla, jo dhuna dhe ekocentrizmi bazohen në paqe të tillë, për të cilin të dyja kontribuojnë me vlera dhe praktikë thelbësore.

Jo-dhuna në nivel individual holistik udhëhiqet nga parimi i mos lëndimit të asnjë krijese të gjallë, duke përfshirë edhe veten dhe përshtatjen e sjelljes së përditshme dhe aktivitetet e këtij parimi . Jo-dhuna në nivel social, gjithashtu, kuptohet si mjet për arritjen e një ndryshimi politik apo shoqëror dhe në rastin ideal ajo përfshin vizionin holistik të jo-dhunës brenda grupeve që i implementojnë veprimet e tilla, si dhe të çdo individ që është pjesë e lëvizjeve të tilla.

Ekocentrizmi i hedh poshtë qëndrimet dhe sjelljet antropocentrike dhe me këtë e zgjeron zonën për kujdes përmes shikimit më të gjerë të sferës njerëzore dhe promovim të barazisë ndërmjet të gjitha qenieve të gjalla dhe mjedisit jetësor .Në thelbin e saj, ekocentrizmi e hedh poshtë superioritetin e njerëzve mbi natyrën. Ai është kritik për ndikimin njerëzor në rrethinën në aspekt filozofik, ekonomik, sociologjik dhe politik.

Nëse paqja bazohet tek këto dy shtylla, atëherë arsimi paqësor, si çdo punë tjetër paqësore, duhet të shikoj tek këto dy shtylla si pjesë të tij integrale në qasjen metodologjike dhe kornizën e veprimit.

Definimi i arsimit paqësor

Sipas përkufizimit të mësipërm të paqes, arsimi paqësor duhet të jetë një instrument i cili do ta promovojë dhe inkurajojë paqen në tri dimensionet e paqes së brendshme, sociale dhe ekologjike, sidomos përmes ndërtimit të kompetencave të individëve- pa marrë parasysh nëse ato janë aktivistë paqësor që janë të përfshirë ose punojnë në organizata civile ose qeveritare, apo thjesht janë njerëz që duan të bëhen më paqedashës në jetën e tyre të përditshme.

Në këtë kuptim, arsimi paqësor është çdo aktivitetet arsimor holistik, multidisiplinar dhe transformues i cili kontribuon në zhvillimin e kompetencave për jetesë dhe ndërtimin e paqes.

Të jetosh në paqe (Living peace) u referohet kompetencave që janë të lidhura me të jetuarit në harmoni, në përputhje me veten, me qeniet e tjera të gjalla dhe mjedisin, në nivel lokal dhe global . Kompetencat e mundura që arsimi po përpiqet ti forcojë për të jetuar në paqe janë:

- duke qenë jo të dhunshëm, apo aftësia për përmbajtje nga përdorimi i dhunës në jetën e përditshme, si për shembull, të bëhen zgjedhje informative dhe të vetëdijshme ose sjellje të padhunshme drejt anëtarëve të familjes dhe moshatarëve;
- transformimi i konflikteve në jetën e përditshme, aftësia për të përdorur shkathtësitë për transformimin e konflikteve në jetën personale dhe shoqërore;
- angazhimi në mjedisin / botën, për shembull, aftësitë për ta përshtatur stilin personal të jetës për ndarje më të mirë të planetit me gjallesat tjera ;
- hulumtimi i identiteteve dhe pranimi i divergjencave, si për shembull, aftësia për përballimin e paragjyqimeve personale dhe respektimin e kulturave dhe qenieve tjera.

Ndërtimit i paqes u referohet kompetencave të cilat janë të nevojshme gjatë organizimit, planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve paqeruajtëse. Kompetencat specifike në këtë fushë për arritjen e paqes janë:

- planifikimi, monitorimi dhe evaluimi i aktiviteteve për arritjen e paqes, si për shembull, aftësia për të identifikuar nevojat e komunitetit, planifikimi i aksioneve jo të dhunshme dhe vendosjen e objektivave në kontekstin e dhënë nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarës;
- transformimi i konflikteve, si për shembull, aftësia për të angazhuar të tjerët në procesin e ndërtimit të komunitetit nëpërmjet motivimit të tyre për tu kujdesur për bashkëjetesë paqedashëse dhe të bëhen pjesë e procesit të arritjes së paqes;
- implementimi dhe organizimi i aktiviteteve për arritjen e paqes, si për shembull, aftësia për të vepruar si ndërmjetësues – palë i jashtëm në konflikt dhe për të krijuar mundësi për marrëveshje bashkë me palët në konflikt;
- inkurajimi dhe ruajtja e paqës, si për shembull, aftësia për të lidhur iniciativat përkatëse qytetare dhe institucionet në kontekstin specifik të konfliktit në mënyrë që të ndihmojnë në funksionimin e qëllimeve të përbashkëta.

Jeta dhe arritja e paqes është proces i njëjtë dhe nuk mund të ndahet nga njëri-tjetri. Është e rëndësishme për ata që e mësojnë atë, jo vetëm të dinë se si të praktikojnë bashkëveprimin pa

qësor në jetën e tyre të përditshme me mjedisin e tyre, por edhe si të përballen me padrejtësitë ekzistuese dhe shkeljet e potencialeve për zhvillimin e të gjitha qenieve të gjalla dhe mjedisit përmes mjeteve proaktive që ushqejnë dhe inkurajojnë paqen dhe arritjen e paqes.

Me këtë qasje të dyfishtë, arsimi paqësor është një program i zhvillimit personal, por edhe një program që na forcon. Përpiqet për kontribut në një proces transformues të bazuar në vlerat në një nivel personal dhe në kontekst më të gjerë social dhe ekologjik.

Karakteristikat e arsimit paqësor

Disa aspekte të arsimit paqësor janë të rëndësishme për të kuptuar natyrën e tij dhe veprimet arsimore. Këto janë fokusi i zhvillimit të kompetencave, qasja e tij holistike dhe multidisiplinare dhe karakteri transformues.

Arsimi paqësor përqendrohet edhe në zhvillimin e kompetencave pavarësisht transformimit të njohurive apo trajnimit të pjesëmarrësve me shkathtësi të veçanta. Në këtë kontekst kompetencat i përcaktojmë si një kombinim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.

- Njohuri - gjëra që dikush i njeh dhe i kupton në bazë të përvojës ose të mësimnxënies.
- Shkathtësi - aftësia për të ndërmarrë veprime ose për të bërë diçka në bazë të praktikës.
- Qëndrimet - mënyra të krijuara të menduarit dhe ndjeshmëria për ndonjë gjë, duke përfshirë edhe mënyrat e sjelljes dhe vlerat mbi të cilat janë bazuar.

Arsimi paqësor synon të zhvillojë kompetenca për sferat komplekse dhe të ndërvarura nga jeta njerëzore - sferën e brendshme, të dimensionit social dhe mjedisor të jetës dhe natyrisht duhet të jetë tërësor dhe multidisiplinarë. Në përputhje me atë, arsimi paqësor thekson zhvillimin holistik të mendjes, zemrës dhe trupit, i stimuluar dhe mbështetur nga mësimi njohës (racional), emocional dhe i prekshëm. Për më tepër, ajo përfshin edhe një gamë të gjerë të formave të ndërlidhura të arsimit, duke përfshirë për shembull, ngritjen e vetëdijes për çështjet sociale mjedisore, arsimim që inkurajon dhe nxit zhvillimin personal, arsim i bazuar në shkathtësi për përballim jo të dhunshëm me situatat jetësore dhe angazhim jo të dhunshëm, e cila kontribuon në shkathtësi për jetesë dhe arritjen e paqes në aspekte të ndryshme.

Kështu, arsimi paqësor është formë transformuese e arsimit që synon të ndryshojë mënyrën se si njerëzit ndihen, mendojnë dhe si sillen, në mënyrë të veçantë të çrrënjës dhunën si një mjet të pranuar shoqërorë të menaxhimit të konflikteve duke forcuar modele jo të dhunshme të menduarit dhe sjelljes ndaj vetes, ndaj të tjerëve dhe mjedisit.

Vërejtje përfundimtare

Nga konstatimi i kuptimit holistik i arsimit paqësor mund të veçohen disa pyetje për çdo edukator / mësues që do të donte ta zhvillonte kornizën e vet për punën e tij për arsimin paqësor.

Konteksti:

- Cili është konteksti i përgjithshëm shoqëror në të cilin punoj?
- Cilat konflikte ekzistojnë në kontekstin tim dhe pse?

- ♦ Cilat janë format më të theksuara të dhunës në kontekstin tim dhe në cilat duhet punuar?

Grupi i synuar:

- ♦ Me cilin grup të synuar mund të punoj apo do të dëshiroja të punoja dhe pse?
- ♦ Cilat janë sfidat e grupit tim të synuar?
- ♦ Cilat janë nevojat dhe qëllimet e tyre arsimore?

Qëllimi:

- ♦ Cili është ndryshimi që dua ta shoh në kontekstin tim?
- ♦ Si mund arsimi paqësor të kontriboj për një ndryshim të tillë?
- ♦ Cilat kompetenca nxënësit e mi duan ose kanë nevojë ti fitojnë?

Korniza teorike:

- ♦ Si i kuptoj konceptet kyçe të punës së paqes? (p.sh. konflikti, paqja, ndryshimi, etj.)
- ♦ Cili është roli i arsimit paqësor në kontekstin më të gjerë të ndërtimit të paqes?
- ♦ Cilat vlera e mbështesin kuptimin tim të paqes dhe si duhet ata të pasqyrohen në qasjen time arsimore për arsimin paqësor ?

Qasja arsimore:

- ♦ A është konteksti im arsimor formal apo joformal?
- ♦ Cila qasje arsimore më shumë i përshtatet grupit tim të synuar?
- ♦ Si mund të krijoj një mjedis për të mësuar e cila pasqyron vlerat e mia dhe kuptimin tim për paqen?

Sebastian Shvajcer është menaxher projekti në Forumin Inter-kulturor Evropian, trajner dhe konsultant i cili që nga viti 2003 punon në Sektorin e Paqes dhe Arsimit. Ka kryer shkenca politike dhe ka filluar të punojë në edukimin qytetar në Gjermani.

Në vitin 2006 ai e fokuson punën e tij në Kaukazin Jugor dhe Ballkanin Perëndimor. Sebastiani faciliton seminare dhe trajnime në tema si që janë: ndërtimi i paqes, transformimi i konflikteve, pjesëmarrja aktive dhe edukimi qytetar për aktivistët e shoqërisë civile, të rinjtë dhe organizatat qytetare.

Nga viti 2011 deri në vitin 2013 Sebastiani e komenaxhoi Programin për arsim paqësor për mësime nxënësive në Maqedoni dhe prej atëherë hulumton dhe edukon për arsim paqësor. Aktualisht qëndron në Tbilisi, Gjeorgji dhe mbështet një gamë të gjerë të iniciativave të shoqërisë civile nëpërmjet trajnimeve dhe mbledhjes të mjeteve financiare.



3. ARSIMIMI PAQËSOR NËPËR SHKOLLA SI MUNDËSI E JO SI BARRË SHITESË

Për nocionin

Nocioni arsimimi paqësor pak nga pak po hyn në fjalorin e shoqërive tona. Më së shpeshti identifikohet me format e ndryshme të arsimimit qytetar, por të udhëzuarit kanë një pasqyrë më të qartë se nuk bëhet fjalë për të njëjtën, nganjëherë as për së afërmi me këtë arsimim. Arsimimi qytetar pohon se për nga vlera është neutrale, se i aftëson nxënësit për t'u gjendur, për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, përpiket që mos të imponojë sistem të vlerave. Arsimimi paqësor për nga vlera është e përcaktuar vetvetiu dhe nuk mund të jetë neutrale për cilëndo çështje.

Në vend që të kontestohemi rreth përshtatjes me arsimimin qytetar dhe me lëndët e ngjashme, të vendosim në shikim të parë disa pyetje të thjeshta: Çka është arsimimi paqësor? Cili është qëllimi i tij? Si realizohet?

Në dispozicion kemi një numër të librave, definicioneve, interpretimeve se çka është arsimimi qytetar e çka nuk është. Ky libër bën pjesë në këtë shoqërim. Problemi me definicionet është se ato na vijnë nga njerëzit tjerë, te arsimimi qytetar kjo bëhet problem. Dhe jo vetëm një problem i vetëm.

“Arsimimi qytetar është proces i tërësishëm pjesëmarrës që përfshin mësimin për demokracinë dhe për të drejtat e njeriut, për jo dhunën, për të drejtën sociale dhe ekonomike, për barazinë gjinore, për zhvillimin e qëndrueshëm, për çmilitarizimin, ndërtimin e paqes, të drejtën ndërkombëtare dhe për sigurinë njerëzore²⁾” – kanë konkluduar qytetarët e vetorganizuar nga apeli i Hagës për paqe në vitin 2000.

Qëllimi i arsimimit paqësor është çlirimi i personalitetit nga prangat e padukshme të mjedisit (dhunës kulturore dhe strukturore), aftësimi që në mënyrë të pavarur të veprojë në parandalimin e dhunës, shfrytëzimit, kujdesit për mjedisin, duke inkurajuar dinjitetin e secilës jetë.

Të veprohet në parandalimin e dhunës, para së gjithash është një vendim me vlerë. Më së paku racional. Dhuna dhe padrejtësia na dhembën dhe nuk mund të qëndrojmë pasivë. Kuptohet se ndihmon dituria që të njihet dhuna, posaçërisht ajo e padukshme, jodirekte, jo fizike.

Arsimimi paqësor më së paku ka për qëllim që të mësojë për zgjidhjet, të ofrojë receta, përgjigje të sakta. Më shumë i intereson reflektimi i realitetit, i intereson që t'i dëgjojë të gjitha palët e përfshira, i intereson që t'i kuptojë motive dhe nevojat. Ky nuk është vetëm transformim jo i dhunshëm i konflikteve. Është edhe gjithashtu vetëdije për zhvillim të qëndrueshëm, interes për ndryshimin e klimës që sjell vërshime, shkatërron toka, shtëpi, njerëz. Na befason ndryshimi i periudhës së thatësirave dhe vërshimeve, përzierja e stinëve të vitit. Arsimimi qytetar nuk dëshiron të jetë i verbër ndaj ndryshimeve që ndodhin në shoqëri.

Në shkollë

Çfarë mund të bëjë arsimimi paqësor, kjo duhet t'i interesojë secilit arsimtar, secilës arsimtare? Para të gjithave, lehtësim. Nëse është barrë, obligim shtesë, caku është gabuar. Ndhmë në mësim. Të shihen nxënësit si bashkëpunëtorë, të shihet vetvetja si person i rritur jo i përsosur i cili e nxit zhvillimin e të rinjve. Të shihen prindërit si ndihmës/bashkëpunëtorë, kënaqja në nxitjen e

²⁾ Sipas fushatës Globale për arsimim për paqe, Hague Appeal for Peace, 2000.

zhvillimit të tyre. Raporti me instancat kompetente (drejtoresha, inspektorë, agjenci dhe ministri) që është i shëndoshë e nuk është i varur. Ata janë këtu që të më ndihmojnë mua, personalitetit që është në kontakt të drejtpërdrejtë me më të rinjtë, me nxënësit. Personaliteti që ka përgjegjësi më të madhe dhe ndikim në formimin e tyre.

Me siguri problemi më i madh i arsimit paqësor nëpër shkolla është ajo se shkollat e sotme ende janë jodemokratike. Nxënësit nuk kanë ndikim mbi çështjet më të rëndësishme: plaet dhe programet, zgjedhjen e arsimtarëve, zgjedhja e burimeve të informimit, shpërndarja e orëve, madhësia e paraleleve. Klasat janë sikurse kutia dhe mesazhi për „shabllonizim“ vështirë që mund të fshihet. Le të paramendojmë klasa rrethore dhe ulje në rrathë në një hapësirë përplot me dritë natyrore; kohëzgjatja e orëve që nuk është e përcaktuar në mënyrë të prerë, por e përshtatur sipas temës, për nxënësit, për momentin.

Sjellja e vendimeve në shkollë është ngushtë e lidhur me arsimimin paqësor. A po i aftësojmë njerëzit e rinj për vendimmarrje në pjesëmarrje ose të bëjmë qytetarë të dëgjueshëm? A duam luftëra nesër ose jo? Nuk ka luftëra pa dëgjueshmëri. Parashtrimi i pyetjeve është problemi më i madh i secilës ushtri. “Nuk je këtu të mendosh, por t’i kryesh urdhrat” është fjalia e njohur për secilin që ka qenë në ushtri. „Nuk je këtu që t’i kryesh urdhrat, por të mendosh“ –duhet të jetë motoja e arsimit paqësor. “Dhe të veprosh”, do të kishte shtuar.

Le të pyetemi nga pozita e arsimit qytetar: cili është roli i shkollës?

Sido që të jetë përgjigjja, do të jetë e fokusuar te nxënësit? Shkolla dëshiron diçka prej tyre. A është kjo krejt përgjigjja? Ku janë arsimtarët? Shkolla a nuk është vendi për interaksionin e tyre – me nxënësit, reciprok dhe me bashkësinë? Vini re – interaksion me nxënësit. Reciproke. Edhe pse të gjithë arsimtarët do t’jua vërtetojnë se “edhe ata fitojnë, mësojnë prej nxënësve të tyre”, prapë këtë do ta shikojnë si “efekt anësor” e jo si qëllim primar. A nuk është me rëndësi të jashtëzakonshme që të vetëdijesohet se arsimtarët nëpër shkolla fitojnë, këmbëjnë e mësojnë shumë nga nxënësit? Nxënësit që janë të vetëdijshëm se në shkollë japin shumë, ata bëhen qytetarë të vetëdijshëm. Çfarë japin? Kuptohet, nuk mendoj në përgjigjet e sakta të pyetjeve të arsimtarëve. E japin atë që arsimtarët nuk e kanë –qasjen në jetën e gjeneratave të reja, ndryshime aq të shpejta, aq të ngadalshme dhe shpesh shokuese që i bart jeta në erën digjitale, energji, entuziazëm, pasion të cilën e ka vetëm rinia.

Përse shkolla nuk është vendi për këmbim? Përse e kemi të vështirë që ta kuptojmë atë se nxënësit e sotëm vijnë nga shekulli 21, ndërsa ne arsimtarët ende kemi ngelur në shekullin 20 ose madje në shekullin 19?

Roli i arsimtarit në arsimimin paqësor nuk është që t’i respektojë nxënësit për tema të caktuara. Harrojeni këtë. Mjerë për ju dhe mjerë për nxënësit.

Roli i arsimtarëve është që të kënaqen në mundësitë e transformimit individual, në transformimin e shkollave dhe të vetë shoqërisë në diçka vërtetë njerëzore, ekologjike dhe miqësore, vend jo i dhunshëm për të jetuar, për të festuar jetën.

Kam frikë të shkruaj se shkollat duhet të bëhen tempuj të njerëzisë, për shkak të të gjitha konotacioneve të mundshme fetare. Por shkollat e kanë potencialin e tyre për transformim, për çlirim, për krijimin e vizionit të botës pa dhunë e padrejtësi. A nuk është kjo ëndërr e secilit

fëmijë? Bashkë me rolin e saj/tij në realizimin e asaj ëndrre. Le të fillojmë bashkë që ta realizojmë, në vend që ta varrosim që nga fillimi.

Ndoshta pikërisht për këtë shkak, shkollat janë vende për disiplinimin e njerëzve, për vrasjen e vetëdijes së tyre, për kreativitetin, diversitetin. Uniformimi, shabllonizimi. Shkollat janë tredhur (janë bërë të paaftha) për shkak se janë të rrezikshme. Kuptohet se çdo pushtet do të ketë ndikim nëpër shkolla. Përse do të kishte? Çfarë lidhje ka kjo se ndoshta unë nesër do të bëhem kryeministër dhe me këtë do ta kam të drejtën që të vendos se çka dhe si do t'ju transmetohet fëmijëve si e rëndësishme? Prej nga kjo e drejtë faranoike në një shoqëri demokratike?

Shkollat sikurse gjykatat dhe mediumet a nuk duhet të jenë të pavarura nga politika? E di se pyetja ju shkakton neveritje, ndoshta edhe tërheqje, por po flas për qëllimin e arsimit paqësor. Të çlirojë. Të parashtojë pyetje. T'i sfidojë autoritetet, autoritetet e fuqishme. T'i inkurajojë të dobët. Arsimimi paqësor nëpër shkollat sot kurrësi nuk është mësim plotësues. Nuk është as "përmbajtje kroskulikulare." Jo nuk është, a po kuptoni? Nuk është.

Ky është djepi i shkollës çfarë na duhet, me qëllim që kurrë mos të kemi luftëra, dhunë dhe eksploatim. Kjo është fara e shpresës për transformim të botës në atë mënyrë që nuk guxojmë të besojmë se është i mundur. Frika jonë është problem, heqja dorë nga ana jonë prej ëndrrave, pajtueshmëria jonë për atë që është për momentin e mundur.

Arsimimi paqësor është gëzim, forcim, lojë intelektuale dhe emocionale dhe nëse nuk shpresojmë dhe nuk i gëzohemi, atëherë ajo nuk është ashtu.

Arsimimi paqësor është mënyrë se si arsimtarët të bëhen më të lirë nëpër shkolla, dalje nga situata në të cilën "nuk dimë se si t'ia dalim me nxënësit", fund i erës kur me nota e kontrollojmë ardhmërinë që vjen – të rinjtë. Fillimi i gjendjes në të cilën nxënësit dhe arsimtarët do t'i gëzohen takimit, në të cilën mësimi është gëzim, festë e vërtetë e një bashkësie, triumf i kureshtjes, valle e kreativitetit.

Shkolla dhe bashkësia

Shkolla në bashkësi? Në shkollat fillore të cilat gjenden afër bashkësisë, ky koncept funksionon. Por si është puna me shkollat e mesme?

Interaksioni me bashkësinë shpesh lidhet me pyetjet nga profesioni ose nga shteti, rregullat e caktuara të sjelljes lidhur me festat shtetërore e të ngjashme.

Por ai është shumë më i madh. Çdo shkollë e mesme ka disa përmbajtje që e shoqërojnë përreth: furra, objekte për ushqim të shpejtë, shitore, kafene, fotokopjore, për fat të keq nganjëherë edhe dilemë, kriminelë, individë të marginalizuar në shoqëri të cilët – për dalim nga shumica prej nesh – shkollën e perceptojnë drejtë: si vend ku rritet dhe zhvillohet jeta, ku marrin hov dhe rriten dashuritë mes të rinjve, vend për ahengje dhe gëzim të rritjes, liri e caktuar, pa derte të cilën firmat dhe institucionet tjera nuk e kanë.

Njohja e atij rrjeti social, lidhja me aktorët, përfshirja e të rinjve (teatri në afërsi, klubi i zhytësve, të pastrehët etj), ndjenja e lidhjes me bashkësinë – çka? Ndërtimi i infrastrukturës paqësore në shoqëri. Nuk është vetëm fitimi motivacion për punë dhe lidhje, por edhe kujdesi për tjetri, për të rinjtë, për të dobët, posaçërisht për rininë pa dhunë.

Sa është shkolla e hapur për prindërit? Sa përmbajtje ua ofron prindërve? Sa jemi të gatshëm që të hapërojmë nga ankesat e përditshme se “prindërit nuk e kanë dert?” Nuk e kanë dert? Për çfarë? Për zhvillimin e fëmijëve të tyre? Ose nuk duan që të humbin kohë nga sistemi autoritar i shkollimit ku nuk ekziston liria e krijimit (formimit) të përmbajtjeve, as vullnet për këmbim. Si ta tërheqim babanë e djalit “problematic” në shkollë? Ashtu duke e përkujtuar se edhe vetë ka qenë problematic? Ose se si sot është i pasuksesshëm, pa punë, pa vetëbesim? Çfarë i ofrojmë? A i thërrasim në shkollë që t’i dëgjojmë? Ose që t’ju themi se “duhet të kujdesen më shumë?” Se duhet ta bëjnë atë që nuk e dinë – që të gjenden në botën në të cilën janë humbës?

Arsimimi paqësor është orientuar kah bashkësia. Kjo u ndihmon arsimtarëve që me lehtësi t’ju gasen aktorëve nga bashkësia. Ju ndihmon që mos t’i dëshpërojë tërheqja e atyre aktorëve. E kthen besimin në ndryshim, e riafirmon vlerën e ëndrrave fëmijërore. Shkolla nuk është ujdhesë. Nuk ekziston jashtë kohës dhe hapësirës. Lidhja me bashkësinë në të cilën vepron është e domosdoshme. E di se ajo shpesh mungon, posaçërisht nëpër shkollat e mesme. Kjo duhet të ndryshojë. Shkolla e hapur i shërben bashkësisë, njerëzve kjo ju kthehet. “Mënyra bashkëkohore e jetës ka sjellë tjetërsimin. Njerëzit janë në garë të përherëshme.” Këto janë fjalitë e para dyzet viteve. Si është sot? Janë ndërprerë lidhjet me shoqëritë tona. Nuk janë vetëm luftërat shkaktar për këtë. Shoqëritë (kinse) janë demokratizuar, por njerëzit jetojnë më keq se më parë. Duke mos hyrë në analizat politike, është fakt se jetojmë në erën e teknologjisë digjitale. Fëmijët sot kanë telefona të mençur. Me to e incizojnë dhunën, bëhen të rëndësishëm për shkak të kësaj. Ka shumë pak arsimtarë të cilët dinë se si të merren me ngjarjet nga bota virtuale. Edhe numri i prindërve është i vogël. Ndryshimet janë shumë të shpejta, frustrimet në shkollë janë të shumanshme, shpesh del se askush askënd nuk e kupton – rolet janë ndërruar dhe askush për këtë nuk na ka njoftuar.

Përmbajtjet

Arsimtarët të cilët janë të interesuar për arsimimin paqësor në shkollë, shpesh pyesin: Si ta di se një aktivitet në shkollë është paqësor? Cilët janë treguesit? Si mos të humbet, si mos të bëhet gabim?

Ata më të shkathët drejtohen për ndihmë te edukatorët paqësorë më me përvojë. Por, përgjigjet janë para syve tanë – t’i pyesim vetë nxënësit. Çka ju pengon? Çka u është imponuar? Çka mendojnë për përmbajtjet? Cilat mesazhe ua sjellin? Cili aktivitet i ndryshon raportet e fuqisë? Cili aktivitet vendos raporte më të drejta? Cili aktivitet jep përgjigje për dilemat e vërteta, për problemet e të rinjve? Cili aktivitet inkurajon që ta kundërshtojmë më të fuqishmin, padrejtësinë?

Shkolla jodemokratike nuk mund të mësojë për demokracinë, posaçërisht jo për arsimimin paqësor. A duhet të heqim dorë? Ose të presim? Fillimisht të demokratizohen shkollat e pastaj të “futet” arsimimi paqësor? Si të demokratizohen? Me vetëm arsimimin paqësor. Kjo nuk është bartje e diturive, aftësive dhe qëndrimeve te nxënësit. Është këmbim, rishqyrtim, bashkëpunim.

Është e kuptueshme, arsimtarët interesohen për përmbajtjet e arsimimit paqësor. Sa janë ato tema të nxehta, aktuale e shoqërore, sa janë të lidhura për luftërat, si për ato të kaluara, ashtu edhe për luftërat aktuale që nuk duam të na ndodhin.

Përgjigjet nuk janë të lehta. Në përgjithësi pranohet se përmbajtjet duhet të jenë të harmonizuara me problemet konkrete në shoqëri. Kështu, arsimimi paqësor në Lindjen e Afërt, në Irlandën

Veriore ose në Ballkan nuk mund t'i anashkalojë konfliktet e dhunshme nëpër të cilat kanë kaluar ose kalojnë ato shoqëri. Në vendet e zhvilluara duhet të punohet në përgjegjësinë e të pasurve për gjendjen nëpër vendet e varfra në botë, raporti ndaj emigrantëve, politikave ekonomike që janë vazhdim i idesë mentale paskolonialiste.

Këtu arrijmë deri te përfundimi se një pjesë e përmbajtjeve duhet të jetë specifik për një mjedis të caktuar, ndërsa një pjesë universal për gjithë planetin. Përmbajtjet janë të rëndësishme, por mënyra e përpunimit të tyre është më e rëndësishme. Po e përsëris se në ndërtimin e paqes më e rëndësishme është “SI?” sesa “ÇKA?”

Ndryshimi i paradigmës

Respektoi më të moshuarit – na kanë mësuar që në vegjëli. Respektoje personalitetin, na përmirëson arsimimi qytetar. Integriteti i personalitetit, etika e saj, guximi, përpjekja për më të dobëtin, për tjetrin më ndryshe le të jetë shembull e jo numri i viteve të dikujt.

Bëhu mashkull/femër, çka do të thotë kjo sot? Si të pajtohen tradita, gjenetika, biologjia me realitetin? Të ecet nga hipokrizia e shoqërisë, frika të jemi ata që jemi dhe edhe më me rëndësi – t’ua lejojmë të tjerëve të janë ajo që janë.

Raportet e fuqisë nëpër shkolla janë vendimtare. Kush sjell vendime dhe si? Fuqia vjen prej lartë drejt poshtë, shteti (ministra) përcakton, arsimtarët si nëpunës shtetërorë realizojnë, ndërsa nxënësit (shtetasit) miratojnë.

Si na duket e gjithë kjo? Sa është hapësira për shtetasit që të marrin pjesë në krijimin e ardhmërisë vetanake/ shoqërisë?

Sërish po them se për arsimimin paqësor është vendimtare atmosfera në shkollë, përjetimi i shkollës si vend për krijimin e ardhmërisë së bashkësisë dhe shoqërisë, përforcimi i arsimtarëve që lirisht të punojnë në nxitjen e rritjes dhe zhvillimit të nxënësve të tyre.

Arsimimi paqësor në Maqedoni sikurse edhe në vendet tjera të cilët kanë kaluar nëpër konfliktet e armatosura, padyshim është e lidhur me ndërtimin e paqes. Kjo shkurt do të thotë bashkëpunim. Shoqëria në të cilën bashkëpunohet në mënyrë intensive është shoqëri që nuk prodhon luftë, as që ka kërcënime për/nga lufta. Përkthyer në kontekst të arsimimit paqësor, kjo do të thotë se ai duhet të ketë për qëllim nxitjen e një numër të bashkëpunimeve: mes vetë nxënësve, nxënësve me arsimtarët, nxënësit me prindërit, nxënësit me bashkësinë, shoqërinë.

Këtë pjesë pak a shumë mund ta njohim.

Por, si është puna me bashkëpunimin mes arsimtarëve, arsimtarëve dhe nxënësve (nuk është e njëjtë sikurse nxënësit me arsimtarët), arsimtarët me trupat kompetente shtetërore, arsimtarët dhe prindërit, arsimtarët dhe bashkësia?

Për këtë, e dimë, nuk ka kohë. Arsimimi paqësor duhet të na e kthejë. Mësimi i sotëm i specializuar nuk parasheh bashkëpunimin mes arsimtarëve në një masë të konsiderueshme. Në të njëjtën lëndë apo të përafërt – po. Por, si, përse do të kishin bashkëpunuar arsimtari i fizikës dhe ai i gjuhës maqedonase?

Në këtë pyetje nëpër shkollat e sotme është vështirë të përgjigjemi me kuptim dhe menjëherë. Në shkollën e re deri te e cila na ndihmoi që të vijmë arsimimi paqësor, vetë pyetja bëhet e pakuptimtë.

Bashkëpunimi na duhet sepse në procesin e mësimi dhe aftësimit për jetë të nesërme me përgjegjësi dhe të frytshme, janë të inkuadruar të njëjtit fëmijë, nga e njëjta shkollë, nga rrethina e njëjtë.

Qëllimi i mësimi është i njëjtë, përgatitja cilësore për jetë dhe për jetë më cilësore që sot, në procesin e rritjes përplot me sfida.

Arsimtarët nuk e kanë lehtë për shkak se kompetencat e tyre si mësues dhe edukues i absorbojnë kryesisht nga profesioni dhe përvoja, por në shoqëritë të cilat ndryshojnë shpejtë, përvoja mund të jetë edhe pengesë.

Dalja është në ndryshimin e paradigmës së të mësuarit. Roli i arsimtarëve është që ta lehtësojnë procesin e të mësuarit, të përgatisin për sfidat e jetës. Në erën e internetit, arsimtarët më nuk janë burim i diturisë, ata janë ndërmjetës, fasilitatorë.

Nxënësit duhet të aftësohet për t'u gjendur. Këtu vijmë deri te lajmet e mira. Sot të rinjtë janë më të aftë në përdorimin e internetit dhe komunikimeve tjera digjitale. Për fat të keq, kjo është e kuptueshme, kjo i frikëson arsimtarët për shkak se i bën që të ndjehen jokompetentë, pa autoritet. Dituria është diku në vendin e dytë dhe nuk është më monopoli i tyre.

Nxënësit – bartësit e procesit

Lajm i mirë është se të rinjtë me anë të përdorimit të telefonave të tyre të mençur, Viber, Tuitër, Fejsbuk dhe kanaleve tjera të komunikimit, janë të familjarizuar me internetin – me burimin më të madh të diturisë në planet. Shakaja thotë se njerëzit sot të cilët kyçen në këtë burim të diturisë, në vend që ta përdorin për mësim, për zhvillimin dhe mirëqenien e tyre, ata i bëjnë këto dy gjëra: në të vendosin fotografite e maceve të tyre dhe zihen me njerëzit të cilët nuk i njohin.

Këtu arrijmë deri te roli i arsimtarit sot dhe deri te roli i arsimit paqësor. Fotografia e maces time është pjesë e privatësisë time që ka rëndësi për mua dhe me të cilën nuk di se si të sillem në botën e lidhur digjitale. Zënkat me njerëzit e panjohur nëpër platforma të ndryshme është shprehje e nevojës për komunikim jashtë sferës time private të sigurt, por edhe e frikës nga ai komunikim.

Arsimimi paqësor transmeton mesazhin se njerëzit tjerë nuk janë kërcënim për ne. Sjellja e tyre mund të jetë kërcënim njëjtë sikurse edhe sjellja jonë që mund të jetë kërcënim për të tjerët. Diversiteti nuk është kërcënim, ai është domosdoshmëri gjatë lidhjes së shpejtë të njerëzve të cilët deri para do kohësh kanë qenë aq larg geografikisht, në aspektin klasor, social, kulturor, në aspektin e vlerave.

Shkurt vijmë deri te qëllimet kryesore të arsimit paqësor:

- të përgatiten, aftësohen dhe forcohen njerëzit e rinj për raport të shëndoshë bashkëpunimi me njerëzit tjerë, pa dhunë, me respekt të ndërsjellë;
- ngjashëm, vetëm në raport me strukturat shoqërore, duke e kuptuar strukturën e pushtetit, rolin e tij që të na shërbejë, obligimi jonë që ta kontrollojmë. Kuptimi i dhunës strukturore dhe kulturore na ndihmon dhe na obligon që të punojmë në zvogëlimin dhe heqjen e saj;

- nxitja e kujdesit për tërësinë e jetës në tokë, qëndrueshmëria e asaj jete, kujdesi për klimën, për resurset, për njerëzit të cilët jetojnë më keq se ne.

Këtu janë arsimtarët e sotëm të fuqishëm. Në kohën e rrogave të ulëta, mospranim shoqëror, kërkesë të kompetencave të reja, dyshimi në kompetencat vetiake – arsimtarët e harrojnë forcën e tyre dhe në kualitetin e tyre të madh. Ky është kujdesi për tjetrin. Sado që të jenë të tërhequr sot, shumicën e madhe të punëtorëve të arsimit i lidh kujdesi për fëmijët me të cilët punojnë. Shpesh kjo është edhe dashuri ndaj jetës të cilës i ndihmojmë të rritet, t’ua japim atë më së shumti që mundemi, që jetët e tyre të jenë më të lumtura, më pak të dhunshme, më të mira se jetët tona.

Sot dhe nesër

Dimensioni kohor është i rëndësishëm te arsimimi qytetar. Kjo është punë në shtigje të gjata. Por me shumë lëkundje e satisfaksione të vogla por të shpejta. Nëna e një vajze e cila vizitonte punëtori për komunikim jo të dhunshëm në Zenicë, erdhi që t’i njoftojë udhëheqësit e atyre punëtorive, që t’i falënderojë. “Për se?” – e kishte pyetur Venera, njëra prej trajnueseve.

“Vajza ime ishte e turpshme, person introvert. Një kohë ka ardhur në punëtoritë tuaja. Sot gjatë drekës më tha: ‘Nënë, mos më ndërpre gjersa flas.’ Kjo ka shumë rëndësi për mua. Ju faleminderit.”

Ajo pse rruga është e gjatë, e pengesat e shumta, le të na përkujtojnë se marrim pjesë në diçka të re, të rëndësishme, të madhe. Pas dy luftërave botërore, periudhës së Luftës së Ftohtë, qytetarët e bashkuar, posaçërisht nëpër shumë tubime të mijëvjeçareve rreth 2000 vjet, kanë vendosur që në mënyrë aktive të ndërtojnë një botë pa luftëra, pa dhunë.

Në kohën kur planeti është zvogëluar dhe çdo ditë po dëgjojmë për ngjarje nga ana tjetër e globusit, kur jemi të vërsuar me informacione dhe kuptojmë se gjërat më të rëndësishme nuk na tregohen, kur tashmë një shekull ekziston Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, kur është themeluar edhe Gjykata e vërtetë Globale – Gjykata Ndërkombëtare Penale (ICC), ne e kuptojmë se sa i brishtë është civilizimi jonë.

Çdo ditë po zvogëlohen mushkëritë e bardha të planetit – pyjet në Amazon, është çudi e madhe që nuk është përdorur armatimi nuklear pas 1945, sistemi i bankave, korporatat dhe politika e korruptuar është jashtë kontrollit edhe në vendet më të zhvilluara e lëre më në ato më pak të zhvilluara. Edhe më tej zhvillohen luftëra, edhe atë me armatim më modern, me arsye më pak të qarta, përveçse për përfitim. Hendeku mes të pasurve dhe të varfërve është edhe më i madh, si në botë, ashtu edhe te ne. Një e dhënë jo larg të kaluarës thotë se 10% e qytetarëve të Maqedonisë nuk kanë parë tren në jetën e tyre. Njëkohësisht, po e njëjta përqindje e qytetarëve të Maqedonisë kanë arsimim të lartë, janë relevant dhe të kërkuar në botë, flasin disa gjuhë.

Si të zvogëlohen dallimet? Si ai hendek mos të prodhojë dhunë? Si më shpejtë t’i bashkëngjitemi bashkësisë së të zhvilluarve, për shembull në UE?

Me arsimim. Me vlerë. Me paqe.

Në vend të përfundimit

Është vërejtje se arsimimi paqësor vjen nga sektori joqeveritar. Kjo me siguri do të duhej ta diskreditonte idenë. Nuk e kam të qartë se përse duhet të diskreditohet ideja se qytetarët aftësohen

për pjesëmarrje të pavarur, kompetente në proceset demokratike, në bashkëjetesën me kualitet me të tjerët.

Sido që të jetë, vërejtja është pjesërisht e saktë.

Është e saktë se në shtet post-jugosllave, arsimimi qytetar ende nuk është nëpër shkolla. Është e saktë se ka disa individë të dalluar, grupe, shoqata për të cilat është me rëndësi që kjo të jetë nëpër shkolla.

Të gjithë kemi nevojë për dituri, kohë, kemi nevojë për njerëz. Për ndryshim, fillimisht vetë neve, shprehive tona, për transformim nga ligjërues në bashkëpunëtor, nga arsimtar në fasilitator, për qëndrimin se ne japim e nxënësit pranojnë, për pranimin e domosdoshmërisë së bashkëpunimit të dyanshëm, këmbimit të shumanshëm.

Arsimtarët e forcuar janë qëllimi i parë më urgjent. Rritja e masës kritike e profesorëve, arsimtarëve, mësuesve, e bashkëpunëtorëve profesionalë të cilët kuptojnë se arsimimi paqësor është ndryshim i paradigmes së shkollës e formuar dhe e strukturuar në periudhën e revolucionit industrial, drejt shkollës që i përshtatet të ardhmes e cila tashmë është këtu.

Vlen që për fund të përsëritet: arsimimi paqësor që në fillim është ngarkesë, presion shtesë ose obligim – nuk është ai.

Arsimimi paqësor na ndryshon, i forcon të dobët, të dëshpëruarit, të marginalizuarit, u ndihmon të fuqishmëve që ta përdorin forcën e tyre për mirëqenien e tyre dhe të të tjerëve e jo në dëm të të tjerëve, vendos raporte që e bëjnë shoqërinë më të fortë, ndërsa paqen më të qëndrueshme.

Në kohën kur njohuritë e njeriut janë të arritshme deri te të gjithë nëpërmjet internetit, na duhet ndihmë në orientim. Ndihmën teknike, ku të gjendet dituria e caktuar, të arrihet, të mësohet, shkolla e sotme e realizon mjaft mirë.

Neve na mungon kuptimi i kontekstit. Përse dy të tretat e njerëzve në planet jetojnë në varfëri? Përse çdo ditë njerëzit e paguajnë ujin nëpër shishe nga burimet të cilat deri dje kanë qenë pronë publike? Çfarë duhet të bëjë secili prej nesh që kurrë mos të ketë luftë te ne? A e dimë ne fuqinë e parashtrimit të pyetjeve? A e kuptojmë tjetrin, më ndryshe, nevojën e tij/saj që të jetojë më ndryshe se ajo në të cilën ne jemi mësuar?

Arsimimi paqësor është asistenti ynë i afërt. Ndihmë. Për hapat e vegjël, për hapat e parë, për hapat më të rëndësishëm.

Sa mirë është të ecet nëpër shtigjet e pashkelura të cilat janë sa më pak të shkelura. Në Maqedoni tashmë janë disa qindra punëtorë të arsimit mjaft të edukuar që të munden në mënyrë të pavarur të realizojnë elemente të ndryshme nga arsimimi qytetar.

Ky libër dëshiron që t'ju njohë të gjithë ju si bashkëpunëtorë/bashkëpunëtores vitalë në ndërtimin e shoqërisë pa dhunë nga të cilët do të mësojmë, me të cilët do të bashkëpunojmë, në të cilat programe do të marrim pjesë, të cilët do të na lidhin me të gjithë kolegët dhe koleget nga e gjithë bota.

Për shkak se në botën e sotme, lokalja nga ajo globalja është larg vetëm një hap i vogël.

E jona është të caktojmë se a do të jetë ky hap paqësor apo ushtarak.

Goran Bozhiçeviq, mësues paqësor dhe mediator, aktiv në punën e paqes që nga viti 1993. Punon në të gjitha vendet post-jugosllave dhe Ukrainë, sipas nevojës edhe në vende të tjera. I afërt me kvekerët dhe menonët. Shkruan miramidale në <http://h-alter.org/> nga viti 2014 dhe fjalor Miramida në <http://radio.rojc.eu/>. Merret me temat e pajtimit, dialogut dhe arsim paqësor. Jeton në Istër.

**4. VENDOSJA E ARSIMIMIT PAQËSOR NË PJESËN
FORMALE DHE JOFORMALE TË SISTEMIT
ARSIMOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

Hyrja

Arsimimi paqësor me përmbajtjet e tij është fushë komplekse që është shumë e rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë qytetare. Pasi që synojmë drejt krijimit dhe zhvillimit të shoqërisë demokratike, multikulturore, në paqe në të cilën ekzistojnë shanset e barabarta dhe të drejtat për të gjithë, realizimi i arsimimit paqësor në të gjitha nivelet, grupet e rritura është shumë me rëndësi për sistemin edukativ-arsimor. Për këtë nevojiten qasje të ndryshme, teknika didaktike-metodike, vegla për zbatimin e tij sipas vendosjes dhe integritit në pjesën formale dhe joformale të sistemit arsimor.

Me qëllim që më mirë ta kuptojmë arsimimin paqësor, do të rikujtohem në definicionet e njohura të cilat gjenden në literaturën për transformimin e konflikteve të Johan Galtung në librin ‘Peace by Peaceful Means: Peace and Conflict, Development and Civilization’, i cili e definon paqen si: “Paqja është mungesa e dhunës ose sjellja e saj deri në minimum në çdo aspekt” dhe “Paqja është transformim i pa dhunshëm dhe kreativ i konfliktit”. Ish sekretari i përgjithshëm i KB, Kofi Anan thotë: “Paqja është çështje konstante dhe do të thotë më shumë se mungesë e luftës, do të thotë çlirim nga uria, nënkupton drejtësi, të drejta të njeriut, arsimim, shëndet dhe jetë të mirë. Sundimi i mirë i paqes do të thotë t’ju jepet shansi njerëzve që të bëjnë një jetë të denjë.”

Është e domosdoshme që metodat dhe teknikat mësimore t’i ndjekin dinamikat në shoqëri, ndryshimet që ndodhin, kurse prindërit por edhe arsimtarët të rriten me nxënësit. Të përdoren praktika të dobishme që përshkruajnë problem/konflikte në mjedisin në të cilin jetojnë, mësojnë, qëndrojnë dhe të cilat praktika ofrojnë zgjidhje të problemeve, ide të dobishme për socializim, për komunikim pozitiv e jo të dhunshëm dhe rregulla për punë ekipore.

Ndryshimet socio-teknologjike janë aq të shpejta, na duket se nuk mund t’i ndjekim, e dobësojnë motivimin e me këtë edhe dinamikën e përcjelljes së ndryshimeve. Por, gjithmonë kërkohen zgjidhje të reja, drejtime, zhvillohen programe sipas masës së nxënësve, të shkollave që do të janë përkrahje që nëpër ato shkolla të përdoren qasjet e reja: komunikim jo i dhunshëm, ndërmjetësimi dhe mënyra tjera për zgjidhjen e konflikteve. Nevojiten aksione të përbashkëta, përkrahje të nxënësve, arsimtarëve, punëtorëve profesionalë, prindërve me qëllim që të njëjtat të kanë sukses.

Përmbajtjet dhe aktivitetet e arsimimit paqësor në Maqedoni janë të përfaqësuara në pjesën formale të sistemit arsimor, si dhe projektet me sektorin joqeveritar, organizata ndërkombëtare si dhe me partnerë të shkollave ose të bashkësisë lokale.

Arsimimi paqësor në maqedoni

Ndryshimet në sistemin shoqëror-politik dhe ekonomik në Republikën e Maqedonisë imponuan shumë çështje për të tashmen tonë që është e shënuar me ndryshime. Zhvillimi i përbashkët i Lindjes dhe Perëndimit, zgjerimi i Unionit Evropian, progresi i shpejtë shkencor-teknologjik dhe efektet nga globalizimi kanë ndikim të fuqishëm në përditshmërinë tonë, kështu edhe në rrjedhat edukative-arsimore.

Me këtë rast, fillohet nga përcaktimet strategjike të Republikës për konsolidimin shtetëror juridik të shtetit sovran, të pavarur e demokratik, social e qytetar, me orientim të qartë dhe përcaktim për t’u integruar në Evropë.

Si aspekte jashtëzakonisht të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm demokratik, përfitimet civilizuese dhe universale, vlerat, të drejtat, kultura e paqes, detyrimisht lind nevoja që të rinjtë, nxënësit të fitojnë njohuri, kulturë dhe vetëdije për këto procese, në të vërtetë ta kuptojnë rëndësinë e idesë evropiane me anë të proceseve të kooperimit evropian, me anë të përmbajtjeve, strukturave dhe metodologjisë së saj. Përvoja e gjeneratës, tradita në mësimin e arsimit paqësor në Republikë në vazhdimësi është ndërtuar dhe zhvilluar me anë të sistemit edukativ-arsimor, më herët e quajtur si Mbrojtja dhe Siguria, tani si Paqe, tolerancë dhe mbrojtje. Nga këtu edhe tema Mbrojtja civile e cila mundëson kompetencat e nxënësve për mbrojtje individuale dhe kolektive nga të gjitha llojet e kërcënimeve natyrore, rreziqeve dhe rrezikimeve. Ndoshta jemi shteti i vetëm nga ish shtetet jugosllave që e ka mbajtur në sistemin e arsimit këtë lloj të përmbajtjeve.

Vendosja e arsimit paqësor në Maqedoni

Në Republikën e Maqedonisë, një pjesë e përmbajtjeve dhe aktiviteteve nga arsimimi paqësor janë të njohura/të vendosura nën titullin Paqe, tolerancë dhe mbrojtje në arsimin e mesëm që realizohen në planet dhe programet mësimore:

A) Qasja formale

Aktivitete projektuese në gjimnaz – Paqe, tolerancë dhe mbrojtje

Lëndë mësimore në shkollën e mesme/profesionale/trevjeçare-Paqe, tolerancë dhe mbrojtje

Orë të lira në shkollat profesionale- Paqe, tolerancë dhe mbrojtje

Shkathtësi jetësore, lëndë mësimore në orët e kujdestarisë në arsimin fillor dhe të mesëm.

Shkathtësitë për të jetuar, lëndë zgjedhore në arsimin fillor, tema – Mbrojtja dhe shpëtimi (12 orë)

Aktivitetet jashtëmësimore, aktivitetet e lira të nxënësve, aktivitetet e planifikuara me programin

vjetor të punës së shkollave po ashtu janë forma të realizimit të aktiviteteve nga kjo problematikë.

B) Qasja joformale

Projektet e shkollave që realizohen me sektorin joqeveritar dhe me organizatat tjera, si në arsimin e mesëm, ashtu edhe në arsimin fillor, si aktivitete jashtëmësimore dhe të lira të nxënësve.

Në pjesën formale edukative-arsimor, vendosja është si vijon:

Në arsimin e mesëm (gjimnaz), nga viti shkollor 2003/2004 në planin mësimor është futur pjesa e detyrueshme Aktivitete projektuese – nga 70 orë për secilin nxënës përgjatë vitit ose dy fusha (nga 35 orë), njërën prej të cilës mund ta zgjedh nxënësi çdo vit nëse tregon interesim dhe mund të jetë Paqe, tolerancë dhe mbrojtje. Për të njëjtën, Biroja për zhvillimin e arsimit për arsimtarin ka përgatitur program me udhëzime dhe drejtime për realizim.

Në fushën Aktivitete projektuese, në planin mësimor nxënësve u ofrohet mundësia që t'i zgjedhin dy fusha (prej 11), në të cilat do të studiohen, hulumtohen dhe përpunohen projekte. Mes tjerash, janë të përfshira fushat: paqja, toleranca dhe mbrojtja, kultura urbane, kultura qytetare, kultura për jetë të shëndetshme për të cilat kishte interesim të madh nga ana e nxënësve, posaçërisht për paqen, tolerancën dhe mbrojtjen (prej 25 deri 30% nga e gjithë popullata e shkollave të mesme në Republikë).

Fusha paqe, tolerancë dhe mbrojtje ofron shumë tituj për të hulumtuar dhe punë të projekteve nga fusha e arsimit paqësor, me anë të të cilave nxënësit realizojnë shumë qëllime të përgjithshme, si për shembull:

- Të promovojnë kulturën e paqes dhe të veprojnë si individ paqësor i integruar në proceset demokratike të Republikës së Maqedonisë;
- Të aftësohen për komunikim më të gjerë, të janë bartës të transformimit të raporteve në shoqëri dhe të përpiqen kundër tjetërsimit, çintegritit dhe degradimit të secilës formë;
- T'i kuptojnë vlerat demokratike dhe universale;
- Të zhvillojnë aftësinë për përgjegjësi individuale, shoqërore, respektim e të ngjashme;
- Të udhëzohen në punën hulumtuese në temat nga fushat e dhëna me mundësinë e përpunimit të projekteve në të gjitha fazat e planifikimit e deri te prezantimi.

Në shkollat e mesme trevjeçare profesionale mësohet (edhe këtë vit) lënda e detyrueshme mësimore Paqja, toleranca dhe mbrojtja, sipas programit mësimor që e solli ministri i arsimit në vitin 2003. Me ndryshimet më të reja në shkollat trevjeçare profesionale, nga ky vit shkollor nuk ka lëndë mësimore, në të vërtetë paqe, tolerancë dhe mbrojtje mbetet si fushë vetëm në orët e lira në shkollë.

Paraqitja tematike e programit mësimor nga Paqja, toleranca dhe mbrojtja:

- Vlerat themelore dhe universale (paqja si vlerë, pozitiv dhe negativ)
- Punëtori kundër dhunës, për komunikim, bashkëpunim dhe zgjidhje të konflikteve
- Rrezikimi dhe rreziqet, parandalimi dhe mbrojtja
- Mbrojtja civile – menaxhmenti i krizës nëshkollë
- Maqedonia dhe bashkësia ndërkombëtare.

Përmbajtjet dalin dhe korrespondojnë me ndryshimet shoqërore, duke i ndjekur proceset integruese në Evropë dhe më gjerë dhe zhvillimin e paqes dhe mbrojtjes si vlerë themelore dhe universale.

Gjithashtu, përmbajtjet dhe temat nga fusha e rrezikimit në botën moderne, parandalimi, mbrojtja e çdo lloji, siguria individuale dhe kolektive, si dhe Maqedonia në raport me bashkësinë ndërkombëtare.

Zgjidhja e konflikteve, komunikimi jo i dhunshëm janë teknika që i mësojnë nxënësit, më shumë në partneritet me sektorin joqeveritar si projekte. Aktivitetet dhe temat nga fusha e mbrojtjes dhe shpëtimit/mbrojtjes civile burojnë si nga nevojat, ashtu edhe nga kërkesat e Ligjit për mbrojtje dhe shpëtimit (Gazeta Zyrtare nr. 36/04 e RM). Përmbajtjet dhe aktivitetet janë në funksion të njohjes së nxënësve me llojet e rreziqeve dhe fatkeqësive që mund të ndodhin në RM dhe në botë, pastaj në funksion të përgatitjes, edukimit dhe trajnimit të nxënësve për veprimet në rast të ndonjë rreziku, ngritja e vetëdijes dhe kultura për ndërmarrjen e masave parandaluese dhe masave gjatë kohës dhe pas fatkeqësive që mund të ndodhin në jetën e përditshme, që t'i ndihmojë vetvetes, të afërmve të tij dhe t'i ruajë të mirat materiale, përmbajtjet për vlerat themelore dhe universale

si dhe raportin e RM dhe organizatave ndërkombëtare me të cilat do të njihen dhe udhëzohen nxënësit.

Orët e lira nëpër shkollat profesionale është fushë në planin mësimor ku përdoren programet dhe udhëzimet për paqe, tolerancë dhe mbrojtje, siç janë në aktivitetet e projekteve nëpër gjimnaze. Përmbajtjet dhe aktivitetet për arsimim paqësor në kuadër të orëve të lira nëpër shkolla janë mjaft të përfaqësuara në praktikë, si në fushën e paqes, tolerancës dhe mbrojtjes, ndërsa mund të gjenden edhe në fushën e kulturës urbane, kulturën qytetare ose si projekte të shkollës.

Shkathtësitë jetësore është lëndë mësimore që realizohet nëpër orët e mësimi, ku në programet mësimore takohen përmbajtjet/aktivitetet/teknikat për zgjidhjen e konflikteve.

Shkathtësitë e jetës, lëndë zgjedhore në arsimin fillor, tema – Mbrojtja dhe shpëtimi (12 orë).

Aktivitetet jashtëmësimore, aktivitetet e lira mësimore, aktivitetet e planifikuara me programin vjetor për punë të shkollave, po ashtu janë forma të realizimit të aktiviteteve të ngjashme.

Në arsimin e mesëm, që nga viti shkollor 2002/2003 e deri më sot, Paqja, toleranca dhe mbrojtja hyjnë në fushën e aktiviteteve projektuese – zgjedhore, nga vitin e parë e deri në vitin e katërt me nga 1 orë në javë. Kjo do të thotë se nxënësit që do ta zgjedhin Paqen, tolerancën dhe mbrojtjen, e realizojnë vetëm një temë për të cilën përgatisin projekt.

Në shkollën e mesme profesionale, në kuadër të orëve të lira në shkollë nga viti shkollor 2005/2006 e deri më sot, ofrohet si aktivitet zgjedhor projektues.

Disa praktika për arsimimin paqësor nëpërmjet projekteve me sektorin joqeveritar

Në këto vitet e kaluara, Byroja e arsimit në Maqedoni, MASH, japin përkrahje për projektet dhe aktivitetet nga sektori joqeveritar dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë nëpër shkolla për përmirësimin e sigurisë, për ndërtimin e klimës pozitive, për komunikim jo të dhunshëm, për kulturën paqësore të gjithë faktorët në procesin edukativ-arsimor.

Qëllimi kryesor i projekteve dhe i programeve të tyre është vendosja e paqes dhe e tolerancës nëpër shkolla, me përdorimin e teknikave/veglave për t'u marrë me konfliktet. Njëherësh, programet kanë për qëllim që ta ngritin vetëdijen dhe të kontribuojnë për zvogëlimin e dhunës nëpër shkolla.

Programi për arsimimin paqësor e realizon ambasada e Parë e fëmijëve në botë MEGJASHI e cila punon me shumë programe/tema. Projekt programet e tyre janë të drejtuara kah promovimi dhe ndërtimi i kulturës paqësore nëpër shkolla, zvogëlimi i dhunës nëpër shkolla dhe forcimi i kapaciteteve të profesorëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe nxënësve në tejkalimin e konflikteve, mësojnë dhe trajnojnë që konfliktet t'i transformojnë me anë të rrugës jo të dhunshme. Është e përfshirë edhe grupi i shkollave të mesme nga Republika të cilët në mënyrë aktive veprojnë dhe tregojnë motivim të fuqishëm për të vazhduar më tej drejt qëndrueshmërisë së aktiviteteve, me tendencën që të janë dhe të gjejnë vend në sistemin e arsimit.

Programi për arsimim paqësor ka për qëllim që ta ngritë vetëdijen, që të kontribuojë drejt zvogëlimit të dhunës nëpër shkolla, jo vetëm në mjediset multietnike, por edhe në mjediset e pastra etnike. Për këto arsye, MASH/BZHA i ka dhënë përkrahje këtij Programi për arsimimin paqësor të MEGJASHI.

Ky vetëm është vazhdim i praktikës kur po ashtu BZHA/MASH i ka përkrahur edhe programet e Forum ZFD (Shërbimit Paqësor Civil – organizatë paqësore gjermane, 2007/2009 -2015) e cila punonte në promovimin e paqes dhe sigurisë, orientuar drejt përmirësimit të dialogut dhe klimës. Nga viti 2012-2015 si partner në aktivitete paraqitet edhe organizata lokale joqeveritare Trening qendra për menaxhimin e konflikteve (TCMC), pastaj u inkuadrua me përkrahjen e saj edhe zyra e OSBE-së, të cilët bashkë punuan në marrëdhëniet ndëretnike në mes nxënësve dhe arsimtarëve nëpër shkolla, lidhja dhe ndërtimi i partneritetit në mes institucioneve, sektorit qytetar dhe bashkësisë afariste, puna e tolerancës dhe e kuptimit të ndërsjellë, posaçërisht në mesin e të rinjve. Përfundoi projekti për ndërmjetësim nëpër shkolla i titulluar si “Ndërmjetësimi mes moshatarëve dhe zgjidhja paqësore e konfliktit – duke mësuar dhe duke jetuar paqen” në të cilën ishin të inkuadruara shumë shkolla nga Republika. Aktivitetet e programit ishin të orientuara drejt trajnimit të arsimtarëve, pedagogëve dhe psikologëve nëpër shkolla, trajnimi i nxënësve për përdorimin e ndërmjetësimit dhe e këmbimit të përvojave me anë të vizitave studimore dhe kampeve të nxënësve dhe formave tjera të bashkëpunimit.

Të gjitha këto programe promovojnë arsimimin paqësor, menaxhimin dhe trajtimin me konflikte – duke mësuar dhe jetësuar paqen. Po ashtu, edhe programi i ri Integrimi Ndëretnik i të rinjve në Arsim (INAR) dhe programet e ngjashme, japin kontribut drejt strategjisë nacionale për arsimimin e integruar drejt realizimit të kompetencave individuale dhe realizimit të qëllimeve të caktuara për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe mes moshatarëve të nxënësve, ndërsa qëllimet shpesh janë përmirësimi i sigurisë, si zvogëlimi i dhunës në mes nxënësve nëpër shkolla dhe krijimi i klimës pozitive e të këndshme të punës.

Byroja për bashkëpunim me Megjashi, po ashtu ka organizuar edhe trajnim me edukatorët nga shtëpitë e nxënësve në temën “Dhuna e moshatarëve”.

Institucionet kompetente për ndjekje, koordinimin në raport me relevancën, efektivitetin, efikasitetin, qëndrueshmërinë dhe ndikimin e aktiviteteve për arsimimin paqësor do të japin rekomandime adekuate për realizimin të mëtejshëm të suksesshëm të tyre, qasje në mundësitë dhe mënyrat për ndërtimin e zgjidhjeve më efikase dhe më të qëndrueshme në implementimin e arsimimit paqësor.

Nevoja për të mësuar arsimimin paqësor

Duke e parë rëndësinë e arritjes të qëllimeve për arsimimin paqësor, imponohet edhe nevoja e sjelljes së programit më të gjatë kohor e cila ofron zgjidhje afatgjata për parandalimin, sjelljen pa dhunë në- për shkolla (për dallim nga programet të cilat deri më tani si projekte shpesh janë realizuar, por që nuk janë gjallëruar plotësisht ose janë të paqëndrueshme). Imponohet nevoja për zgjidhje institucionale dhe sjellje të programeve/moduleve, drejtimeve për aplikim të detyrueshëm nëpër shkolla.

Kjo do të thotë se nëse kihet për qëllim që të zvogëlohen konfliktet dhe të zhvillohen marrëdhënie më tolerante nëpër institucionet arsimore, nevojitet jo vetëm që të zhvillohen idetë për respektimin e dallimeve, por edhe të zhvillohen modelet në të cilat vetë nxënësit do të janë

anëtarë të barabartë të kolektivit, shoqërisë me anë të lirisë së pjesëmarrjes, kompetencave për marrjen e vendimeve, duke shprehur mendimin dhe duke pranuar përgjegjësinë e të ngjashme.

Përveç informacioneve kryesore për komunikim, konflikte dhe ndërmjetësim, t'i paraqesim edhe njohuritë për mundësitë e vetorganizimit, shoqërimit, përcaktimit të aksioneve etj. të cilat do t'u mundësojnë të rinjve që individualisht t'i zhvillojnë potencialet e tyre dhe t'i realizojnë interesat dhe nevojat e tyre. Janë bërë vlerësime, vlerësime dhe gjetje, konkluzione dhe rekomandime që janë bazë e mirë për ndërtimin e strategjive dhe për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme për promovimin e ndërmjetësimit të moshatarët dhe zgjidhjes pa dhunë të konflikteve nëpër shkolla anekënd vendit.

Për shkak të ndërlikueshmërisë së programit dhe rëndësisë së tij për përmirësimin/ndërtimin e komunikimit pa dhunë, posaçërisht nëpër mjediset multietnike, vlerësimi dhe përgjigje në shumë pyetje, me fokus të veçantë të efekteve të programit dhe qëndrueshmërisë së zgjidhjeve.

Nga përvoja e deritanishme dhe nga puna në këto programe imponohet nevoja për një produkt për përpunimin e veglës metodike/didaktike/drejttime për arsimtarët, por edhe për nxënësit. Për momentin nuk ka në dispozicion literaturë profesionale didaktike për arsimtarët, të cilët gjinden vetë sipas zgjedhjes dhe mënyrës së tyre. Në të vërtetë, përdoren udhëzime, drejttime për realizimin e temave të caktuara të cilat kanë dalë nga punëtoritë, seminarët që janë realizuar në periudhën e kaluar.

Materiali duhet t'ju ndihmojë arsimtarëve të cilët e realizojnë Paqe, tolerancë dhe mbrojtje (PTM) ose aktivitete tjera projektuese nga kjo problematikë, të njihen me nocionet në arsimimin paqësor, parandalimin, mbrojtjen, sigurinë, konfliktet, disa prej mënyrave të mundshme/technikave për tejkalimin, zgjidhjen, por që njëherësh edhe të rinjtë të nxiten që individualisht t'i zgjidhin problemet me të cilat ballafaqohen në mjedisin e përditshëm.

Përse është me rëndësi studimi i arsimimit paqësor?

Me studimin, edukimin, trajnimin dhe hulumtimin e këtyre përmbajtjeve mes tjerash i mundësohet nxënësit që t'i njohë edhe rreziqet dhe rrezikimet ekzistuese dhe të mundshme me karakter natyror e shoqëror, që të stërvitet për veprimet në rast të kërcënimeve bashkëkohore, që të veprojë në mënyrë të sigurt dhe konstruktive në situatat e dhëna, që të arrijë disa njohuri, qëndrime dhe të zhvillojë kulturë të mbrojtjes, paqes dhe tolerancës, gjegjësisht të veprojë si individ paqësor dhe integruet në proceset demokratike të Republikës së Maqedonisë.

Cilat janë parimet kryesore të arsimimit paqësor?

Paqja, toleranca dhe mbrojtja, përmbajtjet programore dhe tematike janë aspekt i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm demokratik, për përfitimet e qytetërimit dhe universale, nga këtu detyrimisht imponohet nevoja që të rinjtë- nxënësit të përfitojnë njohuri, kulturë dhe vetëdije për këto procese të idesë evropiane dhe bashkëpunimit evropian. Arsimimi për paqe, tolerancë dhe mbrojtje – arsimimi paqësor synon drejt të arriturave bashkëkohore shkencore, drejt nevojave moderne dhe aktuale, drejt arritjes së kompetencave, qëndrimeve të cilat nëpërmjet realizimit të programeve (projekteve) sjellin përmbajtje dhe aktivitete për realizimin e parimeve të rëndësishme me të cilat sigurohet:

- ♦ demokraci, jo diskriminim;
- ♦ respektimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut dhe të qytetarit;
- ♦ përforcim të solidaritetit social;
- ♦ rritjen e mirëqenies, që do të rezultojë me sigurimin e paqes;
- ♦ perspektivë të qartë për të ardhmen;
- ♦ promovimin e arsimit ndërkulturor;
- ♦ forcimin e shkathtësive për përmirësimin e njohurive;
- ♦ ndërtimin e principeve për jo dhunë të çfarëdo lloji;
- ♦ mjedis/shkollë të shëndetshme e të sigurt, trajnimin e kapaciteteve dhe shkathtësive për përmirësimin enjohurive dhe kuptimin e kulturave tjera dhe
- ♦ ballafaqimin me sfidat ekzistuese të implementuara në shoqërinë e sotme.

Përmbajtjet janë grupuar dhe programuar ashtu që janë përputhur sipas moshës, nevojës, mundësive dhe interesit të nxënësve, gjendjet ekzistuese në shoqëri/rrethinë, si dhe nevoja ligjore e realizimit të përmbajtjeve të caktuara (mbrojtja civile).

Në këtë mënyrë arrihen qëllimet e rëndësishme në edukimin dhe aftësimin e nxënësit i cili si një qytetar i ardhshëm duhet të jetë i sigurt, person human me sjellje paqësore dhe tolerante.

Mënyrat e organizimit dhe realizimit të aktiviteteve Aktivitetet organizohen dhe realizohen në bashkëpunim me nxënësit, ata merren vesh për tipin dhe llojin e aktiviteteve që janë në përputhje me kushtet/mundësitë në vetë shkollë, rajon, mjedis etj.

Ato mund të jenë: punëtori, në kabinet dhe në terren.

Punëtoritë në kabinet realizohen sipas rregullit në shkollë, me ç'rast përdoren mjete të ndryshme ndihmëse: tabelë, panel, skema që i përshkruajnë për shembull kërcënimet (rreziqet) (elektronike, video/CD), tekste që janë bazë për hulumtim, debate dhe diskutime, grafoskop, kompjuter, fleta pune, literaturë referencë etj.

Aktivitetet në terren kryhen sipas marrëveshjes me nxënësit, mundësisht jashtë shkollës, me hulumtime individuale të temës aktuale. Mes tjerash, aktivitetet praktike mund të nënkuptojnë për shembull, simulime të situatave të krizës, studime të rasteve dhe veprimet ndaj rasteve të tilla.

Është e rekomanduar që të bëhen simulime, studime të rasteve që mund të punohen në shumë grupe, me prezantime nëpër shkolla, në mjedisin lokal ose më gjerë.

Të përdoret kabineti i informatikës – nëse punohen projekte të vogla nëpërmjet internetit me shkollat tjera në vend ose nga rajoni. Është e pëlqyer që të vizitohen/të vendoset bashkëpunimi me disa institucione që merren me fushat përkatëse etj.


Është i pëlqyer përdorimi i dokumenteve të ndryshme ndërkombëtare nga fusha e aktiviteteve, si dhe aktivitetet hulumtuese të cilat i përgatitë me nxënësit sipas interesit të tyre.

Titujt e mundshëm për punë në projektet nëpër shkolla

- Dhuna, bulling (ngacmime), teknika dhe mënyra për ndalimin dhe zvogëlimin
- Konfliktet/mosmarrëveshjet dhe transformimi i tyre, ndërmjetësimi, komunikimi asertiv/ jo i dhunshëm
- Sjellja asociale, kriminale e të rinjve
- Dukuritë sociopatologjike dhe të rinjtë (nga aspekti i kërcënimeve dhe rreziqeve shoqërore)
- -Varësitë dhe zhdukja e tyre: narkomania, alkoolizmi etj.
- Njohja e radikalizmit, parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm
- Varësia teknologjike, parandalimi dhe mbrojtja
- Tregtia me njerëz, abuzimi, dhuna
- Terrorizmi lokal ose global
- Katastrofat më të mëdha natyrore në botë
- Tërmetet, parandalimi, procedurat dhe pasojat
- Përmbajtje dhe thatësira (mbrojtja) A ekziston mbrojtja?
- Pasojat dhe mbrojtja nga zjarret në natyrë
- Rreziku për RM nga aksidentet bërthamore në mjedis.
- Rreziku për qytetin nga aksidentet kimike, kontaminimet
- Ndikimi i dëmshëm i rrezatimit
- Epidepi (pasojat dhe mbrojtja), epifitetet, epizotet
- Ndotje (të çdo lloji, lokal e më gjerë); ujërat (Vardari, lumenjtë tjerë në rrethinë)
- Ajri – Veles, Manastir, Tetovë...
- Toka – Shkup, qytete tjera në vendin e banimit në Republikë
- Si të zvogëlohet numri i aksidenteve në komunikacion, aksidentet ekologjike?

Këto janë vetëm një pjesë e temave dhe përmbajtjeve nga Programi për paqe, tolerancë dhe mbrojtje, të cilat mund të përpunohen si lëndë mësimore, por gjithashtu edhe si aktivitete projektuese ose projekte për hulumtim nëpër gjimnaze dhe nëpër shkolla të mesme profesionale.

Sofka Kocева për shumë vite punon në Byronë për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë, këshilltare për arsimimin qytetar në Sektorin për hulumtim dhe zhvillim të arsimit. Punon në projekte, hulumtime, në përgatitjen e analizave, programeve, standardeve arsimore nga fusha dhe tema të ndryshme.



**5. PËR ARSIM PËR PAQE
NUK KA DREJTËSI, NUK KA PAQE!**

*„Paqja nuk mund të mbahet me forcë, ajo mund të arrihet
vetëm me mirëkuptim.“*

Albert Ajnshtajn

Kur përmendet fjala paqe, shpesh herë mendojmë në gjendje të kundërt nga lufta, edhe pse në fakt paqja nuk do të thotë vetëm mungesë të çdo lloji të dhunës, por edhe prezencë e drejtësisë dhe sigurisë në aspekte të ndryshme të jetës.

Fjalori i Oksfordit e përcakton fjalën „paqe” (anglisht : peace) si:

1 iri nga shqetësimi; qetësi.

1.1 Qetësi mendore ose emocionale.

2. Gjendje apo periudhë në të cilën nuk ka luftë apo lufta ka mbaruar.

Në fjalorin digjital të gjuhës maqedone, përveç shpjegimeve të mësipërme, haset edhe një shembull interesant: „Jetojnë në paqe”-frazë të cilën për fat të keq gjithnjë e më pak e dëgjojmë në mjedisin tonë, dhe e pasqyron kontekstin maqedonas për jetën me pajtim dhe mirëkuptim. Nga ana tjetër, deri kohët e fundit, në rrugët tona fuqishëm jehonte parolla „Nuk ka drejtësi, nuk ka paqe”, që luajti një rol emancipues tek qytetarët në aspekt të uniformitetit dhe barazisë së tyre në sistemin në të cilin ata jetojnë, pa të cilat është e pamundur të ruhet paqja, edhe me përdorimin e forcës. Dhe këtu diku përditshmëria maqedonase afrohet me citim e Ajnshtajnit të përmendur në fillim, i cili bën të qartë se paqja është diçka që vazhdimisht duhet të ndërtohet edhe përmes mirëkuptimit. Në vazhdim për të ndërtuar paqen në një komunitet, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për familjen apo shoqërinë në tërësi, është e nevojshme që të gjithë anëtarët e së njëjtës në mënyrë aktive të kontribuojnë për realizimin e qëllimit, të tregojnë një vetëdije për veten, por edhe për të gjithë të tjerët në komunitet.

Nga këtu, në mënyrë të pashmangshme shtrohet edhe pyetja : si krijohen qytetarë të vetëdijshëm të cilët mendojnë në mënyrë kritike për jetën dhe të ardhmen të cilën bashkarisht duhet ta ndërtojnë?

Natyrisht, shtëpia dhe familja janë djepi i parë ku formohen personalitetet e ardhshme aktive shoqërore, por shkolla është shtëpia e dytë në të cilën ata pajisen me aftësi dhe njohuri të cilat në mënyrë ideale duhet t'i shfrytëzojnë në botën reale, gjegjësisht jashtë klasës. Prandaj, varësisht nga ajo se çfarë lloj shoqërie duam të krijojmë, të tilla duhet të jenë edhe shkollat.

Por, si të ndërtohet paqja në një shoqëri, e cila funksionon si produkt anësor i sistemit kapitalist, qëllim i vetëm i të cilit është fitimi, duke e ditur se luftërat, gjegjësisht prodhimi i armëve është një nga industritë më fitimprurëse? Si mund të presim vlera të bazuara njerëzore si empatia, solidaritet, liria, barazia, drejtësia kur vazhdimisht na servohet qasja e Makijavelit për realizimin e qëllimit? Si të ndërtojmë barazinë duke e ditur se ne jemi vendi me ndarjen më të madhe të shtresave klasore në Evropë, vendi në të cilin mbi 180 000 qytetarë jetojnë me më pak se 60 den. në ditë? Si ta llogojmë ndikimin e partive politike që i okupojnë dhe kontrollojnë të gjitha sferat e jetës, ndërsa perceptohen si zyra të punësimit ku vlerat intelektuale dhe kulturore që një njeri i bart me vete janë më pak të rëndësishme?

Me sa duket, është e pamundur, por zgjidhje megjithatë ekziston.

Arsimi

„Arsimi është arma më e fortë që mund ta përdorim për ta ndryshuar botën.»

Nelson Mandela

Arsimi është një proces që mbështet të mësuarit, përvetësimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe shprehive, dhe padyshim do të pajtohem se qëllimi i arsimit është që ta lehtësojë dhe përmirësojë jetën e të gjithëve që janë të përfshirë në këtë proces. Që të mundemi ta ndryshojmë botën ku jetojmë, shkolla - institucioni më i rëndësishëm arsimor, duhet të drejtohet në zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativitetin, se si krijohen breza të gatshëm të mendojnë në mënyrë të pavarur, të inkurajuar ta përdorin kreativitetin e tyre për zgjidhjen e problemeve me të cilat përballen, ose do të përballen në jetën e tyre.

Rezultatet nga testimet ndërkombëtare tregojnë se sistemi arsimor në Maqedoni është në gjendje kome të thellë. Më shumë se dy të tretat e të rinjve në Maqedoni të moshës 15 vjeçare janë funksionalisht analfabetë gjegjësisht aftësitë e tyre të fituara për lexim dhe shkrim janë të papërshtatshme për „përballjen me jetën e përditshme dhe obligimet për të cilat janë të nevojshme aftësi për lexim, më të larta nga niveli fillor”. Këto të dhëna alarmante tregojnë se po e humbasim armën më të fortë me të cilën mund ta ndryshojmë botën dhe nuk është çudi e as rastësi që nuk jemi të kënaqur me kualitetin e jetës dhe progresin që arrijmë.

Si mësimdhënës i përfshirë në sistemin arsimor të Maqedonisë do të lejojë të vlerësoj se sistemi ynë arsimor dështon edhe në aspektin e edukimit të shumë temave të rëndësishme të cilat do të kontribuojnë për përmirësimin e shoqërisë në të cilën jetojmë. Duke pasur parasysh se përveç veprimtarisë arsimore shkollat kryejnë (ose duhet të kryejnë) edhe veprimtari edukative, nuk mund e të mos pyesim veten se ku po ngecim.

Nëse merren parasysh të gjitha format e dhunës në mesin e të rinjve, të cilat tashmë po bëhen përditshmëri dhe për të cilat vazhdimisht lexojmë në media, pa dallim se a ndodh kjo dhunë brenda ose jashtë shkollës, dështimi i komponentit edukativ në procesin arsimor është më se e qartë.

Vetë përfundimi është i nevojshëm - ndryshimet janë të domosdoshme dhe të menjëhershme, por si deri tek ta?

Kultura e jo- dhunës

Që në vitin 1998 Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e shpalli dekadën e parë të shekullit 21 për Dekadë ndërkombëtare për kulturën e paqes dhe jo-dhunës për fëmijët në botë. Deklarata e KB-së u jep përparësi fëmijëve si kategori më e prekshme. Por fëmijët gjegjësisht të rinjtë janë gjithashtu edhe bartës të së ardhmes dhe vetëm nëpërmjet edukimit dhe inkurajimit të tyre mund të shpresojmë për të arritur një kulturë të paqes dhe jo-dhunës.

Me konceptin e arsimit paqësor për herë të parë u takova para tre viteve, falë disa trajnerëve të rinj dhe entuziast të cilët fuqishëm besojnë se një botë më e mirë është e mundur dhe pa egoizëm i ndajnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre me të gjithë mësimdhënësit tek të cilët mund të arrijnë, duke pasur parasysh se mësimdhënësit janë një nga burimet kryesore të ndikimit mbi

të rinjtë. Ky tekst në fakt është frymëzuar prej tyre dhe shpresoj se do të arrij që përvojën pozitive ta përcjellë tek të gjithë ju të cilët aktualisht jeni duke e lexuar këtë, duke besuar se në interes të gjeneratave të ardhshme, por edhe për veten tonë, do të angazhoheni në mënyrë aktive në ndërtimin e kulturën së jo-dhunës.

Është e vështirë të përkufizohet saktësisht se çfarë paraqet arsimi paqësor, por në parim ai promovon njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera të domosdoshme për ndryshime në sjelljen të cilat do t'u mundësojnë fëmijëve dhe të rinjve (gjithashtu edhe të rriturve) që të parandalojnë konfliktet që rezultojnë me dhunë, në mënyrë paqësore të bëjnë zgjidhjen e konflikteve dhe të krijojnë kushte për ndërtimin e paqes në nivel ndërpersonal, intrapersonal, ndërgrupor, kombëtar ose ndërkombëtar. Ose, me fjalë të tjera, fitimin e vlerave, njohurive, qëndrimeve, shkathtësive dhe sjelljes për jetesë harmonike me veten, të tjerët dhe natyrën.

Ajo që më së shumti më nxiti të punoj dhe të hulumtoj në fushën e arsimit paqësor është se jo-dhuna nuk do të thotë pasivitet, por konfrontim aktiv, konstruktiv dhe kreativ me konfliktet. Punëtoritë në të cilat kam fituar shkathtësitë për përpunimin e konflikteve dhe zgjidhjen e tyre në mënyrë jo të dhunshme përfshijnë një pjesë të madhe të shkathtësive të tilla si: zhvillimi i komunikimit, bashkëpunimit, rishikim dhe reflektim, ndërtim të vlerave dhe qëndrimeve, përballimi me emocionet, paragjykimet, stereotipet dhe dallimet – shkathtësi të cilat qoftë për shkak të mungesës së kohës apo njohurive adekuate të punëtorëve të arsimit, anashkalohen në arsimin formal. Por për mua gjëja më e rëndësishme është se pjesëmarrësve në proces u jepet hapësirë e mjaftueshme dhe kohë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre, ti dëgjojnë të tjerëve dhe ti pranojnë dallimet në mes tyre duke lënë hapësirë për ndryshimin e pikëpamjeve fillestare. Është shumë e rëndësishme që të theksohet se arsimi paqësor nuk ofron leksione të gatshme të cilat në mënyrë të verbër duhet të pranohen apo zgjidhje të gatshme që duhet pa kushte të ndiqen, por mundëson një hapësirë të sigurt për komunikim, shkëmbimin e përvojave, duke mësuar nga njëri-tjetri dhe zhvillimin e kreativitetit dhe mendimit kritik.

Paragjykime, pabarazi, padrejtësi

Një studim në vitin 2017 në Universitetin Viktoria në Vellington, i cili është kryer në 36 vende, thekson se pabarazia në shoqëri ndikon fuqishëm në krijimin e paragjykimeve tek njerëzit. Nëse e pranojmë vetëm faktin se Maqedonia është një shoqëri me një klasë enorme shtresash, lehtë do të konkludojmë se bëhet fjalë për një komunitet njerëzish në të cilën paragjykimet janë vazhdimisht të pranishme dhe me këtë paraqesin burim të pashtershëm të sjelljes së dhunshme, pasojë e mungesës së aftësive dhe të kuptuarit të koncepteve të tilla si pranim dhe tolerancë nga njëra anë, por edhe artikullim i padrejtësisë dhe angazhim aktiv për përballimin me të njëjtën, nga ana tjetër.

Arsimi paqësor, nga përvoja ime, tenton në sanimin e këtij problemi duke inkurajuar përkushtimin ndaj parimeve të paqes dhe drejtësisë sociale, domethënë kundërshton jo vetëm dhunën direkte (personale) por edhe dhunën strukturore.

Në vazhdim, shoqëritë multikulturore siç është e jona, në të cilën ngjeshen shumë kultura, janë të ekspozuara ndaj më shumë sfidave në aspektin e dhunës strukturore në aspektin e shtypjes

përmes ideologjisë, religjionit dhe të ngjashme. Nga këtu, nevoja për pranimin e Arsimit paqësor si pjesë e procesit arsimor është edhe më e madhe, sepse jo vetëm që ofron mundësi për t'u përballur me një padrejtësi konkrete dhe dëbimin e një stereotipi të caktuar, por ofron edhe hapësirë për veprim të përbashkët të njerëzve që u përkasin kulturave të ndryshme. Një shembull i tillë konstruktiv është angazhimi i aktivistëve të paqes për mjedisin jetësor, çështje e cila në mënyrë të pashmangshme bashkon të gjithë njerëzit , pavarësisht nga diversiteti.

Pse arsim paqësor?

Në rrethana ku të rinjtë në shoqërinë tonë po përballen me presion të vazhdueshëm nga mjedisi ku ata jetojnë, kur mësimin më së shumti e ndjekin të ndarë nga njëri-tjetri për shkak të përkatësisë së tyre etnike, madje edhe kur personat më me ndikim në shoqëri (për fat të keq tek ne ato janë politikanët) haptazi demonstrojnë dhunë brutale pa asnjë ndërgjegjësim për pasojat, kur edukimi formal është i pafuqishëm për t'u përballuar me pasojat e një shoqërie të konsumuar e cila në mënyrë galopante i shtrembëron të gjitha normat morale, është e pashmangshme të punojmë në kulturën e jo-dhunës dhe në mënyrë sistematike të njëjtën ta inkadrojmë në arsim. Por përse unë personalisht përpiqem për arsim paqësor?

Sepse arsimi paqësor hap çështje të hidhura nga paleta e gjërë e temave nga fusha e të drejtave të njeriut, paragjyqimeve, diskriminimit, mjedisit jetësor, gjëra për të cilat nuk jemi mësuar të diskutojmë sy më sy . Për arsye se arsimi paqësor punon në drejtim të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë jo të dhunshme duke detektuar burimin dhe duke eliminuar mundësitë për zhvillimin e eskalimeve më serioze. Sepse arsimi paqësor e ekspozon pushtetin personal dhe politik, emancipon dhe liron. Për shkak se mundëson kohezionin social dhe mbështetjen e grupeve të marginalizuara.

Sepse i motivon pjesëmarrësit haptazi dhe pa frikë ti shprehin mendimet e tyre, të dëgjojnë në mënyrë aktive, të ndërtojnë botë të reja dhe për të pranuar diversitetin. Sepse zgjon vetëdijen për vetërespekt dhe respektin për tjetrin. Për shkak se ofron aftësi për negociim , zhvillon përgjegjësinë shoqërore, e stimulon të menduarit kritik dhe qasjen proaktive në zgjidhjen e problemeve.

Sepse propagandon empati, solidaritet, barazi, paqe dhe harmoni . Sepse përmirëson cilësinë e jetës.

Një botë më e mirë është e mundur! Do të ndërtojmë një botë më të mirë!

Arsimi është në hap.

Zhana Zhivadinoviç punon si mësimdhënëse e gjuhës angleze në shkollën e mesme ekonomike dhe juridike të qytetit të Shkupit „Arseni Jovkov”. Agjiton për drejtësi sociale, arsim cilësor dhe barazi. Ka besime të thella antimilitariste dhe beson fuqimisht që një botë më e mirë është e mundur.



6. ARSIMI PAQËSOR MUND TË JETË MËNYRË JETESE

Gjimnazi “Zdravko Çoçkovski/ 28 Nëntori”- Dibër ka disa vite që bashkëpunon me Ambasadën e parë të fëmijëve në botë “Megjashi” në kuadër të projektit “Arsim paqësor”.

Unë si psikologe shkollore me përvojë gati pesë vjeçare jam inkuadruar në projektin “Arsim paqësor” që nga fillimet e punësimit tim.

Si shkollë dygjuhësore dhe në të njëjtën kohë edhe multietnike, prioritet i këtij institucioni janë marrëdhëniet e mira mes kolegëve dhe nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike dhe fetare.

Bashkëjetesa mes komuniteteve të ndryshme në qytetin tonë është një pjesë shumë e rëndësishme e edukimit në familje dhe shkollë.

Dibra është qytet për shembull kur flitet për bashkëjetesën mes komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare por kjo nuk do të thotë se nuk duhet të punohet në kontinuitet që këto raporte të ruhen, përmisohen dhe të trashëgohen tek gjeneratat e reja.

Projekti “Arsim paqësor” na ofron përkrahje të konsiderueshme në arritjen e këtij qëllimi nëpërmjet organizimit të trajnimeve për kuadrin mësimor të inkuadruar në projekt dhe shërbimin profesional me qëllim arritjen dhe përsosmërinë e shkathtësive dhe aftësive të individëve të përfshirë të organizojnë dhe realizojnë puntori dhe aktivitete me nxënës sa u takon temave paqe, respektim i të drejtave të njeriut, zgjidhje paqësore e konflikteve, bulizmin, ndërmjetësimin në shkollë, rritjen e vetëdijes ekologjike etj.

Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme të këtij projekti mundëson njohje të reja me kolegë nga e gjithë Maqedonia, shkëmbim të përvojave dhe ideve me qëllim përmisimin e raporteve me nxënësit por edhe mes kolegëve.

Këto trajnime na kanë mundësuar që të eksplorojmë veten dhe të tjerët, të njohim më mirë veten tonë, të ballafaqohemi me të kaluarën e vendit tonë dhe të jemi pjesë e rindërtimit të qëndrimeve më të shëndosha për komunitetet për të cilat kemi pasur më shumë paragjykitime se njohuri.

Ekipi profesional që udhëheq këtë program është gjithmonë në gatishmëri për të na ndihmuar dhe këshilluar por edhe për të na nxitur që aktivitetet e planifikuara të kryhen në kohë dhe me sukses.

Në frymën e arsimit paqësor në shkollën tonë janë realizuar disa puntori dhe aktivitete me nxënës në të cilat janë trajtuar tema për të drejtat e njeriut me theks të veçantë në luftën kundër trafikimit me njerëz, pagën, solidarizim me fëmijët refugjatë sirianë, inkluzion i fëmijëve me aftësi të kufizuara, humanizmin dhe empatinë.

Këto puntori nxisin punën në grupe të kolegëve, ndërsa puna në grup nxit njohjen më të mirë të kolegëve mes veti, bashkëpunimin, ndjenjën e përgjegjësisë, pjesëmarrjen e përbashkët dhe ndarjen e detyrave, ndjeshmëri të nevojave, respektim dhe pranim të diversiteteve, vendimarrje të përbashkët, komunikimin dhe besimin.

Ky program promovon vlera të cilat shpeshherë i ndjejmë si të humbura. Mirëkuptimi, toleranca, respekti dhe besimi reciprok janë vlera të cilat mundësojnë krijimin e raporteve të shëndosha dhe konstruktive mes njerëzve që ndajnë të njëjtën hapësirë jetese pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, gjinore apo edhe moshën.

Arsimi paqësor mund të jetë mënyrë jetese, është e ardhmja e gjeneratave tona të reja.

Arbana Pasholli, psikologe e diplomuar.

E lindur në vitin 1981 në Dibër.

Tre vite të shkollën së mesme i kam kryer në Dibër ndërsa kam diplomuar në shkollën e mesme Eldora New Providence High School në Eldora, Iowa, SHBA.

Studimet i kam kryer në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodij” në Shkup, Fakulteti Filozofik, Instituti i Psikologjisë.

Profesionin e psikologes të shkollës e ushtroj që nga viti 2014.

Me programin “Arsim pagësor” të Ambasadës të parë të fëmijëve në botë Megjashi jam e angazhuar që nga fillimet e ushtrimit të profesionit tim.

Puna ime njëkohësisht është edhe pasioni im. Të punosh me rini do të thotë të mos plakesh kurrë.

7. PËRVOJA NGA SHMQSH “NIKOLLA KAREV”

Maja Filipovska, mësimdhënëse e gjuhës angleze në SHMQSH gjimnazi “ Nikolla Karev” – Shkup.

Jam profesionist kreativ, trajner i paqes, trajner, mediator, mësimdhënës i përkushtuar, mentor dhe tutor. Mendoj se jam punonjës efektiv në ekip me aftësi të fuqishme ndërpersonale, aftësi komunikimi dhe motivimi, e aftë të organizoj dhe të shpërndaj sipas prioriteteve. Unë jam mësimdhënës me arritje të jashtëzakonshme në mësimdhënie dhe edukim, trajim, përkthim, administrim dhe menaxhment.

Jam pjesë e Ekipit për arsim paqësor që nga fillimi që synon futjen e arsimit paqësor në procesin arsimor si një pjesë thelbësore e saj, kordinatore e Ekipit për integrim ndëretnik dhe mentor në Ekipin për model të parlamentit evropjan, që i sjell vlerat evropiane më afër pjesëmarrësve në proces arsimi.

Jam përkrahëse për integrimin e të gjithëve, posaçërisht të fëmijëve dhe të rinjve në të gjitha segmentet e jetës, sigurimin e mundësive të barabarta për jetë cilësore dhe të sigurt, respektimin dhe pranimin e diversitetit dhe nxitjen e drejtësisë shoqërore.

Gordana Blazhevskaja Spiridonova

Është psikolog i diplomuar në Institutin e Psikologjisë në Univerzitetin „Shën Kirili dhe Metodi“, geshtallt terapistë e certifikuar. Punon si psikologe e shkollës në Gjimnazin „Nikola Karev“ në Shkup. Punon me të rinj dhe në punë synon të sigurojë mirëqenien e të rinjve, duke respektuar nevojat dhe duke nxitur zhvillimin e tyre personal, përgjegjësinë dhe kapacitetet që të jenë përkrahje për komunitetin.

Me Megjashin është nga fillimet e punës të arsimit paqësor. Kënaqet të punojë me të rinjtë - duke investuar në to dhe me ata të pasurohet personalisht.



SFIDA / MUNDËSI

Si të fillohet me arsimimin paqësor në një shkollë në të cilën paraprakisht kurrë nuk është përdorur kjo shprehje?!

Përgatitja

- Njoftimi i të punësuarve, drejtorisë dhe arsimtarëve, nxënësve, institucioneve dhe prindërve me shprehjen, kuptimin dhe vizionin e arsimimit paqësor dhe gjetja e mënyrave për promovimin e tij;
- Dorëzimi i lajmërimit deri te prindërit me përshkrimin e kohës, qëllimeve dhe mënyrën e punës me nxënësit;
- Informimi i drejtorisë së shkollës për mënyrën e punës, qëllimet, llojet e aktiviteteve dhe njoftimi për rezultatet e aktiviteteve, postimi i fotografive në faqen e fejsbukut për arsimim paqësor në shkollë, dedikuar për informimin e nxënësve dhe të interesuarve tjerë;
- Bashkëpunimi me Byronë për Zhvillimin e Arsimit, Ministrinë e Arsimit dhe me shkollat tjera me ftesa për bashkëpunim dhe informacione për mënyrën e punës.


Të krijohet programi për punë e cila është në harmoni me nevojat e atyre që janë prezent në shkollë

- Punë e cila përfshin raport të barabartë, ku arsimtarët dhe nxënësit bashkëpunojnë dhe barazisht marrin pjesë në përgatitjet dhe në realizimin e aktiviteteve;
- Zbulimi i nevojave të nxënësve – përdorimi i anketave, pyetësorëve, lista informuese.

Të sigurohet qëndrueshmëria

- Krijimi i kushteve për punën e arsimimit paqësor që të bëhet pjesë e punës së rregullt në shkollë;
- Sigurimi i temave dhe aktiviteteve që janë sfida për nxënësit;
- Promovimi i arsimimit paqësor, promovimi i punës së arsimimit paqësor dhe disponueshmëria për ata arsimtarë të cilët gjithashtu tregojnë interesim që të inkuadrohen.

Bashkëpunimi me institucionet dhe sigurimi i implementimit të arsimimit paqësor në shkollë me anë të bashkëpunimit me institucionet



**KRIJIMI I PUNËS SË NJË KLUBI PAQËSOR
DISA PËRVOJA TË MIRA
(Procesi i formimit të punës së KP në SHMQSH „Nikolla Karev “ – Shkup)**

1. Fillimi

- Formoni grup të nxënësve të cilët vullnetarisht do të lajmërohen dhe të cilët janë të interesuar për këto tema. Pas njoftimit të tyre, formoni faqe të përbashkët në FB ose internet faqe për komunikim dhe shkëmbim më të mirë, informim të nxënësve rreth orarit të takimeve dhe njoftimit për rëndësinë e arsimimit paqësor.

Oferta deri te nxënësit për temat nga arsimimi paqësor dhe zgjedhja bashkërisht se çfarë do të punohet. Në këtë mënyrë qysh në fillim nxënësit do ta ndjejnë veten të inkuadruar, që është komponentë e rëndësishme për funksionim të mirë të klubit.

- Formoni bashkë me nxënësit dhe arsimtarët programin e punës me të cilën do të definohen detyrat e të gjithë pjesëmarrësve në proces – profesorët edukatorë (nëse janë) dhe nxënësit.
- Formoni logon dhe sloganin e klubit paqësor.

Diçka që do t'u ndihmojë nxënësve që të identifikohen me klubin, me aktivitetet dhe me njëri-tjetrin.

2. Puna e klubit – aktivitetet, punëtoritë, bashkëpunimi

- ♦ Temat e mundshme për punëtoritë

Temat e mundshme për punëtoritë: puna ekipore, komunikimi, komunikimi pa dhunë, paragjykimet, diskriminim, konflikte, zgjidhje të konflikteve, ndjeshmëria sociale, gjuha e urrejtjes, të drejtat e fëmijëve, ndërmjetësimi...

Organizimi i aktiviteteve tjera:

Forum dhe teatër vallëzimi, flesh mob, shpërndarja e mesazheve të paqes qytet-arëve në qytet me kartolina për Vitin e Ri ose tullumbace, shkrimi i porosit të paqes te muri i paqes, pjesëmarrja nëpër debate, shënimi i ditëve si Dita Botërore e Paqes (21 shtator) ose Dita Botërore e të drejtave të njeriut (10 dhjetor)...

- ♦ Organizimi i aktiviteteve tjera
- ♦ Bashkëpunimi me shkollat tjera

Bashkëpunimi me shkollat tjera:

ndeshje sportive pa karakter garues, forum dhe teatër vallëzimi, flesh mob, punëtori të përbashkëta, aktivitete të përbashkëta për aktivizëm paqësor, përgatitja e programit të përbashkët për punë, festime të përbashkëta, hulumtime të përbashkëta për efektin nga arsimimi paqësor nëpër shkollë ku realizohen aktivitete për arsimim paqësor, krahasuar me ato shkollë në të cilat nuk ka këso aktivitete, përgatitje të përbashkët të ngjarjeve në të cilat me performancë masive kreative ndikohet në vetëdijen e bashkësisë më të gjerë, aktivitete të përbashkëta për fshirjen e gjuhës së urrejtjes dhe zëvendësimi me porosi paqeje nëpër qytet, punimi i një blloku të përbashkët nëpërmjet të cilit ndikohet në vetëdijën lidhur me arsimimin paqësor të bashkëmoshatarëve...

Bashkëpunimi me ambasadën e parë të fëmijëve Megjashi

APBF Megjashi mundëson lloje të ndryshme të trajnimeve dhe stërvitjeve për arsimim paqësor për profesorët, mentorim, përkrahje dhe ndihmë në realizimin e aktiviteteve nëpërmjet resurseve që i ka (njohuri, informacione dhe kontakte, resurse materiale etj.).

Pjesëmarrja në aktivitete në qytet

Pjesëmarrja nëpër aktivitete në qytet, për shembull, përfshirjen në marshin e paqes në qytet në përkrahje të vlerave dhe ndryshimeve pozitive në bashkësi.

3. Rrumbullakimi i punës vjetore me punëtori përfundimtare

- ♦ Vizita e objekteve kulturore-historike dhe religjioze

Mënyra e njohjes së kulturave, traditave dhe njerëzve.

Organizimi i punëtorisë njëditore

Temat janë kompletimi i asaj që është punuar gjatë tërë vitit dhe rrym-bullakimi i qëllimeve të vendosura.

Shoqërimi bashkërisht duke u freskuar dhe drekë të përbashkët

Mundësia për shoqërim dhe njohje në një atmosferë relaksuese.

KOMUNIKATË

PËR REALIZIMIN E PUNËTORISË SË PARË TË KLUBIT PËR ARSIMIM PAQËSOR¹⁾

Lajmërohen të gjithë nxënësit që janë paraqitur për të marrë pjesë në Klubin e të Rinjve për arsimim paqësor, se punëtorja e parë do të mbahet:

12.10. – e mërkurë, në ora 12.30 për vitin e parë dhe të tretë

12.10. – e mërkurë, në ora 13.00 për vitin e dytë dhe të katërt.

Punëtoritë do të mbahen në kabinetin 21. Klasa gjendet në lokalet e bodrumit, menjëherë afër klasës së artit muzikor.

¹⁾ punëtoritë të cilat realizohen në Programin për arsim paqësor mund të kenë burime nga projekte dhe programe të tjera të cilat sipas vlerave janë të afërta me Programin për arsim paqësor dhe zgjidhen sipas interesit të nxënësve

PUNËTORIA HYRËSE PËR NJOHJE TË NDËRSJELLË DHE NJOFTIM ME PROGRAMIN E PUNËS SË KLUBIT DHE ME PROGRAMIN PËR PUNË NË ARSIMIMIN PAQËSOR

Qëllimet e punëtorisë	Aktivitetet	Koha e realizimit	Materialet e nevojshme
Njohja mes anëtarëve të Klubit të Paqes, edukatorëve –profesorëve të paqes dhe edukatorëve të rinj të paqes; Njohja e nxënësve anëtarë të Klubit të Paqes me programin e arsimimit paqësor.	Pjesa hyrëse: Aktiviteti fillestar për njohjen dhe ngrohjen e grupit (Në realizimin e punëtorisë janë të përfshirë katër profesorë përgjegjës dhe dy studentë –edukatorë të paqes); „Tregojmë emrat“ Pjesëmarrësit ndahen në 3 grupe dhe secili grup punon me njërin prej edukatorëve. Nxënësit sipas udhëzimeve të liderit i tregojnë emrat me një gjest, lëvizje të trupit me të cilën e prezantojnë vetveten. Secili prej anëtarëve e ka për detyrë që ta përsërisë emrin dhe gjestin e atyre që e kanë treguar më parë. Pyetje: 1. A ju pëlqeu loja? 2. Çka ishte e lehtë, çka e vështirë, çka e këndshme, çka e pakëndshme?	10 min.	
	Pjesa kryesore: Aktiviteti: Nxënësit ndahen në gjashtë grupe duke i thënë me radhë numrat nga 1-6, prapë nga fillimi dhe pastaj të gjitha njësitë grupohen, të gjithë çiftet dhe kështu me radhë deri te numri gjashtë. Këto gjashtë grupe marrin udhëzime që të bisedojnë për kuptimet e mundshme të shprehjes arsimim paqësor dhe çka mundet ose do të duhet të përfshijë arsimimin paqësor. Pas një kohe kur mendojnë se janë konsumuar të gjitha njohuritë dhe idetë, lideri i grupit ndan pyetjet paraprakisht të përgatitura, për të cilat çdo grup do të përgatitë prezantim të shkurtër dhe do ta prezantojë para të tjerëve. Konkluzionet i shkruajnë në flipçart-tabelë njëri nga edukatorët – liderë të grupeve, me ç'rast përmbledhen qëllimet e programit për AP sipas grupeve.	5 –7 min. 35 min.	Materiali paraprakisht i përgatitur për punë: -fleta të punës, fleta të bardha për përfundimet për prezantimet, stilolapsa. flipçart, letër, markerë.

	Pjesa përfundimtare: Aktiviteti: Në tabelën e madhe të bardhë ngjiten fletët në të cilat janë shënuar/përmendur disa qëllime dhe aktivitete të Klubit të Paqes dhe AP. Nxënësve të ndarë në grupe u ndahen fletët me fjalitë që përfshijnë përshkrimin e aktiviteteve ose qëllimet në programin e AP. Nxënësit kanë për detyrë që t'i radhisin fletët në këto grupe. Në aktivitet marrin pjesë të gjithë anëtarët e grupeve me ngjitjen e fjalive të tyre në grupin e duhur. Pas kësaj, ata ulen në rreth. Njëri prej edukatorëve e udhëheq aktivitetin përfundimtar dhe nëpërmjet diskutimit bisedohet për vendosjen e duhur të qëllimeve dhe aktiviteteve që do të paraqesin programin për punë të Klubit të Paqes. Rrethi përfundimtar Njëri prej edukatorëve thotë se para përfundimit të secilës punëtori, nevojitet që të bëhet rrethi përfundimtar në të cilin të gjithë tregojnë se si e ndejnë veten dhe ndonjë koment përfundimtar për punëtorinë në tërësi.	10–15 min. 10 min. 15 min. 5 min.	Materiali paraprakisht i përgatitur për punë: Flipçart, një tabelë e madhe e bardhë, fleta të bardha për konkluzionet për prezantimet, stilolapsa, flipçart, letër, markerë.
--	---	---	--

KRIJIMI I POLITIKËS SË ARSIMIMIT PAQËSOR NË SHKOLLË

FORMIMI I PATRULLAVE RINORE TË PAQES

SENSIBILIZIMI PËR NJOHJEN E FORMAVE TË SJELLJES SË DHUNSHME

ARRITJA DHE ZHVILLIMI I AFTËSIVE PËR KOMUNIKIM DHE ZGJIDHJE PA DHUNË TË KONFLIKTEVE

KRIJIMI I POLITIKËS SË ARSIMIMIT PAQËSOR NË SHKOLLË

BASHKËPUNIMI ME SHKOLLAT TJERA, ME NXËNËS DHE ME TË RINJ.

A mendoni se në shkollë nevojitet që nxënësit të inkuadrohen në aktivitete rinore?	A mendon se të rinjtë mund të kontribuojnë me inkuadrimin e tyre aktiv për përmirësimin e marrëdhënieve mes nxënësve në shkollë?	A mendon se nxënësit i dallojnë format e ndryshme të dhunës në shkollë- verbale, fizike, gjinisë, elektronike, ndëretnike?	Mendon se në shkollë është e nevojshme që nëpër vendet publike të janë të vendosura mesazhet e paqes të cilat do të ndihmonin në zhvillimin e kulturës për komunikim të sigurt në shkollë?
A mendon se nxënësit kanë nevojë që të arrijnë njohuri dhe aftësi për komunikim jo të dhunshëm dhe zgjidhje pa dhunë të konflikteve?	A mendon se nxënësit kanë nevojë që t'i mësojnë disa mënyra se si ta njohin ndonjë situatë para konfliktit dhe si të reagojnë në atë situatë?	A mendon se në shkollën tonë nevojitet që të krijohet politikë e shkollës për jo tolerancë të dhunës?	A mendon se nxënësit e shkollave të ndryshme duhet të lidhen mes veti dhe të bashkëpunojnë lidhur me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ta?

A mendoni se në shkollë nevojitet që nxënësit të inkuadrohen në aktivitete rinore?	A mendon se të rinjtë mund të kontribuojnë me inkuadrimin e tyre aktiv për përmirësimin e marrëdhënieve mes nxënësve në shkollë?	A mendon se nxënësit i dallojnë format e ndryshme të dhunës në shkollë – verbale, fizike, gjinisë, elektronike, ndëretnike?	Mendon se në shkollë është e nevojshme që nëpër vendet publike të janë të vendosura mesazhet e paqes të cilat do të stimulonin zhvillimin e kulturës për komunikim të sigurt në shkollë?
A mendon se nxënësit kanë nevojë që të arrijnë njohuri dhe aftësi për komunikim pa dhunë dhe zgjidhje pa dhunë të konflikteve?	A mendon se nxënësit kanë nevojë që t'i mësojnë disa mënyra se si ta njohin ndonjë situatë para konfliktit dhe si të reagojnë në atë situatë?	A mendon se në shkollën tonë është e nevojshme që të krijohet politika e shkollës për jo tolerancë të dhunës?	A mendon se nxënësit e shkollave të ndryshme duhet të lidhen mes veti dhe të bashkëpunojnë lidhur me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ta?

A mendoni se në shkollë nevojitet që nxënësit të inkuadrohen në aktivitete rinore?	A mendon se të rinjtë mund të kontribuojnë me inkuadrimin e tyre aktiv për përmirësimin e marrëdhënieve mes nxënësve në shkollë?	A mendon se nxënësit i dallojnë format e ndryshme të dhunës në shkollë – verbale, fizike, gjinisë, elektronike, ndëretnike?	Mendon se në shkollë është e nevojshme që nëpër vendet publike të janë të vendosura mesazhet e paqes të cilat do të stimulojnë zhvillimin e kulturës për komunikim të sigurt në shkollë?
A mendon se nxënësit kanë nevojë që të arrijnë njohuri dhe aftësi për komunikim pa dhunë dhe zgjidhje pa dhunë të konflikteve?	A mendon se nxënësit kanë nevojë që t'i mësojnë disa mënyra se si ta njohin ndonjë situatë para konfliktit dhe si të reagojnë në atë situatë?	A mendon se në shkollën tonë është e nevojshme që të krijohet politika e shkollës për jo tolerancë të dhunës?	A mendon se nxënësit e shkollave të ndryshme duhet të lidhen mes veti dhe të bashkëpunojnë lidhur me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ta?
A mendoni se në shkollë nevojitet që nxënësit të inkuadrohen në aktivitete rinore?	A mendon se të rinjtë mund të kontribuojnë me inkuadrimin e tyre aktiv për përmirësimin e marrëdhënieve mes nxënësve në shkollë?	A mendon se nxënësit i dallojnë format e ndryshme të dhunës në shkollë – verbale, fizike, gjinisë, elektronike, ndëretnike?	Mendon se në shkollë është e nevojshme që nëpër vendet publike të janë të vendosura mesazhet e paqes të cilat do të ndihmojnë zhvillimin e kulturës për komunikim të sigurt në shkollë?
A mendon se nxënësit kanë nevojë që të arrijnë njohuri dhe aftësi për komunikim pa dhunë dhe zgjidhje pa dhunë të konflikteve?	A mendon se nxënësit kanë nevojë që t'i mësojnë disa mënyra se si ta njohin ndonjë situatë para konfliktit dhe si të reagojnë në atë situatë?	A mendon se në shkollën tonë është e nevojshme që të krijohet politika e shkollës për jo tolerancë të dhunës?	A mendon se nxënësit e shkollave të ndryshme duhet të lidhen mes veti dhe të bashkëpunojnë lidhur me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ta?
A mendoni se në shkollë nevojitet që nxënësit të inkuadrohen në aktivitete rinore?	A mendon se të rinjtë mund të kontribuojnë me inkuadrimin e tyre aktiv për përmirësimin e marrëdhënieve mes nxënësve në shkollë?	A mendon se nxënësit i dallojnë format e ndryshme të dhunës në shkollë – verbale, fizike, gjinisë, elektronike, ndëretnike?	Mendon se në shkollë është e nevojshme që nëpër vendet publike të janë të vendosura mesazhet e paqes të cilat do të stimulojnë zhvillimin e kulturës për komunikim të sigurt në shkollë?
A mendon se nxënësit kanë nevojë që të arrijnë njohuri dhe aftësi për komunikim pa dhunë dhe zgjidhje pa dhunë të konflikteve?	A mendon se nxënësit kanë nevojë që t'i mësojnë disa mënyra se si ta njohin ndonjë situatë para konfliktit dhe si të reagojnë në atë situatë?	A mendon se në shkollën tonë është e nevojshme që të krijohet politika e shkollës për jo tolerancë të dhunës?	A mendon se nxënësit e shkollave të ndryshme duhet të lidhen mes veti dhe të bashkëpunojnë lidhur me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ta?

A mendoni se në shkollë nevojitet që nxënësit të inkuadrohen në aktivitete rinore?	A mendon se të rinjtë mund të kontribuojnë me inkuadrimin e tyre aktiv për përmirësimin e marrëdhënieve mes nxënësve në shkollë?	A mendon se nxënësit i dallojnë format e ndryshme të dhunës në shkollë – verbale, fizike, gjinisë, elektronike, ndëretnike?	Mendon se në shkollë është e nevojshme që nëpër vendet publike të janë të vendosura mesazhet e paqes të cilat do të ndihmojnë zhvillimin e kulturës për komunikim të sigurt në shkollë?
A mendon se nxënësit kanë nevojë që të arrijnë njohuri dhe aftësi për komunikim pa dhunë dhe zgjidhje pa dhunë të konflikteve?	A mendon se nxënësit kanë nevojë që t'i mësojnë disa mënyra se si ta njohin ndonjë situatë para konfliktit dhe si të reagojnë në atë situatë?	A mendon se në shkollën tonë është e nevojshme që të krijohet politika e shkollës për jo tolerancë të dhunës?	A mendon se nxënësit e shkollave të ndryshme duhet të lidhen mes veti dhe të bashkëpunojnë lidhur me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ta?
A mendoni se në shkollë nevojitet që nxënësit të inkuadrohen në aktivitete rinore?	A mendon se të rinjtë mund të kontribuojnë me inkuadrimin e tyre aktiv për përmirësimin e marrëdhënieve mes nxënësve në shkollë?	A mendon se nxënësit i dallojnë format e ndryshme të dhunës në shkollë – verbale, fizike, gjinisë, elektronike, ndëretnike?	Mendon se në shkollë është e nevojshme që nëpër vendet publike të janë të vendosura mesazhet e paqes të cilat do të ndihmojnë zhvillimin e kulturës për komunikim të sigurt në shkollë?
A mendon se nxënësit kanë nevojë që të arrijnë njohuri dhe aftësi për komunikim pa dhunë dhe zgjidhje pa dhunë të konflikteve?	A mendon se nxënësit kanë nevojë që t'i mësojnë disa mënyra se si ta njohin ndonjë situatë para konfliktit dhe si të reagojnë në atë situatë?	A mendon se në shkollën tonë është e nevojshme që të krijohet politika e shkollës për jo tolerancë të dhunës?	A mendon se nxënësit e shkollave të ndryshme duhet të lidhen mes veti dhe të bashkëpunojnë lidhur me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ta?
„Më mirë miqësi sesa grindje“	Format e dhunës dhe karakteristikat e disa formave të dhunës	Mënyrat e manifestimit të sjelljes së dhunshme	Nxënësi tallet me shokun/ shoqen e klasës gjersa ai/ajo përgjigjet në orën e mësimi
Një nxënëse i kërcënohet shoqes së saj nëpërmjet SMS mesazhit se do ta pres me shoqe para shkollës dhe do ta “rrahin fort”	Zhvillimi i aftësive për reagim konstruktiv ndaj dhunës dhe mësimi i alternativave pa dhunë për reagim ndaj dhunës	Zhvillimi i aftësisë që të mbahet qëndrimi personal dhe të rezistojë në kushtet e presionit të mjedisit dhe bashkëmoshatarëve ndaj veprimeve të papërshtatshme	Zhvillimi i aftësisë që të kuptohet qëndrimi dhe gjendja e të tjerëve – “me sytë e tjetrit”
Zhvillimi i aftësive të komunikimit – njohja e gjuhës së mosdëgjimit dhe mospranimit; arritja e teknikave të mira të komunikimit	Kuptimi i konflikteve me qëllim të zgjidhjes së tyre me efikase	Kuptimi i rolit, të drejtave dhe përgjegjësisë të të rinjve në shoqëri, bashkësi dhe në shkollë	„Si t'i themi qartë 'JO' dhunës?“

„Mos e kthe kokën në anën tjetër kur je dëshmitar i ngacmimit nga ana e një nxënësi/nxënëse mbi nxënësin/nxënësen tjetër“	Bashkëpunimi është „më i ëmbël“ se grindja	Zhvillimi i qasjes pozitive të konflikteve	Ballafaqimi me gabimet dhe fajin, por në frymën e ndërgjegjësimit për pozitën e „tjetrit“ dhe kuptimi për dhimbjen dhe të humburën nga konflikti
Konflikti ekziston dhe është pjesë përbërëse e jetës	Shembull për „dëgjim aktiv“– bashkëbiseduesi tregon se për atë ka rëndësi që t’ju dëgjojë – i kushton kohë dhe vëmendje	„Përgatitja e fëmijëve për jetë me përgjegjësi në një bashkësi demokratike në frymën e mirëkuptimit, tolerancës, paqes, barazisë së gjinive, miqësisë mes popujve dhe respektimit të mjedisit natyror“	Fëmija ka të drejtë për jetë, të drejtë për emër pas lindjes, të drejtë që t’i njohë prindërit e tij, të ruhet nga prindërit e tij, të drejtë që të arsimohet, që ta shpreh lirisht mendimin e tij, lirinë e shoqërimit, të drejtën e mbrojtjes nga përzierja në privatësinë e tij/saj...
„Më mirë miqësi sesa grindje“	Format e dhunës dhe karakteristikat e disa formave të dhunës	Mënyrat e manifestimit të sjelljes së dhunshme	Nxënësi tallet me shokun/shoqen e klasës gjersa ai/ajo përgjigjet në orën e mësimi
Një nxënëse i kërcënohet shoqes së saj nëpërmjet SMS mesazhit se do ta pres me shoqe para shkollës dhe do ta “rrahin fort”	Zhvillimi i aftësive për reagim konstruktiv ndaj dhunës dhe mësimi i alternativave pa dhunë për reagim ndaj dhunës	Zhvillimi i aftësisë që të mbahet qëndrimi personal dhe të rezistojë në kushtet e presionit të mjedisit dhe bashkëmoshatarëve ndaj veprimeve të papërshtatshme	Zhvillimi i aftësisë që të kuptohet qëndrimi dhe gjendja e të tjerëve – “me sytë e tjetrit”
Zhvillimi i aftësive të komunikimit – njohja e gjuhës së mosdëgjimit dhe mospranimit; arritja e teknikave të mira të komunikimit	Kuptimi i konflikteve me qëllim të zgjidhjes së tyre më efikase	Kuptimi i rolit, të drejtave dhe përgjegjësisë të të rinjve në shoqëri, bashkësi dhe në shkollë	„Si t’i themi qartë ‘JO’ dhunës?“
„Mos e kthe kokën në anën tjetër kur je dëshmitar i ngacmimit nga ana e një nxënësi/nxënëse mbi nxënësin/nxënësen tjetër“	Bashkëpunimi është „më i ëmbël“ se grindja	Zhvillimi i qasjes pozitive të konflikteve	Ballafaqimi me gabimet dhe fajin, por në frymën e ndërgjegjësimit për pozitën e „tjetrit“ dhe kuptimi për dhimbjen dhe të humburën nga konflikti

Konflikti ekziston dhe është pjesë përbërëse e jetës	Shembull për „dëgjim aktiv“– bashkëbiseduesi tregon se për atë ka rëndësi që t’ju dëgjojë – i kushton kohë dhe vëmendje	„Përgatitja e fëmijëve për jetë me përgjegjësi në një bashkësi demokratike në frymën e mirëkuptimit, tolerancës, paqes, barazisë së gjinive, miqësisë mes popujve dhe respektimit të mjedisit natyror“	Fëmija ka të drejtë për jetë, të drejtë për emër pas lindjes, të drejtë që t’i njohë prindërit e tij, të ruhet nga prindërit e tij, të drejtë që të arsimohet, që ta shpreh lirisht mendimin e tij, lirinë e shoqërimit, të drejtën e mbrojtjes nga përzierja në privatësinë e tij/saj...
Bashkëpunimi është „më i ëmbël“ se grindja	Zhvillimi i qasjes pozitive të konflikteve	Ballafaqimi me gabimet dhe fajin, por në frymën e ndërgjegjësimit për pozitën e „tjetrit“ dhe kuptimi për dhimbjen dhe të humburën nga konflikti	Në mënyrë aktive i shpjegoj idetë e mia dhe po aq në mënyrë aktive përpiqem që t’i kuptoj të tjerët
Në mënyrë aktive i shpjegoj idetë e mia dhe po aq në mënyrë aktive përpiqem që t’i kuptoj të tjerët	Në mënyrë aktive i shpjegoj idetë e mia dhe po aq në mënyrë aktive përpiqem që t’i kuptoj të tjerët	Në mënyrë aktive i shpjegoj idetë e mia dhe po aq në mënyrë aktive përpiqem që t’i kuptoj të tjerët	„Mos e kthe kokën në anën tjetër kur je dëshmitar i ngacmimit nga ana e një nxënësi/nxënëse mbi nxënësin/nxënësen tjetër“
„Mos e kthe kokën në anën tjetër kur je dëshmitar i ngacmimit nga ana e një nxënësi/nxënëse mbi nxënësin/nxënësen tjetër“	„Mos e kthe kokën në anën tjetër kur je dëshmitar i ngacmimit nga ana e një nxënësi/nxënëse mbi nxënësin/nxënësen tjetër“		

Punëtorja „Komunikimi dhe komunikimi asertiv“

Qëllimet e punëtorisë dhe aktivitetet:

- njohja e formave kryesore të komunikimit – verbal, joverbal dhe paraverbal;
- njohja me format e komunikimit efektiv;
- nxënësit të janë të vetëdijshëm për të dy palët në dialog dhe për dinamikën e bisedës;
- nxënësit të mësojnë të komunikojnë dhe të lidhen me të tjerët në mënyrë të kënaqshme për të dyja palët në komunikim;
- nxënësit t'i dallojnë „pyetjet e mbyllura“ nga lloji i hapur i pyetjeve;
- të arrijnë njohuri se si t'i përdorin pyetjet e hapura dhe të vijnë deri te informacionet e dobishme;
- të zhvillojnë aftësi për pasurimin e komunikimit.

Aktivitet për ngrohje – Rrethi i bisedimit

Nxënësit renditen në rreth dhe marrin instruksione që të mësojnë disa çështje interesante për bashkëbiseduesin e tij në anën e majtë. Secili duhet të mësojë diçka vetëm për bashkëbiseduesin në anën e majtë. Pastaj ndahen në çifte me bardhë/zi dhe u jepet udhëzimi i njëjtë.

Aktiviteti hyrës 1. Prezantimi i videoklipit me LCD projektor – Format e komunikimit joefektiv, skenë nga filmi „I miri Vill Hanting“.

Diskutim – pyetjet që ju parashtrohen nxënësve për ushtrimin dhe përmbajtjen e të dy videoklipeve:

- Si ndjeheshit gjatë kohës së ushtrimit?
- Si duket kur i drejtohesh dikujt, a të injoron?
- Kuptimi i arsyes së mirë për veprimin e dikujt a na ndihmon që të ndjehemi keq më pak?
- Gjatë komunikimit me të tjerët sa shpesh na ndodh diçka e njëjtë – që vërtetë mos të „dëgjohemi“ dhe vërtetë të kuptuar?
- Si e ndjejmë veten atëherë?
- A na kanë akuzuar ndonjëherë se kështu komunikojmë?

Skena nga filmi – nxënësve u shfaqen skena nga videoklipi dhe parashtrohen pyetje:

- Çfarë forma të komunikimit ekzistojnë?
(nxënësve u thuhet se 40 % gjatë komunikimit, mesazhi dërgohet në mënyrë paraverbale, 40 % në mënyrë joverbale, vetëm 10 % ka komunikim verbal)
- Si zhvillohej komunikimi verbal?
- Si zhvillohej komunikimi joverbal/gjuha e trupit?
- Çfarë keni vërejtur nga komunikimi paraverbal?

Aktiviteti kryesor 1. „Dëgjoj – nuk dëgjoj“

Me numrat 1 dhe 2, nxënësit ndahen në 2 grupe. Karriget vendosen në 2 rrathë – të brendshëm dhe të jashtëm. Grupi 1 ulet në rrethin e brendshëm, ndërsa grupi 2 në rrethin e jashtëm.

Grupi B merr udhëzime që të tregojë për ndonjë situatë që u ka ndodhur kohëve të fundit. Grupi A merr udhëzime që të ndryshojë strategjitë e dëgjimit:

3. Ta dëgjojë bashkëbiseduesin, por me të gjitha shenjat joverbale ta bëjë të kundërtën – të rrotullohet, të shikojë teposhtë, të shikojë anësh, të duket sikur është duke menduar për diçka tjetër etj.
4. Të dëgjojë dhe vetëm të hesht.
5. Të dëgjojë, të përgjigjet dhe të japë fidbek.

Diskutimi:

- Si e ndjetë veten kur të tjerët shtireshin se janë duke ju dëgjuar, por jo me gjithë vëmendje?
- Si e ndjetë veten kur bisedonit me bashkëbiseduesin që shtiret se është duke ju dëgjuar, por duket sikur aspak nuk e ka dert për ju?
- A mund të kujtoni situatat e përditshme reale kur kështu veproni gjatë bisedës dhe me kë?

Aktiviteti kryesor 2. „Pyetjet e hapura dhe pyetjet e mbyllura“

Puna në grupe nga tre veta – dy pjesëmarrës dhe një vëzhgues, në 2 minuta ndërrohen rolet, secili e luan secilin rol. Pjesëmarrësit A dhe B marrin fleta të punës në të cilat janë të përshkruara se si duken ti-deklaratat dhe unë-deklaratat. Vëzhguesi merr një listë në të cilën është e përshkruar një problem që duhet të zgjidhet me përdorimin e unë-deklaratës dhe ti-deklaratës.

Diskutim:

- Si kaloi ushtrimi?
- Si është më lehtë të diskutohet, me ti-deklarata ose me unë-deklarata?
- Çfarë themi me ti-deklarata e çka me unë-deklarata?
- Si u ndjetë kur i përdorët ti-deklaratat, si kur i përdorët unë-deklaratat?
- Sa shpesh përdorni unë-deklaratat në jetën tuaj?

PUNËTORIA PËR ARSIMIMIN PAQËSOR BURIMET DHE LLOJET E KONFLIKTEVE

Qëllimet:

- kuptimi i natyrës së konflikteve;
- njohuri për shkaqet që mund të çojnë deri te konflikti;
- kuptimi i mënyrës së veprimit të faktorëve: nevojat, vlerat, resurset dhe rrezikimi i tyre gjatë paraqitjes së konfliktit;
- kuptimi dhe dallimi i shprehjeve konfliktet funksionale dhe jofunksionale.

Loja për t'i ngrohur - „Nyja“

Nxënësit ndahen në 2 grupe të cilët janë ndarë me emërtimin me numrat 1 dhe 2. Atyre u jepet detyrë që të afrohen afër njëri-tjetrit dhe t'i kapin duart e ndonjërit nga grupi, vetëm jo të bashkëpjesëmarrësve në të majtë dhe në të djathtë të tyre. Pastaj u jepet udhëzimi që të përhapen pa i lëshuar duart dhe të përpiqen që ta zgjidhin nyjën pa i lëshuar duart.

Ushtrimi: Brainstorming – konflikt asociacione

Në fletët e tabelës për prezantime (flipçart) shkruhen të gjitha shprehjet të cilat i thonë nxënësit.

Aktiviteti hyrës: Barometri

Nxënësit ndahen në grupe sipas ngjyrës, ndahen në 5 grupe, varësisht nga madhësia e grupit. Nxënësve u ndahen deklaratat që i vendosin në një vend të caktuar në hapësirën mes pohimeve “pajtohem” dhe “nuk pajtohem”, me çka zhvillohet diskutimi për qëndrimet dhe pozitat që janë marrë.

Aktiviteti 1.

Nxënësit ndahen në 4 ose 5 grupe, varësisht nga madhësia e grupit. Atyre u ndahen fletët e punës Burimet dhe llojet e konflikteve me udhëzime që të lidhen llojet e ofruara të konflikteve me kategoritë e paraqitura të konflikteve.

Pas përfundimit të aktivitetit hyrës, secili grup e shpreh përfundimin duke ia shoqëruar diskutimin për lidhjen e materialit me përvojat nga jeta e përditshme e nxënësve.

Nxënësit udhëhiqen me pyetjet që i përpilon moderatori i aktivitetit për sjelljen e përfundimeve se si i njohim burimet e konflikteve dhe çfarë konflikte mund të krijohen.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit në grupet e njëjta marrin fletë me përshkrimet e situatave konfliktuoze të cilat i përgatit udhëheqësi i punëtorisë.

Diskutim

1. Cilat konflikte i njihni?
2. A mund t'i lidhim dhe emërtojmë konfliktet nga lista e ofruar paraprakisht?
3. Kush ka qenë i përfshirë në këto situata konfliktuoze?
4. Cili është rezultati më i keq nga këto konflikte?
5. Si munden ndryshe të veprojnë palët e përfshira në konflikt?

Aktivitet me lojë: Kolovajzë – lojë besimi

Anëtarët ndahen në 3 grupe (1, 2, 3). Jepet udhëzimi: dy anëtarë janë anësh dhe njëri në mes, ata dy që janë anësh e lëkundin me kujdes personin në mes që është me sy të mbyllur. Ndërrohen nga gjysmë minutë të gjithë 3 personave në të dyja rolet.

FLETA E PUNËS 1. – Llojet e konflikteve

Konfliktet interpersonal – janë konflikte që ndodhin mes individëve, burojnë dhe manifestohen në relacionet, p.sh. mes dy shoqeve, prind – fëmijë, vëlla – motër, nxënës – arsimtar, i lartë – i nënshtruar...

Konfliktet intergrupore janë ato konflikte që paraqiten në mes grupeve me madhësi të ndryshme dhe janë formuar në baza të ndryshme. Në grupe llogariten – familjet, organizatat e punës dhe organizatat e ndryshme formale dhe joformale, bashkësi më të ngushta dhe më të zgjeruara, grupe etnike, shtete, popuj, raca etj.

Konfliktet intragrupore janë konflikte mes pjesëtarëve të grupeve më të vogla dhe sipas rregullit i përfshijnë të gjithë pjesëtarët e grupit, p.sh. në familje (të ngushtë e të gjerë), ekipet sportive, grupet e punës, komisione të ndryshme, këshilla etj.

Llojet e konflikteve

Konflikt struktural – ky është konflikt që buron nga vetë struktura në një grup që është vendosur me qëllime të caktuara, p.sh. struktura në marrëdhënie siç është hierarkia dhe raporti i lartë« -»i nënshtruar, struktura e kohës (saktësia dhe vonimi), struktura e rregullave ose e përgjegjësisë dhe roleve të individëve në grup, kontrolli jo i barabartë i resurseve. Konflikti struktural shpesh çon drejt dhunës strukturale.

Konflikte destruktive janë ato konflikte ku ekziston mungesa e informacioneve, prezenca e vazhdueshme e tensionit, aspirata drejt konkurrencës me qëllim që të mbizotërohet ose të kontrollohet pala tjetër, e përcjellë me mosbesim e jo rrallë është prezente edhe dhuna.

Konflikte konstruktive janë konflikte pozitive, të cilët edhe përkundër dallimeve fillestare, ofrojnë shans për të pastruar marrëdhëniet dhe mundësinë që të ndryshojnë dhe të zhvillohen palët e inkuadruara, të mësojnë nga njëri-tjetri, t'i zhvillojnë marrëdhëniet, ta njohin më mirë vetveten, të mësojnë dhe t'i respektojnë dallimet, të mësojnë në kooperativitet dhe bashkëpunim.

Llojet e konflikteve

Konflikte të interesave – këto konflikte nënkuptojnë interesat e llojit të ndryshëm – nevoja, dëshira, emocione, interesa materiale, interesa lidhur me pozitën.

Konflikt të vlerave – nënkupton konflikte kur njerëzit kanë mospajttime rreth asaj se çka është mirë e çka keq, çka gabim e çka drejtë, çka është e ndershme të bëhet e çka jo e ndershme. Këto konflikte zakonisht janë të rënda kur ndodhin mes njerëzve ose grupeve sisteme të ndryshme të vlerave ose besimeve, me këtë rast të dyja palët luftojnë fuqishëm që ta imponojnë sistemin e tyre të vlerave mbi sistemin e vlerave të palës së përfshirë në konflikt.

Konflikt të informacioneve është konflikt që buron nga mungesa e komunikimit adekuat ose nga ekzistimi i dezinformatave – informacione të gabuara, të vjetruara, të rrejshme, jo të sakta, jo të sigurta. Gjatë këtyre konflikteve del në sipërfaqe vlerësimi i ndryshëm i rëndësisë së informacioneve ose interpretimi i ndryshëm i të dhënave, nganjëherë edhe qasja jo e barabartë e procedurave.

Fletë pune – Pohime për barometër

- Është keq të ndeshesh me dikë
- Kur interesat kundërshtohen, konfliktet nuk mund të zgjidhen
- Fuqia e përcakton zgjidhjen e konfliktit
- Edhe viktima është përgjegjëse për konfliktin sikurse edhe nxitësi
- Konfliktet për nga natyra janë negative
- Në secilin konflikt duhet të ketë një që do ta fillojë
- Më së shumti konflikte kemi me ata që kanë më së shumti rëndësi për ne
- Konfliktet duhet të shmangen
- Gjatë konfliktit, është e pëlqyer që të tregohen emocionet
- Në secilin konflikt, njëra palë duhet të humb
- Nga konflikti nuk mund të dalësh me vetërespekt
- Polemika i pastron problemet
- Zgjidhja e çdo përleshje duhet të përmbajë kompromis
- Në luftë dhe në dashuri gjithçka lejohet
- Grindja mund të zgjidhet vetëm kur njëra parë lëshon pe
- Përleshja e mendimeve është e nevojshme dhe e dobishme
- Në konflikt, të gjitha palët janë njëjtë përgjegjës
- Viktima nuk është përgjegjëse sa është shkaktari

REALIZIMI I PUNËTORISË SË TRETË ME KLUBIN PAQËSOR RINOR ME TEMËN „NDJESHMËRIA SOCIALE“

Qëllimet e punëtorisë	Aktivitetet	Koha e realizimit	Materialet e nevojshme
	Aktiviteti për ngrohje -lojë: „Pinguinë dhe pelikanë“ Pjesëmarrësit janë bashkë në një rreth të madh. Njëri prej pjesëmarrësve është „pelikan“, ndërsa të tjerët janë „pinguinë“. Edukatori me duar tregon se si pelikani do t'i gëlltisë pinguinët dhe i shndërron në pelikanë. Lëviz me hapa të mëdhenj. Pastaj tregon se si lëvizin pinguinët me hapa të vegjël me këmbë afër njëra-tjetrës (sikurse pinguinët e vërtetë), duart e vëna përgjatë trupit, ndërsa pëllëmbët të kthyer nga jashtë. Pelikani i ndjek pinguinët dhe kur i zë, shndërrohen në pelikanë. Të njëjtën e përsërisin edhe pelikanët e rinj gjersa të mos mbetet asnjë pinguin. Kjo mund të diskutohet me pyetjen: Si më të fortit e më të fuqishmit i ndërrojnë qëndrimet dhe mendimin e më të dobëtëve?	3–5 min. 10 min.	

Ndërgjegjësimi për atë se si përjetohen mundësitë e kufizuara; Zhvillimi i ndjenjës së empatisë drejt atyre që nuk kanë mundësi të barabarta; Ndërgjegjësimi se si njerëzit lindin me potenciale të njëjtë, barazi në të drejta dhe në dinjitet, por për shkak të faktorëve të ndryshëm, plotësisht ose jo mjaftueshëm i realizojnë potencialet e tyre. Mundësia që të kuptohen rrethanat për shkak të të cilave shpesh ndodh kjo (rrethanat në shoqëri, ndonjë sëmundje e padëshiruar, prejardhja e ndryshme, statusi social i prindërve, i farefisit). – Mundësia që të bëhet dallimi se si është ndjeshmëria ose pandjeshmëria jonë dhe e shoqërisë ndaj atyre të cilëve u duhet ndihma, mbështetja, për dallim nga ata të cilët ecin para drejt sukseseve; –ndërgjegjësimi për realitetin ose jo realitetin në shoqërinë tonë- sa kujdesemi të gjithë ne për të tjerët dhe sa jemi të vetëdijshëm për ndjenjat e tyre, për pafuqinë e tyre, ndjenjën e izolimit social, ofendimeve, etiketimeve... –lidhja me situatat e vërteta në jetë dhe mundësia për vlerësimin e tyre;	Aktiviteti kryesor 1. Përgatitja Fletët e punës priten në kartela dhe shumëfishohen në numrin e nevojshëm (në skajin e djathtë të secilës kartelë qëndron numri i cili tregon se në sa copa duhet të shumëfishohen kur grupi numëron 20 nxënës). Nëse numri i pjesëmarrësve është më i madh, duhet të rritet edhe numri i copëve të secilës kartelë, por me këtë rast të ruhet raporti mes kartelave të nevojshme që përbëjnë një grumbull. Pastaj kartelat shpërndahen në pesë grumbuj (sipas numrit me të cilin janë shënuar nga ana e majtë e kartelës). Të gjithë ndalen në një vijë (pozita fillestare) pas së cilës para dhe mbrapa ka hapësirë të mjaftueshme. Bëhet sqarimi se kjo është vija e fillimit të secilit prej nesh si qenie të barabarta njerëzore të dhuruar me të gjitha të drejtat dhe liritë e parapara në aktet ndërkombëtare. Secili e tërheq nga një kartelë (situata jetësore) nga secili grumbull. Marrin udhëzime se duhet plotësisht ta harrojnë identitetin e tyre, ta lexojnë me vëmendje atë që shkruan në kartelën e tyre dhe të koncentrohen në rolin e dhënë dhe në atë person (tërësisht të mishërohen me rolin). Marrin udhëzim se do të duhet të lëvizin para –mbrapa ose të qëndrojnë në vendin e njëjtë sipas deklaratave të dhëna të cilat i lexon edukatori dhe udhëzimin se si të lëvizin. (Theksohet se udhëzimin për lëvizje që është shkruar në secilën kartelë nuk guxon ta shohin pjesëmarrësit tjerë). Kur do të lexohen deklaratat dhe pasi që të vijnë deri në fund të klasës, fëmijët ulen në rreth. Diskutim: Pastaj me nxënësit diskutohet duke parashtruar këto pyetje: Si ndjeheshin ata që kanë ardhur deri në “majë”? Si u ndjetë gjersa “ecnit” para, ndërsa të tjerët mbetën pas jush? Si u ndjenë ata që erdhën deri në “fund” ose afër tij? Si u ndjetë gjersa të tjerët ecnin para, ndërsa ju qëndronit në vend? Për çfarë duhet vija fillestare? Si reflektohet pozita sociale mbi mundësitë për gëzimin e të drejtave? A duhet të kënaqemi me gjendjen e këtillë? Në një situatë të këtillë a duhet të bëhet diçka? Si duhet të veprojnë bashkësia për t’u ndryshuar gjërat?	7–10 min. 15 min.	Fletët e punës
--	---	---------------------------------	-----------------------

	Aktiviteti kryesor 2. Barometri Edukatori i lexon deklaratat. Nxënësit radhiten sipas përcaktimeve: pajtohen plotësisht, pajtohen deri diku, nuk pajtohen deri diku ose nuk pajtohen plotësisht. Diskutim: Tani a dimë diçka më shumë për ndjeshmërinë sociale? Cilët faktorë ndikojnë? A jemi të vetëdijshëm për situatën reale për dallimet në të drejtën e mundësive të barabarta? A jemi të vetëdijshëm për atë se a kujdesemi dhe sa kujdesemi për realizimin e të drejtave për mundësi të barabarta për të gjithë? Sa dhe a kujdesemi që të kontribuojmë për ndryshimin e situatës? A kemi menduar ndonjëherë për këto pyetje? A mendojmë se mundemi edhe ne si pjesë e bashkësisë, të bëjmë diçka?	10 min. 10 min.	
	Pjesa përfundimtare: Nxënësit janë bashkë në rreth dhe udhëheqësi ia ofron mundësinë secilit që të thotë shkurt fdbekun për atë se si e ka ndjerë veten gjatë kohës së punëtorisë.	10 min.	

1	Keni lindur në një familje të mirëqenë, me shtëpi dhe me dy prindër të punësuar.	4
1	Keni lindur në një familje mesatarisht të mirëqenë, me një prind të punësuar dhe në një banesë më të vogël.	10
1	Keni lindur në një familje të varfër, me prindër pa punë të përhershme dhe pa banesë tënde.	6
2	Keni lindur me shëndet të mirë, pa sëmundje të rënda gjatë fëmijërisë.	13
2	Keni lindur me shëndet të ndjeshëm dhe me disa sëmundje më të rënda gjatë fëmijërisë.	5
2	Keni lindur me pengesa në zhvillim (me hendikep fizik).	2
3	Pas përfundimit të shkollimit menjëherë keni gjetur punë.	4
3	Pas përfundimit të shkollimit keni gjetur punë pas një kohe.	7
3	Pas përfundimit të shkollimit, nuk keni mundur të gjeni punë për një kohë të gjatë.	9
4	Keni lindur në një fshat malor.	3
4	Keni lindur në një fshat të ulët.	4
4	Keni lindur në një qytet të vogël në brendësi.	7
4	Keni lindur në kryeqytetin e shtetit.	6
5	Keni të ardhura që i kënaqin të gjitha dëshirat e tua dhe dëshirat e anëtarëve të familjes tënde.	2
5	Keni të ardhura që i kënaqin nevojat e tua dhe nevojat e familjes tënde.	4
5	Keni të ardhura që nuk i kënaqin nevojat e tua dhe nevojat e familjes tënde.	14

Keni lindur në një familje të mirëqenë, me shtëpi dhe me dy prindër të punësuar. DY HAPA PARA
Keni lindur në një familje mesatarisht të mirëqenë, me një prind të punësuar dhe në një banesë më të vogël. QËNDRO NË VENDIN E NJËJTË
Keni lindur në një familje të varfër, me prindër pa punë të përhershme dhe pa banesë tënde. NJË HAP MBRAPA
Keni lindur me shëndet të mirë, pa sëmundje të rënda gjatë fëmijërisë. NJË HAP PARA
Keni lindur me shëndet të ndjeshëm dhe me disa sëmundje më të rënda gjatë fëmijërisë. QËNDRO NË VENDIN E NJËJTË
Keni lindur me pengesa në zhvillim (me hendikep fizik). NJË HAP MBRAPA
Pas përfundimit të shkollimit menjëherë keni gjetur punë. NJË HAP PARA
Pas përfundimit të shkollimit keni gjetur punë pas një kohe. QËNDRO NË VENDIN E NJËJTË
Pas përfundimit të shkollimit, nuk keni mundur të gjeni punë për një kohë të gjatë. NJË HAP MBRAPA
Keni lindur në një fshat malor. DY HAPA MBRAPA
Keni lindur në një fshat të ulët. NJË HAP MBRAPA
Keni lindur në një qytet të vogël në brendësi. QËNDRO NË VENDIN E NJËJTË
Keni lindur në kryeqytetin e shtetit. NJË HAP PARA
Keni të ardhura që i kënaqin të gjitha dëshirat e tua dhe dëshirat e anëtarëve të familjes tënde. TRI HAPA PARA
Keni të ardhura që i kënaqin nevojat e tua dhe nevojat e familjes tënde. NJË HAP PARA
Keni të ardhura që nuk i kënaqin nevojat e tua dhe nevojat e familjes tënde. NJË HAP MBRAPA
Vija fillestare i tregon potencialet me të cilat lindemi.
Të gjithë ne lindim të barabartë në të drejta dhe dinjitet.
Gjatë jetës janë shumë faktorë që ndikojnë në realizimin e plotë ose të pamjaftueshme të potencialeve tona.
Pozita ekonomike dhe sociale e secilit individ ndryshon gjatë jetës për shkaqe të ndryshme.
Për shkak të pozitës së tyre të pamjaftueshme, disa madje “bien” nga loja e jetës ose nuk kanë mundësi që plotësisht t’i zhvillojnë potencialet e tyre.
Situata e pabarazisë në raport me pozitën sociale duhet të jetë nxitje për shtetin, por edhe për organizatat e ndryshme si dhe për bashkësinë që të veprojnë në drejtim të zbutjes së kushteve jo të volitshme për ata të cilët nuk kanë mundësi të barabarta për zhvillim dhe për të arritur drejtësinë.
Të gjithë ne lindim të barabartë në të drejtat dhe në dinjitet.
Secili ka të drejtë në mundësitë e barabarta dhe në trajtim të barabartë.
Disa njerëz janë të paracaktuar që t’i kanë të gjitha, gjersa disa nuk meritojnë që të kanë.
Njerëzit duhet të ndahen sipas statusit social.
Njerëzit duhet të ndahen sipas potencialeve të tyre, diturisë, aftësive dhe përpjekjeve.
Secili ka të drejtë në arsimim, në siguri sociale, në mbrojtje shëndetësore.
Të gjithë duhet të mendojmë për të tjerët dhe sa na ndjekin ata në realizimin e potencialeve tona.
Të gjithë duhet të jemi përherë të vetëdijshëm për situatat që na rrethojnë dhe për atë që ndodh përreth nesh në raport me dallimet sociale, etiketimet e të tjerëve, kujdesin për të tjerët, për dëshirën e përbashkët që të gjithë përherë të kemi të drejta të njëjta dhe mundësi të njëjta.



Goran Bozhiçeviq

8. FJALOR I ARSIMIT PAQËSOR

Shpjeguar nga një mësues paqësor me njëzet e katër vjet përvojë në vendet post-jugosllave dhe më gjërë.

Shënim hyrës 1. Nëse jeni duke lexuar këtë tekst sikur të jenë ato definicione të dhëna, kthehuni në fillim, humbisni tri qarqe dhe atëherë hudsoni kubin përsëri. Nëse ky tekst nxit tek ju mendimin kritik dhe vetë filloni ta shënoni kuptimin e këtyre termeve, kërceni dhjetë fusha përpara.

Shënim hyrës 2. Të gjitha termat shpjegohen në përgjithësi në kontekstin e arsimit paqësor dhe punës paqësore. Qëllimi i autorit nuk i përfshin kuptimet universale në kontekste të tjera.

A

Aktivizëm – përpjekje aktive për të mirën e përbashkët. Atë e karakterizon vullnetarizmi, motivimi personal i vlerave dhe mungesa e shpërblimit adekuat material. Për kulturën tonë politike (më saktësisht, për mungesën e saj) aktivizmi më lehtë mund të kuptohet si kontradikt i dorëheqjes së zakonshme - Asgjë nuk mund të bëhet. Kjo nuk ekziston askund. Kot përpiqesh.

Qytetari është entiteti bazë i një shoqërie demokratike. Autoritetet e reduktojnë atë vetëm si një votues i cili vetëm në zgjedhje shpreh politikën e tij. Aktivizmi civil përfshin një sistem vlerash, qëllime të qarta, bashkim dhe veprim për interesa të përbashkëta.

Qytetari aktive - pjesë e domosdoshme e kulturës së zhvilluar politike në shoqëritë demokratike. Kjo nuk i redukton qytetarët në votues apo mbështetës të opsioneve të caktuara politike. Qytetaria aktive pret nga qytetarët që të deklarojnë mbi vendimet që janë të rëndësishme për ta, sidomos për ata që nuk u pëlqejnë. QA do të thotë qasje e lirë tek informatat, gazetaria hulumtuese dhe pluralizmi medial (qëllimisht nuk po flasim për gazetarinë e pavarur, por për mundësinë që qytetarët të informohen nga burime të ndryshme), liri e asocimit dhe veprimit dhe një standard i arritur i caktuar jetese - punësim, pagë adekuate. Në varfëri është e vështirë të flitet për qytetari aktive, më shumë mund të flasim rreth niveleve të ndryshme dhe mënyrave për të shprehur rebelim.

Të dëgjuarit aktiv - shkathtësi, përpjekje e vetëdijshme për të dëgjuar, për të kuptuar atë që na thotë bashkëbiseduesi. Përfshin edhe gjuhën e trupit, kryesisht shikimin në sy, pantomimë dhe gjestikulacione me të cilat tregojmë që jemi të pranishëm dhe dëgjojmë me vëmendje, si dhe parashtrijmë nënpyetje (Çfarë saktësisht mendon kur thua se kjo nuk është e mirë?;

Si ndihesh atëherë?) dhe parafrazim sipas nevojës, në qoftë se është e rëndësishme për ne të kontrollojmë nëse kemi kuptuar mirë (ti më thua se edhe përsëri dy marrëveshjeve tuaja me shkrim dhe tri takime të drejtpërdrejta në të cilat keni rënë dakord për të bashkëpunuar në përgatitjen e koncertit, ata juve aspak nuk ju kanë thirrur). Dëgjimi aktiv është ndoshta aftësia kyçe dhe themelore e çdo pune paqësore. Kjo na ndihmon që ti kuptojmë jo vetëm informacionet aktuale, por edhe ndjenjat, nevojat, motivet e bashkëbiseduesve apo të tjerëve në fjalë. Ka dy karakteristika të rëndësishme të të dëgjuarit aktiv:

1. ajo kërkon koncentrik, e përdorim në biseda të rëndësishme, marrëveshje dhe takime me njerëz që nuk i njohim apo me të cilët kemi qëndrime, vlera të ndryshme, dhe me të cilët keqkuptimi është shumë i mundshëm. Nuk është e nevojshme që të përdoret në çdo bisedë të relaksuar, edhe pse me kohë do ta kuptojmë vlerën dhe gjithnjë e më shumë dhe më natyrshëm do ta aplikojmë;

2. ajo nga ne nuk kërkon që të biem dakord me atë që dëgjojmë. Ne jemi të fokusuar për të dëgjuar dhe kuptuar, por jo edhe për të konfirmuar dakordimin tonë me atë që e dëgjojmë.

B

Bojkot - mungesë e organizuar apo spontane e pritshmërisë: veprim, blerje, vizitë, ardhje. Bojkoti duhet të dallohet nga sanksionet, sepse bojkotet janë kryesisht spontane, të lidhura me emocionet dhe vendimet e vetë qytetarëve. Sanksionet i sjellin institucionet dhe rrallë ose asnjëherë nuk sjellin rezultate të dëshiruara. Bojkoti mund të jetë efikas, dërgon një mesazh të qartë se nuk duam të mbështesim sjellje të caktuar, nuk kërkon procedura të gjata dhe përputhshmëri. Disavantazhet e bojkotimit janë të lidhura me mosrealitetin e pritshmërisë - sa shumë qytetarë me të vërtetë do ti kuptojnë shkaqet, do të inkuadrohen, a kanë alternativë? Bojkoti mund të jetë afatshkurtë dhe afatgjatë, zgjat derisa nuk ndryshohen arsyet që çuan në bojkot. Mund të jetë masiv ose individual, i cili në fund shpie në masivitet. Edhe pse nuk e quajmë me këtë emër, shumë prej nesh bojkotojnë produkte të caktuara, vende publike, ngjarje publike që nuk përputhen me sistemin tonë të vlerave, ndërsa janë në dispozicion dhe të ofruara; ne jemi grupi i tyre i synuar.

Duhet të dallohet përzgjedhja nga bojkoti sepse gjatë përzgjedhjes udhëhiqemi nga cilësitë e dëshiruara të një produkti, ngjarje, personi, ndërsa te bojkoti cilësitë ekzistuese do të sakrifikohen për ne karakteristika të papranueshme; shfrytëzim (abuzim) i forcës së fëmijëve apo punonjësve, pikëpamje të papranueshme dhe të rrezikshme politike, gjuhë e urrejtjes. Nuk mund të bojkotojmë produkte dhe shërbime që nuk na pëlqejnë apo që nuk janë të disponueshme për ne, bëhet fjalë për një mohim të vetëdijshëm nga ajo që është e nevojshme për ne dhe nga ajo që ne duam, për arsye më të larta etike.

N

Ndërtim i paqes²⁾ – forcim dhe përforcim i infrastrukturës jo të dhunshme shoqërore në mënyrë që të mund të shfrytëzohen resurset e brendshme dhe të jashtme në mënyrën më të mirë për të krijuar një paqe të qëndrueshme³⁾.

Të gjitha proceset dhe aktivitetet që çojnë shoqërinë nga një gjendje e armëpushimit në një gjendje paqeje të qëndrueshme⁴⁾.

Ndërtimi i paqes ndryshon nga puna paqësore (e kuptuar në përgjithësi); Ndryshon me atë që ajo ndodh në zonat e prekura nga lufta apo ndonjë konflikt tjetër të armatosur dhe ku në mënyrë serioze janë të shkatërruara marrëdhëniet midis armiqve ose ndërmjet ish-armiqve.

²⁾ I njëjti autor <http://www.cms.hr/hr/mirovni-studiji/osnovni-pojmovi-mirovnih-studija>

³⁾ Definicion i John Paul Lederlach

⁴⁾ Definicion nga Kolegiumi për ndërtim të paqes të studimeve për paqe në Zagreb

Qëllimi përfundimtar i ndërtimit të paqes është pajtimi, gjendje shoqërore në të cilën më nuk ekziston rrezik nga një konflikt i dhunshëm ndërmjet ish armiqve dhe ku të gjitha shkaqet e mundshme të konfliktit të tillë të dhunshëm ose të ngjashme janë të hequra. Por kjo nuk do të thotë se në një shoqëri të tillë nuk ka nevojë për punën e paqes, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e një shoqërie pa dhunë, diskriminim, padrejtësisë.

Ndërtimi i paqes është një koncept relativisht i ri, i sjellur qysh në vitin 1992 në fjalorin e KB-së. Sot konsiderohet si një nga qasjet kryesore në ndërtimin dhe përmirësimin e shoqërive të pasluftës. Ai përfshin një gamë të plotë të aktiviteteve që kanë për qëllim ndërtimin e institucioneve shtetërore, sundimin e ligjit, kulturës politike, të shoqërisë civile, ri-integrimin e veteranëve ushtarakë, kthimin e të internuarve, riparimin e viktimave, gjykimet e krimeve të luftës dhe ballafaqimin me të kaluarën.

D

Debati - një mënyrë e popullarizuar e bisedës që filloi të zbatohet me zhvillimin e një sistemi shumëpartiak, për tema relevante shoqërore, sidomos në mesin e nxënësve të shkollave të mesme dhe studentëve. Debati zhvillon aftësinë për oratori, argumentim, qartësinë e shprehjes, ndjenjën e kohës dhe audiencës. Qëllimi i debatit është të bindë palën tjetër dhe publikun se argumentet tona janë më të forta, më të bindshme. Nga ky këndvështrim, debatet kanë kuptim, ndihmojnë në perceptimin e problemeve nga kënde të ndryshme, artikulimin e argumenteve dhe kundër-argumenteve. Nga perspektiva e arsimit paqësor, përsëri të gjitha karakteristikave të dobishme, debati ka edhe ata më pak të dëshirueshme. Rezultati përfundimtar i debatit normalisht kuptohet si një „fitore”, e cila nënkupton se përsëri do të ketë dhe „dështim” gjegjësisht „të dështuar”. Më shumë vëmendje u është kushtuar efekteve, fuqisë së bindjes, sesa forcës së vetë argumenteve dhe analizës së rezultateve të tyre. Debati bazohet në faktin se „ne” kemi të drejtë dhe me vështirësi pranon se „ne” ndoshta nuk kemi të drejtë, gjegjësisht e lidh atë për të matur fuqinë e folësit, por jo edhe të vlerës së argumenteve. Vërejtja më e madhe e debatit vjen nga pozita e mjetit më të rëndësishëm paqësor: a) të dëgjuarit aktiv - dëshirë e vërtetë për të dëgjuar bashkëbiseduesin; b) parashtrimin e pyetjeve që do të na ndihmonin ta kuptonim më mirë argumentimin e folësit.

Në debat, pyetjet drejtohen për të treguar se bashkëbiseduesi është i gabuar dhe nuk na shpjegon argumentet e tij. Prandaj debati, veçanërisht nëse është real dhe jo një ushtrim, është shumë problematik në komunikimin ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore dhe individëve.

Dialogu - model themelor i komunikimit ndërmjet individëve dhe grupeve me qëndrime dhe vlera të ndryshme në pikëpamjet politike apo të ndryshme. Nëpërmjet dialogut, përpjekimi që ta dëgjojmë bashkëbiseduesin dhe ta kuptojmë motivimin e tij dhe nevojat e tij. Kjo nuk do të thotë që patjetër duhet t'i pranojmë ato, por më së miri është që t'i kuptojmë nga vijnë. Baza e dialogut është të dëgjuarit aktiv, një përpjekje e vetëdijshe dhe e drejtuar në dëgjimin dhe të kuptuarit e palës tjetër. Dialogu nënkupton që të dy ose të gjitha palët do të përdorin dëgjimin aktiv. Dialogu nuk synon drej një marrëveshje ose përfundim të përbashkët, por në rritjen e mirëkuptimit midis palëve që kanë mosmarrëveshje ose konflikte të hapura.

Aksion i drejtpërdrejtë - veprim i drejtpërdrejtë i individëve dhe grupeve kundër burimit të diskriminimit, rrezik për njerëzit ose mjedisin, autorë të veprave penale kundër të cilëve nuk merren masa të tjera (adekuate). Ndryshe nga protesta, ajo është e planifikuar detalisht, arsyet dhe qëllimet janë të qarta për të gjithë që janë të përfshirë, dhe janë të rëndësishme dhe të pranueshme. Gjithashtu është e paraparë edhe përfshirja e medias. Sipas rregullave, flasim për veprime të drejtpërdrejta jo të dhunshme, veprime që nuk kanë për qëllim të lëndojnë krijesat e gjalla ose të shkaktojnë dëme materiale të të mirave të përgjithshme. Për veprime të tilla është karakteristike që mund të shkaktojnë një reagim të policisë dhe është e rëndësishme që të parashikohen pasojat e mundshme (arrestimi, paraburgim, shqyrtim) për të cilat duhet që paraprakisht të planifikohet strategji paqësore për përballimin me to. Si tek protestat, por në një masë shumë më të vogël (sepse të gjithë që janë të përfshirë njihen dhe së bashku kanë bërë përgatitjet) ekziston mundësia e hyrjes së individëve të cilët janë të prirur për dhunë, qofshin ato provokatorë apo jo. Prandaj është e rëndësishme distancimi i qartë nga dhuna dhe planet për t'u përballuar me situata në të cilat mund të vjen deri te dhuna.

Diskriminimi - diferencimi i një personi ose personave dhe një qëndrim i ndryshëm ndaj tij / tyre në bazë të tipareve të caktuara të identitetit që nuk kanë lidhje me situatën konkrete. Nuk është diskriminim ndalesa për hyrje në ndërtesat publike (padyshim) të personave të alkoolizuar, pamundësia për regjistrim të studimeve për shkak të rezultateve të dobëta të provimit pranues ose refuzimi i punëtorëve të cilët nuk i kanë kualifikimet e përshkruara / kërkuara. Por ndalesat në bazë të orientimit fetar, politik, etnik dhe seksual janë sigurisht diskriminuese. Sot, janë të përhapura format indirekte, të fshehura të diskriminimit, por gjithashtu ka institucione tek të cilat mund të drejtohem. Nuk duhet të përzihet çdo ndalesë ose e drejtë e pa realizuar me diskriminim, por të kontrollohet nëse arsyet kanë lidhje me një veçori të caktuar personale që është e padëshirueshme.

I

Identiteti - mënyrë në të cilën / si shikojmë veten tonë dhe lidhemi me njerëz të tjerë (të ngjashëm) dhe si na kategorizojnë të tjerët. Pyetjet: Kush jam? Ku përkas? - janë ndër pyetjet thelbësore që secili prej nesh i parashtron. Në arsimin paqësor duam që njerëzit të kenë përgjigje të qarta për ta. Për ne nuk janë aq të rëndësishme vetë përgjigjet, por sa personi ka menduar me të vërtetë për ta dhe sa janë ato të kushtëzuara nga pritshmëritë e mjedisit. Në Ballkanin Perëndimor (dhe në shoqëritë e tjera në tranzicion me konflikte të pazgjedhura) identiteti zakonisht lidhet me origjinën etnike / kombëtare, fetare, statusin martesor, moshën, profesionin. Kjo nuk është e domosdoshme, as e mirë e as e keqe, por na tregon për një varg të roleve shoqërore përmes së cilave paraqitemi tek të tjerët, ndërsa vetë fshehim vetëveten.

Prezantimi me, për shembull, „Maqedonas, besimtar ortodoks, i martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar” konsiderohet „në rregull”, por porosia pas identiteteve të radhitura në atë mënyrë, është potencialisht problematike nga pikëpamja paqësore (parandalimi i dhunës dhe diskriminimit

). Kjo do të thotë që një prezantim i tillë do të konsiderohet si i pranueshëm nga shoqëria, por kjo na tregon shumë pak për vetë personin. Njerëzit me tipare të tilla ka me qindra mijëra dhe nëse është e vërtetë se ato cilësi janë më të rëndësishme, kjo do të thotë se jetohet në shoqëri shumë të unifikuara, ku diversiteti i individit nuk është i dëshirueshëm.

Në punën paqësore i inkurajojmë njerëzit që ti njohin dhe ti potencojnë identitetet e tyre të cilat i përcaktojnë, të cilat janë të rëndësishme, me të cilat dallojnë nga masa e njerëzve të tjerë, veçanërisht nëse potencojmë disa, si për shembull, gurmanë, luajë kitarë, baba krenar , adhures i bozës, tifoz i „Barcelonës”.

Identitetet janë të rëndësishme në arsimin për paqe, sepse të menduarit e tyre i çliron njerëzit që të distancohen nga „pjesëtarët e kolektivit” dhe kështu ta fitojnë unitetin e vet, me ç’rast respektohet uniciteti, diversiteti i të tjerëve. Më pak insistohet në ngjashmëri, uniformitet, bindje - parakushtet e nevojshme për eskalim të dhunës.

K

Konflikti – gjendje / situatë (e brendshme) e pakëndshme e personit, në mes dy ose më shumë personave, grupe njerëzish apo komunitete më të mëdha, ku janë prezent interesa dhe / ose nevoja të pakënaqshme, kurse „pala tjetër” shihet si fajtor për situatën e tillë. Konflikti tek ne perceptohet si diçka shumë negative, e padëshiruar, e keqe. Ajo që është e keqe është dhuna në konflikt, e për shkak se jetojmë në shoqëri të ngarkuara me luftëra dhe kujtime për ta, dhuna është kudo, si në kujtesë, ashtu edhe në raportet e përditshme.

Shpesh nuk mendojmë se jeta pa konflikte nuk është jetë (e vërtetë). Më shumë konflikte kemi me njerëzit që janë të afërt dhe të rëndësishëm për ne. Konfliktet dhe mënyrat me të cilat sillemi me to na ndihmojnë ta forcojmë, thellojmë marrëdhënien tonë me të tjerët, ose madje ta ndalojmë atë. Konfliktet, për shkak të potencialit të tyre emocional, energjetik dhe të dhunshëm, janë „ideale” për manipulimin e njerëzve nga ana e politikave të këqija. Vetëdijësimi se ata na shtyejnë në konflikt me njerëzit a) të cilët nuk i njohim b) të cilët kanë probleme të njejta ose të ndryshme si ne c) për shkak të qëllimeve të cilat nuk na tregohen, që na inponohen si të rëndësishme dhe pa alternativa megjithëse ato gjithmonë egzistojnë, në masë të madhe i redukton shanset për një konflikt të armatosur, luftë.

Shiko: Transformimi i konfliktit.

P

Paqe- “gjendje e shoqërisë në të cilën njerëzit kujdesen për nevojat e njerëzve të tjerë”. Kjo është një nga nocionet që „nuk duhet të shpjegohen” dhe zakonisht definohet me mungesë të luftës. Është pak më precize të thuhet se ajo është një gjendje e shoqërisë në të cilën njerëzit jetojnë të lumtur dhe pa kërcënim për luftë. Zakonisht, kuptimi i saj vjen (kryesisht) nga tradita krishtere dhe i referohet paqes së përvetshme, qëndrimit në paqe, paqe me ju. Këto kuptime na çojnë në

drejtimin e gabuar nëse termin e përdorim për një komunitet njerëzor, një shoqëri. Me paqe nuk mendojmë për një shoqëri në të cilën nuk ka konflikte dhe të gjithë jetojnë në harmoni, mirëqenie dhe gëzim. Konfliktet janë një pjesë e pashmangshme e jetës njerëzore, e çdo komuniteti njerëzor. Nuk na pengojnë konfliktet, por dhuna në to. Në paqe nuk kemi konflikte të armatosura, por kemi një sërë të tjerash që transformohen në mënyrë jo të dhunshme. Dallimi i paqes negative dhe pozitive është gjithashtu i zakonshëm, sipas teoricientit norvegjez Johan Galtung. Paqja negative është thjesht mungesa e dhunës, konfliktit të armatosur, luftës. Paqja pozitive përfshin rinovimin e marrëdhënieve midis palëve të kundërta, krijimin e një sistemi shoqëror që u shërben të gjithëve në komunitet si dhe zgjidhjen konstruktive (jo të dhunshme) të konflikteve shoqërore. Shpesh e quajmë paqe e qëndrueshme dhe stabile.

Arsimi paqësor - Shumë pak njerëz do të mund të ju tregojnë saktësisht se çfarë mendojnë me këtë nocion. Ndër të tjera, ata që merren me paqen (çfarëdo që do të thotë kjo) nuk do të ndjejnë nevojën për të përcaktuar „sepse e dinë se çfarë është”; ata që merren me arsimin do të jenë të hutuar, të tjerët në përgjithësi nuk e dinë se për çfarë bëhet fjalë.

Arsimi paqësor ka dy karakteristika që e dallojnë atë nga llojet e tjera të arsimit:

- ai varet shumë nga mjedisi ku mësohet;
- mënyra e mësimdhënies e shpreh vetë thelbin dhe kuptimin e arsimit.

Kjo do të thotë se gjithçka që shkakton, drejtpërdrejt ose tërthorazi, forma të ndryshme të padrejtësisë dhe / ose dhunës në ndonjë shoqëri, bën pjesë në fokusin e arsimit paqësor. Në të njëjtën kohë është e rëndësishme vetëdijësimi për gjendjen në të cilën jetojmë, si dhe mënyrën në të cilën e bëjmë këtë vetëdije – në mënyrë participative, eksperienciale, bashkëpunuese. Arsimi paqësor, mbi të gjitha, forcon, nxit në veprim dhe nëpërmjet vetë marrëdhënies mësues-nxënës forcohet fuqia e bashkëpunimit me qëllim që nxënësi ta tejkalojë mësuesin. Arsimi paqësor është ndihmë dhe lehtësim për të gjithë që janë të përfshirë në procesin mësimor, sepse nëse nuk është, atëherë kjo nuk është arsim paqësor. Ajo nuk është një objekt, në veçanti nuk është „një nga” ose „për notë”, por është një mënyrë e edukimit dhe arsimit të qytetarëve përgjegjës për një shoqëri më pak të dhunshme dhe të drejtë.

Fuqia - aftësia për të bërë ndryshim ose t'i kundërvihemi një ndryshimi. Ka lloje të ndryshme të fuqisë, e në arsimin paqësor është i rëndësishëm dallimi në mes të “fuqi me” fuqi e/nga bashkëpunimi dhe „fuqi mbi” / „fuqia e dominimit”. Pjesëmarrësit e programeve të paqes shpesh kanë një opinion negativ në lidhje me fuqinë, e cila është një arsye shtesë për ti njohur me fuqinë e bashkëpunimit, mbështetjes, inkurajimit të jetës.

DH

Dhuna - sulm ndaj / mohim të dinjitetit dhe të drejtës për jetë të një qenieje të gjallë. Dhuna fizike na e kërcënon vetë jetën dhe prandaj është më e njohur për ne. Por ekziston një gamë e tërë e llojeve të tjera të dhunës që shumica e njerëzve as që e nënkuptojnë me termin „dhunë”.

Dhuna strukturore është një nga nocionet më të rëndësishme të arsimit paqësor. Shumë prej tyre nuk janë të vetëdijshëm për të dhe pakica plotësisht e studiojmë atë. Si nocion e sjelli Johan Galtung në vitin 1969. Përfshin një sërë mekanizma, sjellje, ideologji, rregulla, marrëdhënie të inkuadruara që diskriminojnë disa ose të gjitha grupet shoqërore, ua shkurtojnë përmbushjen e nevojave dhe shkaktojnë vdekshmëri, invaliditet, papunësi, mos strehim, dëshpërim të rritur. Këtu bëjnë pjesë të gjitha format e diskriminimit, racizmit, pabarazisë gjinore, mungesa e arsimit apo neglizhenca e tij si dhe mungesa e kujdesit shëndetësor adekuat dhe mbrojtjes. Dhuna strukturore dhe fizike mbërthehen mes veti, kështu që kemi dhunën në familje, dhunën në punë, dhunën policore, terrorizmin, krimet nga urrejtja, dhunën shtetërore dhe luftën. Në arsimin paqësor është kyçe që të mësohet, të zbulohet dhe të tregohet për dhunën strukturore, sepse me eliminimin e saj, me reduktimin e saj në mënyrë direkte rritet cilësia e jetës për të gjithë dhe zvogëlohen shanset e ndonjë dhune fizike.

Dhuna kulturore tenton që ta justifikojë dhunën strukturore. Në të i rradhitim edukimin me formularë të dhunshëm, ndëshkimin (rrahja ka dalur nga parajsa), talljen me të dobëtit, me ato që janë të ndryshëm, fajësimin e viktimave (çfarë bërë jashtë kaq vonë?), patriarkati (festim kur lind një djalë, dhe jo kur lind vajzë), shaka raciste, nacionaliste, seksiste. Kjo është poshtërsi, sepse e konsiderojmë si „pjesë e traditës sonë,” dhe nuk mundemi në mënyrë direkte ta perceptojmë inkurajimin e llojeve të ndryshme të dhunës, sulmet mbi integritetin e njerëzve dhe qenieve të tjera të gjalla që dalin prej saj.

Jo-dhuna - Çdokush që merret me punën e paqes në çdo formë që është do ta përdorë këtë term në biseda dhe tekste të shkruara. Një numër shumë i vogël i këtyre njerëzve do ta praktikojnë në jetën e tyre. Prandaj përkufizimi i saj nuk është i rëndësishëm. Jo-dhuna është një qëndrim ndaj jetës, zgjedhje e jona nëse do të bëjmë përpjekje maksimale për të mos qenë të dhunshëm dhe ta parandalojmë dhunën. Ka një gamë të tërë të përkufizimeve të tjera, veçanërisht në lidhje me Mahatma Gandin dhe nocionin Ahimsa (Sanskrit - अहिंसा, ahimsa-jo -dhunë) është parimi tradicionalisht etik i filozofisë indiane që ndalon dëmtimin e qenieve të gjalla dhe nënkupton heqjen dorë nga dhuna në çdo formë qoftë (mendore, fizike, verbale etj.). Normalisht, përfshin pacifizmin dhe vegjetarizmin⁵⁾.

Aq sa është e rëndësishme që vetë ta jetojmë jo-dhunën, po aq e rëndësishme është që në punën e tyre, veçanërisht në atë paqësore të pyetemi:

- ♦ a përfshin ajo ndonjë dhunë (ndoshta ndonjë punon nën presion, ndoshta dikënd nuk e kemi përfshirë për shkak të paragjyqimeve tona, ndoshta të gjithë janë meshkuj, dhe nuk ka femra ...)
- ♦ Si e parandalon puna jonë dhunën?

Aksion jo i dhunshëm - „Në veprimet jo të dhunshme, nuk shkaktohen lëndime ndaj kundërshtarëve të tyre politikë ose ndaj të tjerëve (personave, grupeve ...). Nëse dëmtimi i disa pasurive është i pashmangshëm, atëherë duhet të kufizohet dhe të kujdeset që bashkëpunëtorët e veprimit të marrin përgjegjësinë për veprimet e tyre. Sabotimi anonim nuk është formë e

⁵⁾ Wikipeda

veprimeve të padhunshme. Veprimi jo i dhunshëm nuk duhet që ta pengojë punën e shërbimeve që janë të rëndësishme për shpëtimin e jetës, e as të parandalojë ndarjen e të mirave që janë të rëndësishme për jetë⁶⁾”.

Forca e veprimeve jo të dhunshme është pikërisht në këtë mohim të dukshëm për të arritur qëllimin me mjete të dhunshme. Ajo shpesh ose rregullisht është dramatike kur janë të shterura të gjitha mjetet e disponueshme ligjore dhe kërkon përgatitje të mirë, komunikim të negociuar, respektim të kundërshtarëve (kjo nuk do të thotë edhe aprovimin e veprimeve të tyre), heqjen dorë nga dhuna që mund të paraqitet gjatë zbatimit të veprimit.

P

Përgjegjësi- term shumë i rëndësishëm dhe pak i menduar, i cili shpesh interpretohet gabimisht. Nxënëx i përgjegjshëm është ai që rregullisht i bën detyrat e shtëpisë, është një shembull i zakonshëm, por jo domosdoshmërisht i saktë. Ndoshta bëhet fjalë për bindje, dëshirë për afirmim, frika nga ndëshkimi, dashuria për lëndën, por jo edhe domosdoshmëri për përgjegjësi. Ajo e lidh sjelljen e individit dhe të komunitetit, vetëdijen që si pjesë e një kolektivi më të madh përgjigjemi / jemi të lidhur me punën e anëtarëve të tjerë të këtij kolektivi, sidomos kur bëhet fjalë për akte jashtëzakonisht të dëmshme, kriminale.

Përgjegjësinë e lidhim në kontekstin e dhunës, konflikteve, luftërave. Shpesh përzihet me nocionin e fajit, i cili është më konkret. Në luftë vetëm disa njerëz janë fajtorë, gjegjësisht janë autorë të dhunës, por shumë prej tyre janë përgjegjës. Kur bëhet fjalë për konfliktet ndëretnike, fajtorë janë ata që janë të përfshirë në mënyrë direkte ose nxitësit e tyre, por përgjegjës janë gjithë anëtarët e grupit etnik / kombit që lidhet me dhunën. „Unë me këtë nuk kam asnjë lidhje” është deklaratë e cila për personin që e ka thënë ka kuptim, por nuk duhet të ketë për personin i cili e lidh aktin e dhunës / padrejtësisë me kombësinë e kryerësit.

Në punën paqësore i vetëdijësojmë ato marrëdhënie identiteti. Të gjithë ata që pohojnë se është e rëndësishme për ta që të jenë, për shembull Kroatë, madje edhe ata të tjerët, të cilët të tjerët i njohin si Kroatë, kanë një lidhje- janë përgjegjës bashkë me to për krimet që kanë të bëjnë me kroatët. Prandaj është e rëndësishme që të distancohemi, për të parandaluar krimet dhe / ose për ti dënuar, ti përpunojmë, ti izolojmë dhe ti lidhim me individë konkret apo grupe më të vogla, në mënyrë që kolektivi të mbetet i paprekur nga ana e tyre. Nëse nuk e bëjmë këtë („Unë nuk kam lidhje me këtë”), e gjithë bashkësia etnike bart barrën e krimit konkret.

Drejtësia shoqërore - Kur në shoqëri a) të gjithë kanë qasje të barabartë në resurset shoqërore dhe natyrore që ekzistojnë dhe të cilat janë të mjaftueshme për nevojat e të gjithë anëtarëve; b) sistemi gjyqësor është i harmonizuar dhe i pavarur; c) minoritetet, veçanërisht grupet e cënueshme, janë të mbrojtura; d) nuk ka diskriminim ose ekzistojnë shumë mekanizma të zhvilluar për perceptimin dhe parandalimin e saj - mund të themi se ekziston drejtësi shoqërore. Vetë nocioni i drejtësisë është një nga nocionet kryesore të arsimit paqësor.

⁶⁾ Sipas Theodor Ebert cituar nga www.rand.hr

Ndryshimi shoqëror ose ndryshimi shoqëror pa dhunë është i drejtuar në diskriminimin ekzistues, padrejtësinë, shfrytëzimin e njerëzve ose resurseve nëpërmjet një mase të pranueshme, reduktimin ose heqjen e dhunës kulturore dhe strukturore dhe sjelljen ndaj vlerave të caktuara në shoqëri. Në punën paqësore, me këtë term, ekskluzivisht nënkuptojmë të gjitha format e ndryshimit që reduktojnë dhunën dhe respektojnë dinjitetin e jetës, si dhe të drejtat e njeriut dhe të gjitha konventat ndërkombëtare që lidhen me to dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

P

Pajtimi - Në përgjithësi nuk ka konsensus për atë se çka paraqet dhe si vihet deri tek ajo. Gjithashtu konsiderohet se termi „ekspert i pajtimit” është oksimoron dhe të gjithë ata që e mësojnë kanë kujdes nga etiketime të tilla. Mendohet se ajo është çështje personale e secilit person, por gjithashtu është rol i domosdoshëm në çdo shoqëri dhe vend për të bërë të mundur, që pas ndonjë lufte eventuale pajtimi të përshpejtohet dhe të realizohet në një masë që është e mundshme.

Pajtimi nuk përmban forcë dhe shpejtësi, njëkohësisht bëhet fjalë edhe për procesin dhe për qëllimet, ndërsa përfshin të paktën tri nivele: ballafaqim me të kaluarën (e errët), mbajtjen e marrëdhënieve me ish-armiq të tashmen dhe ndërtimin e ardhmërisë së përbashkët. Është e gabuar të konsiderohet se viktimat më të mëdha e kundërshtojnë pajtimin, përkundrazi, pikërisht njerëzit që i kanë humbur më të dashurit shpesh dinë të flasin ose të punojnë në atë për të ndaluar të keqen dhe urrejtjen. Falja është e lidhur me pajtimin, ndërsa insistimi për falje nga ana tjetër, si kusht i domosdoshëm, flet më shumë për papërgatitjen tonë për pajtim, sesa për atë „anën tjetër”.

Nevojat – ajo pa të cilën nuk mund të jetojmë me dinjitet dhe shëndetshëm si person i realizuar. Ekziston një hierarki e përgjithshme e nevojave sipas Maslovit dhe ato shumë qartë janë të shpjeguara në psikologji. Në punën paqësore është e rëndësishme që të mos harrojmë se në paqe njerëzit munden dhe kanë mundësi për ti plotësuar nevojat e tyre, nga ato themelore deri te ata më të lartat - për vetërealizim, ndërsa në luftë plotësimi i nevojave tona reduktohet në ato themeloret-bëhet përpjekje për të mbijetuar. Gjendja në të cilën disa njerëzve u ndalohet qasja në arsim, shëndetësi, vendimmarrje politike e të ngjashme, nuk mund të quhet paqe. Puna paqësore në masë të madhe është përpjekje për atë që të gjithë njerëzit ti plotësojnë nevojat e tyre, e cila është një sfidë e madhe në botë ku qindra miliona njerëz nuk kanë ujë, e lëre më të vetërealizohen përmes talenteve të tyre.

Problem në vetë punën paqësore është orientimi drejt plotësimit të nevojave të tjerëve. Nëse nuk i përfshijmë njerëzit të cilëve duam tu ndihmojmë në marrjen e vendimeve për atë që vërtetë kanë nevojë, në çfarë renditje dhe në çfarë forme mund të ndodhë dëmi. Gjithashtu, që nuk është rast i rrallë, dëmi mund të ndodhë nëse i injorojmë nevojat personale.

Jo-dhunë e konsiderojmë atë qasje ndaj jetës dhe të tjerëve sipas të cilës punojmë për të kënaqur nevojat tona, por edhe për nevojat e të tjerëve. Për kushtet tona dhe kulturën e dhunshme kjo

është një qasje mjaft radikale - na mësojnë se është në rregull, madje edhe e dëshirueshme, për armiqat tanë, kundërshtarët dhe në përgjithësi për të tjerët nevojat e tyre të jenë të paplotësuar.

Paragjykimi - hapi nga stereotipeve tek diskriminimi. Përderisa të gjithë kemi stereotipe dhe vetë ato nuk janë të dëmshme, diskriminimi është i keq, i dhunshëm, që rrezikon sistematikisht të drejtat e njeriut. Kështu paragjykimet janë në mes, nuk janë të padëmshme, por jo edhe domosdoshmërisht të dëmshme. Është e rëndësishme që të jemi të vetëdijshëm se të gjithë i kemi dhe gjithmonë të pyesim se sa, si dhe kur ato ndikojnë në sjelljen tonë dhe çfarë do të ndërmarrim paraprakisht për të mos gjykojmë njerëz dhe situata që janë të panjohura për ne.

Drejtësia - mënyrë për të ruajtur vlerat themelore në shoqëri, parimisht për shkak të mirëqenies së të gjithë anëtarëve të saj. Kur as edhe këto vlera nuk janë të qarta ose janë kontradiktore, kur mungon konsensusi shoqëror, atëherë lind ndjenja se nuk ka drejtësi në shoqëri. Ndjenja se ekziston drejtësia, kontribuon në një perceptim të qartë të kuptimit të jetës, dhe kështu zbatimi i drejtësisë bëhet një instrument i rëndësishëm i sundimit. Ekzistojnë dy nocione me të cilat drejtësia është vazhdimisht në një marrëdhënie kontradiktore: a) e drejta b) paqja. Përderisa drejtësia i referohet përjetimit të brendshëm të individëve ose grupeve që jeta shoqërore është e rregullt dhe se të gjithë anëtarët janë të mbrojtur, e drejta është kryesisht një seri e rregullave të shkruara dhe të pashkruara që kanë për qëllim zbatimin e drejtësisë. Këto rregulla zbatohen relativisht lehtë, por ndjenja e për drejtësi shpesh mungon.

Dikotomia paqe ose drejtësi paraqitet në çdo konflikt të armatosur. Përderisa „paqja” paraqet fund të dëshirueshëm të luftës dhe mundësinë e të jetuarit „normal”, „drejtësia” paraqet raport adekuat ndaj atyre që janë fajtorë apo përgjegjës për luftën dhe krimet. Në praktikë ndodh që pikërisht „fajtorët” të kenë fuqinë për ta ndaluar luftën dhe dilema duket që ska zgjidhje, ose paqe ose drejtësi, nuk mundet të dyja. Gjithnjë e më shumë kuptohet se bëhet fjalë për një dilemë të gabuar dhe se nuk ka paqe (të qëndrueshme) pa drejtësi, e as drejtësia nuk mund të arrihet pa paqe.

Në arsimin paqësor, hasim edhe në termat si drejtësi retributive që u drejtohet autorëve dhe ndëshkimit të tyre. Ajo është pjesë e traditës sonë dhe lidhet me policinë, gjykatën, burgjet, madje edhe me dënimin me vdekje. Rezulton që: a) një pjesë e madhe e autorëve pas konflikteve të mëdha, luftërave thjesht nuk mund të procesohen (ka shumë dhe shumë arsye të tjera); b) dënimi i kryerësve nuk sjell kënaqësinë e viktimave (shembullin e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, ICTY në Hagë); c) dënimi dhe burgimi rrit normën e krimit dhe nuk e zgjidh atë.

Gjithnjë e më shumë po përdoret nocioni drejtësi restauruese, e cila përqendrohet tek viktimat dhe rimëkëmbjen e marrëdhënieve të komunitetit. Megjithëse shihet dhe ndonjëherë duket e vështirë për t'u bërë, drejtësia restauruese, sidomos kur bëhet fjalë për dhunën në shkollat, lagje dhe në mesin e të rinjve, ka gjithnjë e më shumë veteranë. Pyetja kyçe është: Çfarë duhet bërë që viktimat të ndihet e kënaqur, të mos i shtyejmë autorët në kriminalitet të mëtejshëm dhe ti „shpëtojmë” për komunitetin, dhe komuniteti tu ndihmojë edhe njëherë palë edhe të tjetrës që të vazhdojnë në mënyrë të barabartë të marrin pjesë edhe më tej në jetën e saj?

Punëtorja - në arsimin paqësor paraqet një vend takimi për pjesëmarrësit / pjesëmarrëset dhe udhëheqësit e shumë gjatë punimit të një teme. Për punëtorinë nuk është e domosdoshme

që udhëheqësi/udhëheqësja të ketë ekspertizë në këtë temë, më e rëndësishme është që të dij se si pjesëmarrësit/pjesëmarrëset ti angazhoj në një proces që është kuptimplotë, përmes të cilit mësojnë dhe përforcohen për punën e temës, problemin. Puna në punëtoritë quhet eksperiencë dhe pjesëmarrëse, dhe udhëheqje më e mirë është atëherë kur ata që e udhëheqin, e udhëheqin përmes bashkëpunimit dhe i inkurajojnë dhe përforcojnë vetë pjesëmarrësit që së bashku ta formësojnë procesin drejt qëllimit të dhënë. Numri optimal i pjesëmarrësve në punëtori është midis 10 dhe 16, dhe zakonisht ka rreth njëzet. Grupet më të mëdha kërkojnë ndarjen në grupe më të vogla dhe ndihmë në udhëheqjen. Udhëheqja në çifte, sidomos femër-mashkull është e dëshirueshme, sidomos në mjediset patriarkale, dhe vetë bashkëpunimi i udhëheqësve të tyre, u përcjell një mesazh të qartë pjesëmarrësve. Autori i këtyre rradhëve ka udhëhequr punëtori me numrin më të vogël prej 6 personave, deri mbi 300.

Diversiteti – termi ndoshta më pak i menduar, dhe më së shumti i përdorur në punën paqësore. Shpesh thuhet se „të gjithë jemi të ndryshëm” dhe se „diversiteti na pasuron” dhe kjo merret si e mirëqenë. Nëse i marrim pohimet e dhëna si të vërteta (të paktën janë për këtë autor të tekstit) pyetja është se prej ku aq rezistencë ndaj diversitetit, aq shumë konflikte të dhunshme për shkakun e tij: Është e vështirë që të shpjegohet diversiteti pa një raport me nocionet e paqes dhe luftës. Në paqe ndryshimet lulëzojnë, në luftë në mënyrë drastike reduktohen : në sjellje, pamje, të menduarit, komunikim, zgjedhje, veprime.

Në punën paqësore është e rëndësishme t'i kushtojmë vëmendje: a) të drejtës për diversitet, manifestimit të tij publik; b) perceptimi i diversitetit nga të tjerët dhe shkaqet për reagime të dhunshme të mundshme.

Diversiteti mund ta frikësoj tjetrin sepse ai / ajo nuk i kupton ato (gjuhën e huaj, zakonet, mënyrën e veshjes, shprehjen e emocioneve ...). Është e zakonshme të merret në konsideratë se me njohjen e ndërsjelle ndryshimet do ta zvogëlojnë rrezikun e dhunës së mundshme (për shembull, nxënësit duke vizituar kishën ose xhaminë). Kjo është (pjesërisht) e vërtetë, por nuk është e mjaftueshme. Nëse lëmë pas dore anën emocionale, frikën dhe habinë, rrezikimin, nëse nuk punojmë në shkaqet më të thella që e mohojnë ose nuk e kuptojnë dallimin, atëherë pak kemi bërë. Njerëzit të cilët janë të sigurt në identitetin e tyre nuk kanë problem me dallimet. Një besimtar i vërtetë ortodoks e pranon ekzistencën e Islamit si një mënyrë e raportit me Perëndinë. Dhe anasjelltas. Për këtë arsye „hapi kah tjetri” është i mirë dhe i rëndësishëm, por „hapi kah vetja” është të paktën po aq i nevojshëm.

Gjinia dhe seksi – Seksin na e përcaktojnë kromozomet dhe na është dhënë nga lindja, gjinia është e kushtëzuar nga shoqëria. Në kulturat tona nënkuptohet një ndarje e qartë e mashkullit / femrës. Çdo devijim sanksionohet pak a shumë me dhunë. Ndarja e gjinisë dhe seksit hap një spektër të tërë të identiteteve që nuk janë të kuptueshme në mënyrë „të qartë” gjegjësisht tradicionale si mashkull apo femër. Megjithëse duket se përkufizimi i qartë i gjinive dhe me këtë edhe i seksit në vetvete e „lehtëson” jetën, nuk është kështu. Rolet tradicionale ndryshohen, kuptohet domosdoshmëria për hapjen e hapësirës publike dhe politike, deri vonë e mbyllur për gratë. Çdo person në vete ka më shumë ose më pak tipare ose karakteristika që tradicionalisht i atribuohen gjinisë së kundërt. Mënjanimi, mosnjohja dhe dënimi i tyre është akt dhune ndaj

vetë personit, drejt tërësisë së ekzistencës së tij. Presioni nga përzierja e këtyre identiteteve për tu shprehur dhe për tu deklaruar si M ose F të qartë - e varfëron, e zvogëlon vetë komunitetin, shoqërinë.

S

Solidariteti - ndarja e resurseve të tij me të tjerët, veçanërisht nëse resurset janë të vogla, pa kërkuar shërbime nga pala tjetër. E definuar në këtë mënyrë, solidariteti nuk përshtatet me mënyrën kapitaliste të të menduarit, ku gjithçka ka çmim dhe ku zhvillohet e gjithë industria e ndihmës. Solidariteti nuk duhet të lidhet me paratë ose me dhënien e diçkaje, thjesht ndonjëherë nënkuptohet që ti ftojme ata që kanë nevojë të përdorin pajisjet, makinat, burimet dhe / ose kapacitetet tona. Solidariteti në këtë mënyrë bëhet një nocion i cili del nga sfera „humanitare” dhe bëhet subversive ndaj modeleve të dhunshme, shfrytëzimit, përdorimit të „pushtetit mbi”; është një nocion thellësisht paqësor që përmban ngushëllim për tjetrin, ndërton raporte të bashkëpunimit që janë bazë për ndërtimin e paqes.

Bashkëpunimi – së bashku, vullnetarisht, veprimi i harmonizuar i autorëve të shumtë. Raportet e fuqisë gjatë bashkëpunimit janë të barabarta ose së paku përshtatet dhe respektohen me saktësi. Bashkëpunimi është forma më e lartë e transformimit të konflikteve. Gjatë bashkëpunimit merret parasysh përmbushja e nevojave **të të gjitha palëve të përfshira. Konfliktet** gjatë bashkëpunimit janë rregull, dhe jo përjashtim, për shkak të dallimeve të autorëve, kapaciteteve të tyre, nocionet e komunikimit, presion nga afatet, situatave të papritura dhe një seri të situatave të brendshme dhe të jashtme. Është e nevojshme të parashikohet sjellja dhe raporti me konfliktet, paraprakisht të bien dakord mbi mekanizmat për parandalim, zbulim, **vërejtje, qëndrim aktiv**. Ndiemon nëse parashikohet një mediator i pranueshëm i përbashkët, pala e „tretë” e cila do të ndihmojë për komunikim më cilësor kur kriza / konflikti do të shpërthejë. Bashkëpunimi shpesh merret si „e mirëqenë”, nënvlerësohet kompleksi i një komunikimi të ndërsjellë kualitativ, shkëmbim i informacioneve, dallimet në sjelljen e partnerëve në situata krize. Nuk mjafton të theksohet se sa është i rëndësishëm bashkëpunimi në kontekstin e paqes. Ajo ndërton raporte ndërmjet palëve të përfshira, me atë edhe në komunitet dhe shoqëri. Për atë thuhet: Ku ka bashkëpunim, aty ndërtohet paqe.

Ballafaqimi me të kaluarën - Koncepti i ri, nga fundi i shekullit të XX. Organizata më e njohur ndërkombëtare e cila merret me këtë është e themeluar në vitin 2001 - Qendra ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale (<https://www.ictj.org>). Ballafaqimi, megjithatë është një nocion më i gjërë nga drejtësia tranzicionale dhe përfshin të gjitha ato procese dhe aktivitete me të cilat i zbulojmë, njohim, informojmë, i hulumtojmë ato ngjarje nga e kaluara dhe bëjmë parandalimin nga ndikimi i tyre i rëndë, destruktiv ndaj të tashmes dhe të ardhmes. Fakti i përgjithshëm është se pas luftës askush nuk dëshiron të flas për krimet dhe padrejtësitë e veta, kurse ekzagjerohen ato që janë bërë mbi ne dhe të tanët.

Ballafaqimi me të kaluarën është një nga ato mekanizma/ mjete me të cilat e heqim njëlljosjen nga kolektivi, duke emëruar fajtorët konkret, e studiojmë kontekstin dhe gjejmë kënaqësi për viktimat. Pushtetarët dhe shoqëritë nuk duan punë për ballafaqim me të kaluarën pasi që i shfaq në një imazh më të keq nga ajo se si ata e shohin vetëveten dhe pikërisht për këtë punohet për punë të nevojshme dhe shëruese e nevojshme për procesin e pajtimit dhe arritjes së paqes së qëndrueshme. Për ilustrim ndoshta është më e përshtatshme motoja e **cila në atë kohë është përdorur nga Fondacioni Martin Luter King**: “Ne shqetësojmë ata që nuk janë të shqetësuar, dhe i ngushëllojmë ata që janë” (We disturb the comfort ones and we comfort the disturbed ones) ose në shtypshkronjën e Beogradit “ Nëse jeni mirë, atëherë asgjë”

T

Toleranca– zgjedhje e vetëdijshme që do të tolerojmë diçka (cila) që: a) nuk na pëlqen; b) në të cilën mund të ndikojmë. Nuk ka kuptim të flasim, për shembull, që e „tolerojmë klimën”, sepse nuk mund të ndikojmë në atë ose që e „tolerojmë metalin e **rëndë ose muzikën e turbofolkut**” nëse ajo nuk na pëlqen. **Toleranca është shumë e rëndësishme sepse jetesa në një mjedis të patolerueshëm mund të jetë një** ankth i vërtetë. Si do që të jetë, toleranca nuk është një garanci se nuk do të arrihet deri te dhuna. Shumë njerëz tolerantë janë të gatshëm të bashkohen në thirrjen për betejë, luftë ose të marrin pjesë në protesta të dhunshme nëse thirren nga autoritete ose nëse situata është shërbyer nga mediat si e domosdoshme, detyruese. Mosbindja është një garanci shumë më e madhe se toleranca, që nuk do të vjen deri te dhuna e armatosur.

Transformimi i konflikteve - qasje arsimore / shkencore / praktike ndaj konflikteve. Bazohet në bindjen se: a) konfliktet janë pjesë e jetës së përditshme; b) se ata janë mundësi **për të përmirësuar cilësinë** e raporteve, por njëkohësisht edhe një rrezik për shkak të potencialit për dhunë. Postulati themelor është „të jesh i kujdesshëm me personin, i ashpër me problemin⁷⁾”. **Është e pranueshme të flitet për zgjidhjen e konflikteve⁸⁾, kështu që** ekzistojnë departamente të tëra në universitetet **në mbarë botën që** merren me këtë. Ne jemi më të prirur për të përdorur termin transformim i konflikteve dhe me atë theksojmë **se palët e përfshira në konflikt** ndryshojnë, dhe më tepër ndryshon raporti i tyre. Kjo mohon se pas konfliktit mund të „kthehemi në situatën siç ishte më parë”. Shpesh njerëzit **në situata** lufte flasin për rivendosjen e situatës para konfliktit, e cila është e kuptueshme dhe njerëzore, por nuk është reale që të pritët. Zhvillimet në konfliktet, veçanërisht ato të dhunshme dhe të armatosura, në mënyrë dramatike i ndryshojnë vetë autorët dhe raportet e tyre, kështu që flasim për transformim në të cilën konflikti i dhunshëm do të përfundojë dhe do të krijojë një raport të ri, dhe nuk do të kthehet „ai i vjetri”. Në punën paqësore flasim për transformimin jo të dhunshëm të konflikteve. Kështu theksojmë se patjetër duhet të merren parasysh: a) faktet b) ndjenjat dhe c) nevojat e të gjitha palëve të përfshira. Në transformimin jo të

⁷⁾ Në anglisht: *Be soft with person but tough on issue*

⁸⁾ Në anglisht *conflict resolution*

dhunshëm nuk ka fitues dhe humbës, por ka marrëveshje që të gjithë janë më pak (kompromis) ose më shumë (bashkëpunim) të kënaqur.

Transformimi i konflikteve është i madh dhe shkencor, akademik në praktikë sferë e njohur. Përfshin analizën e konfliktit (të cilat janë palë të përfshira direkt dhe indirekt, cilat janë ndjenjat dhe nevojat e tyre, se çfarë në të vërtetë ka ndodhur - të vërtetën faktike), dinamika e konfliktit (konflikt vazhdimisht ndryshon, raportet në mes autorëve ndryshojnë, njohuritë për elementet e konfliktin ndryshojnë, ndryshojnë autorët e jashtëm ...), mënyrat e sjelljes me konfliktin (në masë të madhe në lidhje me interesimin dhe fuqinë e palëve të përfshira për të ndikuar në ndryshimin).

Gabimi standard është të pritet që konflikti „do të zgjidhet” dhe se pas „zgjidhjes” nuk duhet më që të punohet në raportet midis palëve. Më e dobishme është të kuptohet se vetë konflikti tregon brishtësinë e raporteve dhe kompleksin e tyre dhe se është e rëndësishme që vazhdimisht të punohet në mirëmbajtjen e tyre cilësore (komunikim, pritshmëri, plotësimin e nevojave, ndarja e fuqisë ...).

V

Viktima- Ka shumë përkufizime të këtij koncepti shumë të rëndësishëm dhe të ndjeshëm, dhe çdo lëshim i tyre na çon në rrezikun për konflikte shtesë, lëndim. Në një kontekst paqeje është e rëndësishme të kemi parasysh dy gjëra. Së pari, viktimat përcakton nëse kundër saj është kryer dhunë ose jo. Edhe pse ndoshta më saktë mund të thuhet se për atë është kompetent gjykata apo ndonjë arbitër tjetër kompetent, nuk është çdo herë ashtu.

Sidomos jo në situatat e përditshme. Të përqafuar një person tjetër mund të jetë një veprim i shoqërisë, miqësisë, respektit, dashurisë. Por mund të jetë edhe një shprehje e mbifuqisë, kontrollit, kërcënimit, presionit, poshtërimit, në qoftë se personi i përqafuar- viktimat ndjehet në atë mënyrë. Edhe pse perceptimet në mënyrë diametrale janë të ndryshme, nuk është e „dhunuesit” të vlerësoj (ai / ajo ka të drejtë të mbrohet, të justifikohet), por ndjenja e pakëndshme, e dhunshme, e shkaktuar ndaj prersonit tjetër duhet të prahohet. Së dyti, çdo transformim cilësor i konflikteve, veçanërisht ndërtimi i paqes, duhet të përfshijë satisfaksionin e viktimës. Egzistojnë një varg mekanizmash për riparim, kompensim dhe dëmshpërblime të tjera. Shpesh harrohet se për viktimat më e rëndësishme është pohimi i njerëzve që kanë vuajtur, sesa ai që është i rëndësishëm për ta, e ka njohur (autoritetet, komuniteti, shteti) dhe të punohet në ato çështje që të mos zhvlerësohen, harohen, e as që tu përsëriten atyre ose dikujt tjetër. Edhe pse relativisht është rrënjësor mendimi se viktimat janë ata që kërkojnë hakmarrje, në praktikë nuk është ashtu. Ata kërkojnë njohjen për vuajtjet e tyre dhe garancën se ajo nuk do të përsëritet. Gjithashtu, edhe kërkim falje nga autorët ose ndëshkimi i duhur i tyre. Këtu vijmë te nocionet e drejtësisë retributive dhe restauruese.

